



Republika e Kosovës - Republika Kosove
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšta, Administrativne Poslove

01 Nr. *01/01-46987*
Data/Datum: *20.12.2019*

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Gjakovë-Djakovica-Gjakova
Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01 Nr. _____ /2019
Dt. 18.12.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, bazuar në nenin 12 dhe 17 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 14 të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 18.12.2019, pas diskutimeve lidhur me pikën e 8 të rendit të ditës: Draft Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë PKVEE 2019-2021, e miratoj këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë PKVEE 2019-2021

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë PKVEE 2019-2021 për Komunën e Gjakovës.
2. Pjesa përbërës e këtij vendimi është Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë PKVEE 2019-2021 për Komunën e Gjakovës
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetari të Komunës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Shërbime Publike
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Anton Shala
Anton Shala



Komuna e Gjakovës

**Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë
(PKVEE)
2019 – 2021**

Nëntor 2019



financed by
giz
German Development Cooperation
www.giz.de

Deklarim:

Ky Plan është mbështetur nga Qeveria Gjermane dhe implementuar përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Kosovës për Eficiencë të Energjisë.

Studimi, mbledhja e të dhënave si dhe hartimi i planit është realizuar nga konsulenca e angazhuar nga GIZ: EECG falë bashkëpunimit dhe koordinimit të ngushtë me Menaxheren Komunale të energjisë dhe grupin punues të Komunës së Gjakovës. Pikëpamjet e hartueseve të këtij plani si dhe të dhënat e publikuara nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-së.

SHKURTESAT:

MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
AKEE	Agjencia Kosovare për Eficiencë të Energjisë
ORF-EE/GIZ	Fondi i Hapur Rajonal për Eficiencë të Energjisë/Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë
PKVEE	Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë
EE	Eficienta e Energjisë
BRE	Burimet e Ripërteritshme të Energjisë
kWh	Kilo-wat-ore
GWh	Giga-wat-ore
ktoe	Kilo Ton oil/naftë ekuivalent
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MF	Ministria e Financave
TC	Termocentral
NQ	Ngrohje Qendrore
KEK sh.a.	Korporata Energjetike e Kosovës, Shoqëri Aksionare
HC	Hydrocentral
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut në Kosovë
SKT	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
KCAME	Komisioni për Certifikimin e Auditorëve dhe Menaxherëve të Energjisë
UA	Udhëzim Administrativ
GLN	Gaz i Lëngëzuar i Naftës
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
BE	Bashkimi Evropian
KE	Komisioni Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
DPEN	Direktiva për Performancën Energjetike të Ndërtesave

Përmbajtja

1. HYRJE	3
1.1. OBJEKTIVAT E PKEE.....	3
1.2. KUADRI LEGAL DHE POLITIKAVE ENERJËTIKE.....	5
1.3. PËRFITIMET NGA REALIZIMI I PKVEE.....	7
1.4. PËRMBLËDHJE EKZEKUTIVE.....	8
2. INFORMACIONE BAZË RRETH KOMUNËS	14
2.1. POZICIONI GJEOGRAFIK.....	14
2.2. KLIMA.....	17
2.3. POPULLLSIA DHE BANIMET.....	18
2.4. STRUKTURA ORGANIZATIVE.....	20
2.5. TREGUESIT EKONOMIK DHE FINANCIAR.....	21
2.6. POLITIKAT ENERJËTIKE RELEVANTE SHËTETERORE DHE LOKALE.....	22
2.7. EKSPERIENCA NË ZBATIMIN E MASAVE TË EFIÇENCËS SË ENERJËSË	23
2.7.1. KAPACITETI NË ZBATIMIN E PROJEKTEVE TË EFIÇENCËS SË ENERJËSË	23
3. FURNIZIMI ME ENERJË, PRODHIMI DHE SHPËRNDARJA.....	23
3.1. FURNIZIMI ME ENERJË.....	23
3.1.1. ENERJËJA ELEKTRIKE.....	23
3.1.1.1. Furnizimi me energji elektrike.....	23
3.1.1.2. Shpërndarja e energjisë elektrike.....	24
3.1.2. NËN PRODUKTET E NAFTËS.....	25
3.1.2.1. Thëngjill.....	26
3.1.2.2. Biomatat	27
3.2. PRODHIMI ENERJËSË.....	29
3.2.1. PRODHIMI I ENERJËSË NGA BURIME TË RINOVUESHME (SHPP, PV, SISTEMET E UJIT TË NGROHTË, POMPAT E NXEHTESISË, IMPIANTET E ENERJËSË SË ERËS).....	29
3.2.2. IMPIANTET E NGRËHJES SË PËRQENDRUAR DHE SHPËRNDARJA E NXEHTESISË.....	30
3.2.3. PRODHIMI I ENERJËSË SIPAS SEKTOREVË	34
3.2.3.1. Prodhimi i Energjisë nga sektori residencial.....	34
3.2.3.2. Prodhimi i Energjisë nga sektori shërbimeve.....	34

3.2.3.2.1. Prodhimi i Energjisë nga ndërtesat publike	34
3.2.3.2.2. Prodhimi i Energjisë nga ndërtesat komerciale dhe sme.....	34
3.2.3.2.3. Prodhimi i Energjisë nga sektori i ndërmarrjeve e shërbimeve publike	35
3.2.3.3. Prodhimi i Energjisë nga sektori industrisë.....	35
3.2.3.4. Prodhimi i Energjisë nga sektori bujqesisë.....	35
4. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTOREVE.....	36
4.1. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDËRTESTAT PUBLIKE.....	36
4.1.1. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDËRTESTAT E ADMINISTRATËS PUBLIKE	36
4.1.2. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDËRTESTAT PUBLIKE TË EDUKIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË.....	39
4.1.3. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDËRTESTAT E SHËNDETIT PUBLIK.....	41
4.1.4. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDËRTESTAT PUBLIKE TË KULTURES DHE SPORTIT	42
4.1.5. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDRICIMIN PUBLIK TË RRUGEVE	42
4.2. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDËRRMARRJET PUBLIKE.....	44
4.2.1. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDËRRMARRJET PUBLIKE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË UJRAVE TË ZEZA.....	44
4.2.2. KONSUMI I ENERGJISË NGA MBLEDHJA E METJEVE URBANË.....	45
4.3. KONSUMI I ENERGJISË NGA SEKTORI BUJQESISË	46
4.4. KONSUMI I ENERGJISË NGA SEKTORI TRANSPORTIT	47
4.4.1. STOKU I TRANSPORTIT TË KOMUNËS.....	47
4.4.2. TRANSPORTI PUBLIK	49
5. ANALIZA E POTENCIALIT TË EE SIPAS SEKTORËVË.....	50
5.1. SEKTORI I SHËRBIMEVE.....	50
5.1.1. NDËRTESTAT PUBLIKE	50
5.1.2. NDRICIMI PUBLIK I RRUGEVE	51
6. POTENCIALI I KURSIMIT TE ENERGJISË DHE REDUKTIMIT TË GAZEVE ME EFEKTIN SERRË (GHG).....	54
7. TARGETAT E KURSIMIT TË ENERGJISË.....	54
8. MASAT E EE PËR TË REALIZUAR TARGETAT E KURSIMIT TË ENERGJISË.....	55
8.1. INFORMACION NË LIDHJE ME KAPACITETET TEKNIKE PËR ZBATIMIN E MASAVE TË EE	55

8.1.1. MASAT E POLITIKËS TË PROMOVIMIT TË EE DHE NDRYSHIMIT TË SJELLJES TË KONSUMATORËVE KARSHI KONSUMIT TË ENERGJISË.....	55
8.2. MASAT E EE SIPAS SEKTORËVE.....	57
8.2.1. MASAT E EE NË SEKTORIN E NDËRTESAVE PUBLIKE.....	57
8.2.2. NDRICIMI PUBLIK I RRUGËVE.....	61
8.2.3. NDËRRMARRJET PUBLIKE.....	64
8.2.3.1. ndërmarrjet publike të furnizimit me ujë dhe të ujrave të zeza.....	64
8.2.3.2. Mbledhja e mbetjeve urbane.....	64
8.2.4. SEKTORI I SHËRBIMEVE PRIVATE.....	66
8.2.5. SEKTORI I INDUSTRISE.....	67
8.2.6. SEKTORI I BUJQËSISË.....	70
8.2.7. SEKTORI I TRANSPORTIT.....	71
9. PLANET E VEPRIMIT.....	72
9.1. PRIORITIZIMI I SEKTORËVE.....	72
9.2. NIVELI I KONTROLLIT TË KOMUNËS NË TË GJITHË SEKTORËT.....	74
9.3. SFIDAT E KOMUNËS NË LIDHJE ME KONSUMIN ENERGJETIK.....	75
10. MONITORIMI DHE IMPLEMENTIMI I PLANIT TË VEPRIMEVE.....	76
10.1. MANAXHIMI I ENERGJISË NË KOMUNA.....	76
10.1.1. KOORDINIMI.....	78
10.1.2. RAPORTIMI.....	80
10.1.2.1. Monitorimi dhe raportimi brenda komunës.....	80
10.1.2.2. Raportimi ne Agjencionin Kosovar për Efciencë të Energjisë (AKEE)....	81
11. MODELI DHE BURIMET FINANCIARE PËR FINANCIMIN E REALIZIMIT TË MASAVE TË EE.....	83
11.1. FINANCIMI NGA BUXHETI I KOMUNËS.....	83
11.2. FINANCIMI NGA BUXHETI QENDROR.....	85
11.3. FINANCIMI NGA DONATORËT.....	86
11.4. FINANCIMI NGA FONDET E EU.....	86
11.5. AKSESI NE FINANCIMIN NËPËRMJET BANKAVE KOMERCIALE – PARASHIKIMI I KUFIZIMEVE PËR MADIËSINË E BORXHIT.....	87
11.6. MEKANIZMAT E FINANCIMIT TË ZBATIMIT TË PLANIT TË EFICENCËS SË ENERGJISË.....	90
12. MASAT E EFICENCËS SË ENERGJISË PËR PERIUDHËN 2019-2021 PËR TË ARRITUR TARGETAT E EFICENCËS SË ENERGJISË.....	92

12.1. SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE.....	92
12.1.1. MASAT E EE NË NDËRTESAT PUBLIKE KOMUNALE.....	92
12.1.2. MASAT E EE NË NDRICIMIN E RRUGËVE NË KOMUNË.....	97
13. ANEKSE.....	102
13.1. Aneksi 13.1 - LISTA E NDËRTESAVE PUBLIKE KOMUNALE (PB).....	102
13.2. Aneksi 13.2 - TË DHËNAT BAZË TË NDËRTESAVE PUBLIKE KOMUNALE (PB).....	104
13.3. Aneksi 13.3 - NDRIÇIMI PUBLIK RRUGOR KOMUNAL.....	108

1. HYRJE

1.1. OBJEKTIVAT E PKEE

Plani i EE për Komunën e Gjakovës, duke qenë në thelb një shprehje e nevojave të komunës, siguron një zhvillim të qëndrueshem dhe realizon njëkohesisht edhe mbrojtjen e mjedisit gjatë të gjithë ciklit të shfrytëzimit të burimeve energjitike. Plani i EE për Komunën e Gjakovës do të jetë pjesë e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit ekonomik të Komunës. Gjatë hartimit të një dokumenti të tillë çështja më themelore është niveli i besueshmërisë së të dhënave bazë të përdorura për të gjitha analizat, llogaritjet për skenaret energjitike si dhe saktësia në përcaktimin e treguesve të përgjithshëm ekonomik për të ardhmen.

Plani i EE për Komunën e Gjakovës është një dokument që analizon situatën aktuale dhe rekomandon veprimet dhe ndryshimet që duhet të ndërmerren për të ardhmen në sektorët e ndryshëm të shërbimeve komunale në lidhje me konsumin e energjisë. Në të janë analizuar dhe përfshirë të gjitha ndryshimet e nevojshme që duhet të ndërmerren për të rritur efikasitetin në përdorimin e energjisë, sigurinë e furnizimit me burime energjitike, optimizimin e burimeve për mbulimin e nevojave me synim kryesor zhvillimin e qëndrueshëm të mbare ekonomisë për të ardhmen për Komunën e Gjakovës. Duke mbajtur në konsideratë se ndryshimet në sektorin energjistik nuk ndodhin spontanisht, ristrukturimi i sistemit energjistik kërkon marrjen e masave shumë të mëdha. Eksperienca nga Komunitet e tjera në Ballkan dhe Europë ka treguar se duhet të vendoset një ekuilibër i drejtë si ndërmjet mekanizmave të tregut dhe ndërhyrjeve të qeverisë-lokale ashtu si edhe ndërmjet aspekteve teknike/teknologjike, menaxhimit të energjisë dhe rëndësisë që duhet t'i kushtohet anës sociale.

Plani i EE për Komunën e Gjakovës është e domosdoshme për të plotësuar detyrimet e Kosovës për të përmbushur të gjitha detyrimet ndërkombetare që kanë të bëjnë me arritjen e targetave të EE, BRE (në nivel vendi dhe nivel komune) si dhe mbrojtjen e mjedisit dhe për të harmonizuar e konvergjuar zhvillimin e sektorit energjistik në përputhje me Direktivat e Bashkimit Europian, për të bërë të mundur asociimin e Kosovës në familjen Europiane.

Një çështje shumë e rëndësishme, që diskutohet shpesh si në rrethet politikebërëse ashtu edhe në ato teknike është: A është e nevojshme një Plani i EE për Komunën e Gjakovës për një Komunë e cili po kalon në procesin e tranzicionit nga abandonimi i ekonomisë të centralizuar në krijimin e sistemit të ekonomisë së tregut? Megjithatë duhet theksuar që edhe Komunitet e zhvilluara nuk i kanë mbaruar diskutimet rreth kësaj çështje, marrëdhënia ndërmjet tregut dhe ndërhyrjeve të Qeverisë Lokale ka treguar eksperienca të ndryshme nga një vend tek një tjetër. Opinioni i përgjithshëm është e domosdoshmëria e hartimit dhe implementimit të një Plani i EE për Komunën e Gjakovës për të vendosur një ekuilibër ndërmjet mekanizmave të veprimit të tregut dhe ndërhyrjeve të Qeverisë Lokale. Natyrisht që fjala "Plani i EE për Komunën e Gjakovës" ka kuptim të ndryshëm në ekonominë e centralizuar dhe në atë të tregut. Gjithashtu, përmbushja e misionit për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjistik, kërkon përcaktimin e të gjithë objektivave dhe masave të nevojshme fiskale nëpërmjet një plani me tërësi masash plotësisht të përcaktuara në kohë dhe me investimet perkatesë.

Plani i EE për Komunën e Gjakovës analizon në detaje brenda kuadrit të planit të veprimeve probleme madhore të cilat sot diskutohen gjerësisht: çfarë duhet bërë në drejtim të kursimit të energjisë në sektorët e banesave, shërbimeve publike komunale dhe industrisë; a duhet të vazhdojmë të realizojmë ngrohjen e banesave private dhe atyre publike me energji elektrike (që është një burim deficitar) apo të krijojmë kushte për penetrimin e ngrohjes së përqendruar nga impianti i përditësuar të Ngrohtores së Gjakovës, burimeve të lëndëve djegëse (vecanërisht biomasave/peletave, GNL dhe burime të tjera alternative); cilat janë investimet e domosdoshme për këtë qëllim; etj. Përgjigje të cilat do të rezultojnë të qarta në konkluzionet e Planit të EE për Komunën e Gjakovës. Plani i EE për Komunën e Gjakovës përfshin drejtimet teknike, financiare, ekonomike, ligjore, organizative, institucionale, mjedisore dhe të trainimit

të vazhdueshëm të të gjithë specialistëve me qëllim që të përgatise të gjithë kuadrin e domosdoshëm për të integruar në mënyre jo të sforsuar masat e EE/ BRE/Teknologjive miqësore me Mjedisin në të gjitha shërbimet komunale. Gjatë hartimit të kësaj plani të veprimeve janë trajtuar një sërë çështjesh dhe i jepet përgjigje edhe disa pyetjeve të tjera strategjike shumë të rëndësishme, si:

- Cilat interesa komunale duhet të mbrohen dhe si?
- Si keto interesa komunale do të shpërndahen në nënsektoret e ndryshëm për të arritur targetat përkatse të EE/BRE?
- Cilat do të jenë kushtet e domosdoshme që duhen vendosur dhe plotësuar në një kohe të përcaktuar në mënyre të tillë, që shërbimet energjetike komunale të realizohen në të njëjtin nivel komforti si edhe në komunat e BE-se?
- Si do të rrisim konkurrencën dhe hapjen e tregut në favor të konsumatorëve pa shmangur përgjegjësitë e Komunës për funksionimin e sistemit energjetik dhe sigurisë së furnizimit në të gjitha shërbimet publike?

Ekspertët kanë kryer parashikimet energjetike deri në vitin 2030 dhe pasojat e politikave energjetike dhe efekteve të jashtme të lidhura me këto politika energjetike. Këto parashikime përshkruajnë limite brenda të cilëve shërbimet energjetike komunale në Gjakovë ka shumë të ngjarë që të zhvillohet. Skenarët përshkruajnë mundësitë në periudha afatmesme dhe afatgjate të zhvillimit duke u bazuar edhe në parashikimin e ardhshëm teknologjik dhe ekonomik dhe kushte klimaterike të komunës.

Plani i EE për Komunën e Gjakovës është mbështetur mbi një vizion të qartë për zhvillimet e ardhshme, që do të ndodhin në shërbimet energjetike komunale. Megjithëse ka qenë e vështirë të parashikohet me saktësi se cilat do të jenë karakteristikat e këtij zhvillimi të ardhshëm, disa drejtime të cilat kanë dale si rezultat i analizave të gjata historike për komuna të ngjashme dhe që kanë probabilitet të lartë të ndodhin për të ardhmen janë si vijon:

- Sistemi i ardhshëm për shërbimet energjetike komunale duhet të jetë më shumë i orientuar drejt konsumatorit,
- Sistemi i ardhshëm për shërbimet energjetike komunale duhet të jetë më i diversifikuar në drejtim të përdorimit të të gjithë burimeve dhe të gjitha teknologjive energjetike,
- Sistemi i ardhshëm energjetik për shërbimet energjetike komunale duhet të jetë më i decentralizuar.
- Të gjitha teknologjitë, që do të zgjidhen për plotësimin e nevojave për shërbimet energjetike komunale, duhet të mbështeten mbi parimin e kostos më të ulët, sigurisë së furnizimit dhe mbrojtjes së mjedisit.

Plani i EE për Komunën e Gjakovës analizon tre çështje kryesore: 1) situatën e furnizim-kerkeses së energjisë deri në vitin 2030; 2) strukturën institucionale për shërbimet energjetike komunale dhe 3) përgatitjen e paketës financiare, të investimeve të kërkuara, dhe të ndërtimit të afateve kohore për zbatimin e secilës masë të EE/RES në bazë të rekomandimeve të parashtruara nga Plani i EE për Komunën e Gjakovës.

Për pasojë, objektivi madhor i Planit të EE për Komunën e Gjakovës është zhvillimi i një sektori energjetik efektiv për shërbimet energjetike komunale që:

- nxit përdorimin eficient, ekonomik dhe me ndikim minimal në mjedis në mënyrë të tillë që sektori energjetik të jetë një sektor mbështetës për një zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë shërbimeve energjetike komunale.
- garanton sigurinë e furnizimit me burime energjetike në përgjithësi dhe energji elektrike në vecanti.
- garanton reduktimin e gazeve acid, smogut dhe gazeve sere për shërbimet energjetike komunale në Gjakovë.

1.2. KUADRI LEGAL DHE POLITIKAVE ENERGETIKE

Një nga parakushtet e rëndësishme për një zbatim të suksesshëm të Planit të Veprimit të Eficencës së Energjisë është harmonizimi i tij i plotë me legjislacionin përkatës komunal, shtetëror dhe të BE-së. Elementet kryesorë janë të përshkruara si më poshtë.

Regulla dhe dokumenta relevante të Bashkimit Evropian

Katër objektivat bazë të politikës energjetike Evropiane deri në 2020 janë:

- reduktimi i shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga vendet e zhvilluara me 20%;
- rritja e efikasitetit të energjisë me 20%;
- rritja e përqindjes së mbulimit me burime të rinovueshme me 20%;
- rritja e përqindjes së mbulimit me biokarburante në transport me 10%.

Dokumentet kryesorë legjislativë të cilat rregullojnë zhvillimin e sektorit të energjisë në nivel Evropian (të listuara në mënyrë kronologjike) janë:

- "Karta e Bardhe" e një politike të Energjisë për Bashkimin Evropian, Janar 1996;
- Energjia për të Ardhmen: Burimet e Rinovueshme të Energjisë, "Karta Bardhe" për një strategji të Komunitetit dhe Veprim, Nëntor 1997;
- Karta e Gjelbërt "Drejt një Strategjie Evropiane për Sigurimin e Furnizimit me Energji";
- Karta e Gjelbërt mbi efikasitetin e energjisë ose "Të bësh më shumë me Pak, Qershor 2005";
- Karta e Gjelbërt mbi një Strategji Evropiane për Qëndrueshmëri, Konkurrence dhe Furnizim me Energji të Sigurt, Mars-2006;
- Plani i Veprimit për Eficencën e Energjisë: Realizimi i Potencialit - Kursim 20% deri në 2020, Tetor 2006;
- Propozimi për Politikën Energjetike Evropiane, Janar 2007;
- Propozimi për planin e efikasitetit të energjisë së BE-së, viti 2011.

Direktivat e Bashkimit Evropian që rregullojnë fushën e Burimeve të Rinovueshme të Energjisë janë:

- Direktiva 2001/77/EC, mbi promovimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burime të rinovueshme të energjisë në një treg ndërkombëtar të energjisë elektrike, Shtator 2001;
- Komunikimi në lëndët djegëse alternative për Transportin Rrugor si dhe në një sërë masash për të nxitur përdorimin e Bio-karburanteve, Nëntor 2001;
- Direktiva 2003/30/EC mbi promovimin e Bio-karburanteve për Transport, Maj 2003;
- Direktiva 2009/28/EC mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme dhe amendimin dhe më pas shfuqizimin e Direktivave 2001/77/EC dhe 2003/30/EC, 23 Prill 2009.

Direktivat e Bashkimit Evropian që direkt ose indirekt rregullojnë fushën e efikasitetit të energjisë janë:

- Direktiva 2006/32/EC mbi efikasitetin tek përdoruesi final i energjisë dhe shërbimet energjetike, Qershor 2006;
- Direktiva 2009/125 mbi vendosjen e kërkesave për "Eko-projektimin" për produktet që lidhen me energjinë, Korrik 2009;
- Direktiva 2010/30 mbi vendosjen e treguesve nëpërmjet etiketave dhe informacioneve standarde të konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera për produktet e lidhura me energjinë, Tetor 2010;
- Direktiva 2010/31 mbi performancën energjetike të ndërtesave, Nëntor 2010;
- Direktiva 2012/27 mbi efikasitetin e energjisë, e cila amendon direktivat 2009/125 dhe 2010/30 dhe shfuqizon direktivat 2004/8 dhe 2006/32, Tetor 2012.

Dokumentet më të rëndësishme të politikave të energjisë në Kosovë janë :

- Ligji i efikasitetit të energjisë
- Strategjia e Energjisë e cila prezanton një dokument me politikat bazë për zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë ;

- Planet për Veprim në lidhje me Eficencën e Energjisë
- Traktati i Komunitetit të Energjisë për Europën Jug-Lindore, i cili është nënshkruar në Tetor 25, 2005. Ky traktat ka për qëllim të krijojë një treg të integruar për energjinë elektrike dhe gazin natyror, si pjesë e trugut më të gjerë të BE.

Ligji i Efiçencës së Energjisë

Përshtatja e ligjit të Efiçencës së Energjisë përbën themelin mbi të cilin zbatohen aksionet pasi legjislacioni i nevojshëm dytësor të jetë zhvilluar. Nje parim rëndësishëm për politikën kombëtare të efiçencës së energjisë, sic është përkufizuar në Ligjin të Efiçencës së Energjisë, është rritja e edukimit dhe ndërgjegjësimit për publikun e gjerë si dhe për konsumatorët final në lidhje me përfitimet që ata kanë nga reduktimi i konsumit të energjisë në mënyrë ineficente. Ligji rregullon përshkruan informacionin dhe trajnimin.

Ligji i EE këkon që Agjësia e Efiçencës së Energjisë e Kosovës të:

- Publikojë në faqen e saj zyrtare të Internetit informacion mbi mekanizmat, publikimet, financat dhe strukturat ligjore të cilat mund të ndihmojnë në arritjen e objektivave për kursimin e energjisë
- Informojë konsumatorët për metodat dhe praktikrat e ndryshme të cilat shërbejnë në arritjen e objektivave për kursimin e energjisë
- Të sigurojë trajnime për institucionet qeveritare dhe autoritetet lokale

Ligji për Efiçencën e Energjisë gjithashtu lejon për financim nga Fondi i Efiçencës së Energjisë të drejtohet tek programet të cilat rrisin ndërgjegjësimin dhe edukimin për efiçencën e energjisë. Etiketimi i pajisjeve që konsumojnë energji gjithashtu njihet si themeli për përmirsimin e informacionit mbi efiçencën e energjisë tek konsumatori.

Pengesat kryesore për zbatim e masave të EE janë si vijon:

- Qëllimi dhe objektivi nuk trajtojnë marrëdhëniet me publikun, zbatimin e politikave shtetërore për promovimin e efiçencës së energjisë dhe shërbimet e ofruara për zbatimin e tij;
- Funksionet shtetërore për promovimin e efiçencës së energjisë nuk janë përkufizuar qarta dhe janë të mjegullta në detyrat e tyre;
- Pasiguritë në detyrat e çdo institucioni përgjegjes për zbatimin e Ligjit mbi Efiçencën e Energjisë;
- Planet për Efiçencën e Energjisë janë shprehur në terma të përgjithshëm, pa përkufizimet të qarta;
- Nuk janë përkufizuar aktivitetet dhe masat për promovimin e efiçencës së energjisë;
- Nuk jepen përkufizimet të qarta për sigurimin dhe grumbullimin e informacionit mbi promovimin e efiçencës së energjisë;
- Aktiviteti i kufizuar dhe organizimi i mirë i procesit të auditimit të energjisë.

Ligji i Performancës Energjetike në Ndërtesa

Ligji "Performancës Energjetike në Ndërtesa" përcakton bazën e nevojshme ligjore për vendosjen e rregullave dhe kryerjen e veprimeve të detyrueshme për ruajtjen e ngrohjes termike në ndërtesa. Ligji përcakton që projekti dhe konstrukti i ndërtesave duhet të plotësojë parametrat e nevojshëm teknik për ruajtjen, kursimin, dhe përdorimin efiçent të energjisë në stokun e ndërtesave në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtij ligji është që të vendosë normat dhe rregullat për reduktimin e humbjeve të ngrohjes/nxehtesisë në ndërtesa. Dizajni dhe konstrukti i ndërtesave të reja duhet të llogarisë ruajtjen e energjisë dhe përdorimin e saj efiçent me koeficient normative volumetrik të humbjeve termike dhe përfshin instalimet termike të sistemeve qendrore ose rajonale të ngrohjes. Bazuar në këtë ligj, Ministri nëpërmjet Udhëzimit Administrativ vendos normat, rregullat dhe kushtet për dizajnin dhe konstruksionin e ndërtesës si dhe për mënyrën e gjenerimit dhe ruajtjes së ngrohjes në ndërtesa përfshihet në kodin energjetik të ndërtesave.

Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE)

PKVEE është adoptuar dhe vendos targetet e mëposhtëm të cilët fokusohen kryesisht në gjenerimin e energjisë dhe sektorin e konsumit. Reduktimin e intensitetit të energjisë me 9% me 2020 kundrejt niveleve të 2012; Përputhjen ligjore të sektorit të energjisë dhe strukturës rregullatore brenda EU Acquis dhe përmbushjen e detyrimeve të Paketës së Tretë të tregut të brendshëm të energjisë në përputhje me atë të BE.

1.3. PËRFITIMET NGA REALIZIMI I PKVEE

Përvec potencialit të madh të kursimeve të energjisë dhe reduktimit të shpenzimeve operuese për shërbimet energjetike komunale, ekzistojnë një numër i madh barrierash për të zbatuar programet e eficiencës së energjisë, përfshirë:

- Procedura jo-fleksibelë prokurimi për pajisjet dhe shërbimet;
- Buxhete të limituara një-vjecare që limitojnë financimin e përditësimeve të kapitalit;

Financimi i projekteve të EE mund të jetë vecanërisht sfidues përderisa Komunitet shpesh janë të mbyllura në një rreth vicioz për shkak të buxhetit të limituar për investime të reja, ndërsa vartësia në infrastruktura të vjetra e detyron Komunitet e që t'i përdori burimet e kushtueshme që ka në mënyrë jo-eficiente.

Më me rëndësi për arritjen e kursimeve afat-gjata në energji është instalimi dhe ndërtimi i kryer me një profesionalizëm të lartë. Oferta më e mirë për punët instaluese/ndërtimore ka me vete riskun e mos-përdorimit të praktikave më të mira që zotërohen nga instalues me përvojë. Si pasojë, procedurat e tenderimit publik duhet të rregullohen – sa më shumë që të jetë e mundur – për të përzgjedhur kombinimet e paisjeve dhe punëve të cilat kanë kosto optimale dhe përfitime sa më afat-gjata. Për këtë arsye, kërkesat e cilësisë në specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit duhet të jenë precize dhe procesi i vlerësimit duhet të reflektojë këtë përjasje.

Financimi i eficiencës së energjisë është i ndryshëm nga forma të tjera investimi. Ndërsa projektet e investimit financohen shpesh kundrejt ndonjë produkti të prekshëm – investimet në eficiencën e energjisë gjenerojnë shumicën e vlerës së tyre nga të ardhurat që ato do të gjenerojnë në të ardhmen prej kursimeve të energjisë. Si rrjedhojë, në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i Planit të EE për Komunitet e Gjakovës, është e rëndësishme që të merren në konsideratë mënyrat se si mund të zvogëlohen barrierat duke grupuar/bashkuar prokurimin publik, praktikën shumë vjecare publike të kontabilitetit, të buxhetit dhe ruajtjen e kursimeve – dhe të nxiten skemat për ndarjen e përfitimeve.

Masat për reduktimin e energjisë në sektorin publik mund të ndihmojnë në frenimin e shpenzimeve të energjisë, duke krijuar në këtë mënyrë një hapësirë fiskale për shpenzimet e tjera (p.sh. shërbimet sociale, investime në infrastrukturë, etc.). Megjithatë, zbatimi i programeve të eficiencës së energjisë është i limituar edhe në ekonomitë e vendeve të zhvilluara, me anë të rregullave të kontabilitetit, praktikave të ngurta të prokurimit të sektorit publik, dhe aksesit të limituar të buxhetit ose financimit të projekteve të EE. Për shembull, aplikimi strikt i kriterëve të prokurimit të cmimit më të ulët nuk e reflekton përfitimet që vijnë nga investime në kursimin e energjisë. Materialet dhe pajisjet e një cilësie më të lartë dhe me një performancë më të mirë energjetike do të jenë pak më të kushtueshme, por do të arrijnë kursime më të larta në koston e energjisë gjatë jetegjatësisë së tyre.

- 1. Disa nga përfitimet e zbatimit të Planit të EE për Komunitet e Gjakovës janë:**
- 2. Rritja e eficiencës së energjisë, si gjatë prodhimit ashtu dhe përdorimit të burimeve energjetike, me synim ndotjen minimale të mjedisit për shërbimet energjetike komunale;**

3. Optimizimi i sistemit të furnizimit me burime energjitike duke u mbështetur në konceptin e planifikimit me kosto më të ulët dhe ndikim minimal në mjedis për shërbimet energjetike komunale;
4. Ristrukturimin e plotë të kompanive lokale të furnizimit me ngrohje të përqendruar, me ujë , mbledhjes së mbetjeve urbane dhe ndricimit public të rrugëve;
5. Rritjen e ndjeshme të investimeve në sektorin e energjisë nëpërmjet tërheqjes së kapitalit nga Institucionet Financiare Ndërkombetare si dhe të kapitalit privat;
6. Plotëimi i të gjitha detyrimeve që dalin nga Planet PKVEE dhe PKVBRE,
7. Krijimi i një sektori energjistik të aftë si nga ana financiare ashtu edhe nga ajo teknike për shërbimet energjetike komunale;
8. Krijimi i një kuadri efektiv institucional dhe rregullator për shërbimet energjetike komunale;
9. Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë në furnizimin me energji nëpërgjithësi dhe energji elektrike në vecanti për shërbimet energjetike komunale;
10. Reduktimi i ritmeve të rritjes së konsumit të energjisë elektrike, duke rregulluar tarifat e energjisë elektrike në nivelet e kostos ekonomike, paralel me përmirësimet graduale të cilësive dhe rregullueshmërisë së furnizimit me energji elektrike.
11. Trajnimi i stafit komunal me teknologjitë me bashkohorë të EE/BRE për shërbimet energjetike komunale.

1.4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova shtrihet në qendër të Evropës Juglindore dhe ka një sipërfaqe prej 10,887 km². Kosova kufizohet me Shqipërinë, Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi. Kosova karakterizohet me relief të ndryshueshëm, me fusha të mëdha dhe zona malore. Rrethohet nga malet- Alpet Shqiptare. Maja më e lartë e këtyre vargmaleve ka lartësinë mbidetare prej 2,700 metra. Megjithatë, malet nuk e izolojnë Kosovën. Lumenjtë kanë formuar lugina të thella, duke i kapërcyer barrierat natyrore dhe duke i formuar lidhjet natyrore. Në territorin e Kosovës shtrihen dy tërësi, rrafshi i Dukagjinit dhe Fusha e Kosovës të cilat janë të ndara në mes veti me malet e Drenicës.

Rajoni përreth Gjakovës është i dominuar nga rrafshi i Dukagjinit. Ai rrethohet me Alpet e larta Shqiptare në pjesën perëndimore dhe, me zonën e vogël malore të Drenicës në lindje.

Gjakova shtrihet ndërmjet Prizrenit dhe Pejës. Për nga madhësia është qyteti i dytë në rajon. Para luftës Gjakova ishte qendra më e rëndësishme industriale dhe disa kapacitete industriale kanë rifilluar prodhimin.

Për ta promovuar transportin publik dhe për ta përmirësuar lidhjen me Kosovën perëndimor, një linjë e re hekurudhore ndërmjet Pejës dhe Prizrenit nëpër Gjakovë është propozuar në këtë plan. Realizimi i linjës hekurudhore, me sa duket, nuk do të zër vend parësorë në një të ardhme të afërt. Megjithatë, ky projekt do të ketë efekt të drejtpërdrejt në zhvillimet e ardhshme të Gjakovës. Për ta siguruar zhvillimin e ardhshëm të kësaj hekurudhe, duhet të bëhet një studim i realizueshëm dhe një korridor duhet të mbahet i lirë nga ndërtime (burimi: PZHK 2006-2015+ /fq.232). Aeroporti i Gjakovës në vitin 2012 është transferuar si aset nga kontingjenti italian i KFOR-it, Ministria Italiane e Mbrojtjes dhe Qeveria e Kosovës, në pronësi të Qeverisë. Aeroporti është në gjendje të shumë të mirë dhe i gatshëm për t'u përdorur për transport mallrash, si dhe për aktivitete sportive dhe rekreative të aviacionit. Ky aeroport do të ofrojë trajnime profesionale për pilotët e rinj. Mund të përdoret për fluturime "ngarkesash" (kargo) ose transport mallrash; mund të përdoret edhe nga agjencitë fluturuese me kosto të ulët (burimi: <http://gjakovaportal.com/Portals/0/Investo-ne-Gjakove.pdf>).

I vetmi aeroport i vogël në rajon, dhe i dyti në Kosovë, është i vendosur në afërsi të Gjakovës. Për momentin (2006) ky aeroport i vogël është i në shërbim të KFOR-it Italian, dhe nuk

përdorët nga civilët. Nëse ky aeroport i vogël do të mund të hapet për përdorim civil, do të ishte alternativë e mirë e aeroportit të Gjakovës e që paraqet rëndësi të madhe për tërë Kosovën. Gjakova ka pozitë të mirë në rajon. Për ta zbutur konkurrencën në rajon, duhet të përforcohet bashkëpunimi ndërmjet qyteteve. Bazë për këtë mund të jenë komunikimi me i mirë ndërmjet qyteteve, si dhe projektet e përbashkëta për zhvillimin ekonomik. Forma e qeverisjes lokale në Kosovë është Komuna. Komuna rregullon dhe udhëheq çështjet publike brenda territorit të saj për të siguruar kushte për jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët. Ajo kujdeset, gjithashtu, për çështje me interes të përgjithshëm që ndërlidhen me komunën dhe nuk mund të shqyrtohen vetëm nga pushteti qendror apo ndonjë organ tjetër.

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues i komunës, i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët. Në Komunën e Gjakovës Kuvendi ka sot 35 anëtare, që përfaqësojnë parti të ndryshme politike. Kuvendi i Komunës emëron Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin e Komuniteteve me anëtarë të Kuvendit. Këto Komitete mund të kooptojnë edhe anëtarë jashtë Kuvendit, por këta nuk mund të përbëjnë kurrsesi shumicën dërrmuese të Komiteteve. Veprimtaria e pushtetit lokal drejtohet nga Kryetari i Komunës, nga një Nënkryetar, 12 Drejtor të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Komunës nga përbërja e këshilltarëve të tij. Kjo veprimtari realizohet përmes administratës së komunës, e cila drejtohet nga Kryetari i komunës me udhëheqësit e drejtorive përkatëse. Në Bordin e Drejtorëve bëjnë pjesë drejtorët e: 12 Drejtorive, të cilat formojnë strukturën organizative të administratës së komunës.

Ky Plan Veprimi për Eficiencën e Energjisë prezanton gjetjet dhe rekomandimet kryesore nga zbatimi i vlerimit ndër-sektorial për energjinë në Komunën e Gjakovës për dy sektorët më të rëndësishëm të shërbimeve komunale të ndërtesave publike dhe atë të ndricimit rrugor, i cili është zbatuar nga një skuadër ekspertesh të EECG me mbështetjen financiare të GIZ dhe mbështetjen e gjithanshme të ekspertëve të shumë drejtorive të Komunës së Gjakovës gjatë periudhës 2018-2019. Qëllimi i këtij vlersimi është që të analizojë performancën dhe efektivitetin e përdorimit aktual të energjisë në sektorët e shërbimeve Komunale si dhe të identifikojë e prioritzojë mundësitë për krijimin e një strategjie për eficiencën e energjisë në zonat urbane në një periudhë 3 vjeçare (dhe një analize parashikuese për 12 vite deri në vitin 2030) bashkë me një plan të arsyeshëm zbatimi për Komunën e Gjakovës.

Potenciali i përgjithshëm i kursimit kumulativ deri në vitin 2030 i energjisë në Komunën e Gjakovës është:

Sektori	Kursimi kumulativ i energjisë deri në 2030 [MWh/vit]	Kursimi i energjisë [%]	Redukimi kumulativ i CO ₂ deri në 2030 [tCO ₂ /vit]	Redukimi i CO ₂ [%]
Sektori i ndërtesave publike	10,352	33.55%	5,219	51.06%
Ndricimi publik i rrugëve	612.00	68%	684.91	68%
Transporti: flota komunale e makinave	36,492	17.13%	39,436	17.13%
Gjithsej	11,000	35.41%	5,943	52.79%
Sektori rezidencial	283,910	30%	325,582	45.66%

Potenciali kursimit të energjisë në Komunën e Gjakovës, i planifikuar sipas PKVEE tre-vjeçar në këtë dokument, është:

Sektori	Kursimi i energjisë [MWh/vit]	Kursimi i energjisë [%]	Redukimi i CO ₂ [tCO ₂ /vit]	Redukimi i CO ₂ [%]
Sektori i ndërtesave publike	764	35.00%	369	53.267%

Ndricimi publik i rrugëve	174.32	68%	19.71	68%
Transporti : flota komunale e makinave	7.524	17.13%	8.131	17.13%
Gjithsej	946	40.94%	397	53.26%

Logjika për të investuar në eficientë e energjisë në infrastrukturën e zonave urbane Komunale është që të përmirsohet (i) aftësia e Komunës për të siguruar shërbimet e nevojshme tek qytetarët e saj duke rritur kështu standartin e tyre të jetës dhe punësimit, si dhe (ii) të reduktojë konsumin specifik të energjisë për një shfrytëzim më të qendrueshëm të burimeve dhe financave Komunale. Investime në eficientë e energjisë, të tilla si rehabilitimi i ndërtesave publike, ndricimi i rrugëve, furnizimi me ujë të pijshëm ose një sistem transporti publik eficient e ndihmon Komunën në përmirsimin e niveleve të shërbimit dhe komfortit në përputhje me standartet e një mjedisi të shëndetshëm dhe zvogëlimin e shpenzimeve në buxhet.

Për shkak të rëndësisë që zhvillimi i sektorit të ndërtesave publike dhe ndricimit rrugor që ka për Gjakovën, i është kushtuar vëmendje e veçantë identifikimit dhe zhvillimit të masave të integruara për të siguruar si **perfitime Komunale në eficientë e energjisë ashtu dhe në zhvillimin e komunës**. Për shembull, rehabilitimi i ndërtesave publike në qendër të qytetit rrit atraktivitetin e tij; ndërsa masat e integruara inovative për transportin urban lehtësojnë qarkullimin e automjeteve dhe përmirsojnë atraksionet turistike të komunës.

Në mënyrë që të zbatohen masat e eficientës së energjisë të sugjeruara në këtë plan dhe që të nisë rrugëtimi drejt një rruge për ruajtjen e energjisë dhe përmirsimin e shërbimeve Komunale, Komuna duhet të fokusohet në këto tre sfera kryesore: (i) **Adoptimin e planit të eficientës së energjisë nga këshilli Komunal** për legjitimizimin dhe institucionalizimin e targeteve për eficientë e energjisë; (ii) **Zhvillimin dhe promovimin e mekanizmave të qëndrueshëm financiar për eficientë e energjisë** të cilët konsiderojnë kursimet shumë-vjecare të energjisë për shlyerjen e investimit në eficientë e energjisë; (iii) **Fuqizimin e kapacitetit Komunal për sigurimin e eficientës së energjisë** dhe themelimin e një njesie të veçantë përgjegjëse për mbikqyrjen e zbatimit të planit të eficientës së energjisë. Plani i Komunës reflekton angazhimin serioz të saj në këtë çështje dhe do të mundësojë që Komuna e Gjakovës të realizojë targetet specifike të eficientës së energjisë bazuar në një analizë të thellë dhe një plan veprimi për të krijuar vullin që nevojitet për një angazhim dhe bashkëpunim më të gjerë të komunitetit në investimet Komunale.

Analiza e detajuar tregon se marrja e masave të investimeve në eficientë e energjisë në 2 sektore të shërbimit Komunal të cilët janë identifikuar dhe renditur sipas prioritetit që ata zoterojnë. **Kosto totale e masave të investimeve kumulative të rekomanduara për eficientë e energjisë** arrin shifrën e 11.215 milion EURO. Në qoftë se këto masa zbatohen deri në vitin 2030, mund të arrihen **kurisime totale kumulative prej 5.74 milion euro**. Kursimet e parashikuara vjetore përfaqësojnë 33.55% të kursimeve të energjisë në sektorët e shërbimeve komunale ose 6.8-7.5% kursime në konsumin e energjisë në të gjithë Komunën, krahasuar me mesataren e tre viteve baze 2015-16-17. Nga pikëpamja financiare **periudha e veshlyerjes e të gjithë këtij programi të jetë afërsisht 5.107 vjet (si mesatare për të gjitha ndërtesat) dhe 4.5-8.8 vjet (për ndërtesa të ndryshme)**. Të dy këto raporte përfaqësojnë një nivel të kënaqshëm të profitabilitetit duke konsideruar kurisime në kostot direkte të energjisë, ndërsa dominojnë përfitimet në komfort, furnizim e shoqëri, si zakonisht për programet e investimit në sektorin publik.

Sektori me vetë shlyerjen më të shpejtë të investimeve, periudhen më të shkurtër të zbatimit dhe kompleksitetin më të vogël është sektori i ndricimit, sic tregohet në tabelën 1. Duke rehabilituar paisjet ekzistuese për ndricimin e rrugëve me teknologji LED, Komuna mund të reduktojë shpenzimet që ky sektor sjell në buxhet duke përmirësuar në të njëjtën kohë sigurinë e trafikut si dhe komfortin e rrugëve për të gjithë banorët. Në tabelën

1 janë dhënë rrugët që do të jenë prioritet për të zbatuar masat e efijencës së energjisë për ndricim eficient në tre vitet e para të planit të EE.

Tabela 1: Rrugët për të cilët do të bëhet ndricimi publik që do të jenë prioritet për të zbatuar masat e efijencës së energjisë sipas të planit të veprimit të EE

Parametrat e rrugëve	1	2	3	4	5
Emri i Rrugës në lidhje me ndricimin e publik	Aleksandër Moisiu	Ali Ibra I	Ali Ibra II	Deshmoret e Lirise	Devë
Kapaciteti i Llambës	150	150	150	150	150
Numri i Llambave	12	11	17	18	19
Periudha e zbatimit	2019	2019	2019	2019	2019
Investimet totale të përfaqëruara të zbatimit të masave të efijencës së energjisë (€)	5280	4840	7480	7920	8360
Kursimet e energjisë (kWh/vit)	2407	2409	2105	60058	11807
Madhësia e reduktimit të CO ₂ (tCO ₂ /a)	2.70	2.70	1.22	67.26	13.22
Periudha e thjeshtë e vetë-shlyerjes, vite	9.973	9.132	16.152	0.599	3.219
Parametrat e rrugëve	6	7	8	9	10
Emri i Rrugës në lidhje me ndricimin e publik	Ismail Qemali	Kralan	Kushavec I	Kushavec II	Marin Barleti
Kapaciteti i Llambës	150	150	150	150	150
Numri i Llambave	12	35	8	12	15
Periudha e zbatimit	2020	2020	2020	2020	2020
Investimet totale të përfaqëruara të zbatimit të masave të efijencës së energjisë (€)	5280	15400	3520	5280	6600
Kursimet e energjisë (kWh/vit)	4921	14353	3422	7169	6793
Madhësia e reduktimit të CO ₂ (tCO ₂ /a)	5.51	16.08	3.83	8.03	7.61
Periudha e thjeshtë e vetë-shlyerjes, vite	4.877	4.877	4.676	3.348	4.416
Parametrat e rrugëve	11	12	13	14	15
Emri i Rrugës në lidhje me ndricimin e publik	Mark Marlota	Nënë Tereza	Novosellë e Poshtme	Orize	Skënderbeu
Kapaciteti i Llambës	150	150	150	150	150
Numri i Llambave	48	20	12	18	11
Periudha e zbatimit	2021	2021	2021	2021	2021
Investimet totale të përfaqëruara të zbatimit të masave të efijencës së energjisë (€)	21120	8800	5280	7920	4840
Kursimet e energjisë (kWh/vit)	19982	8844	17608	7765	4678
Madhësia e reduktimit të CO ₂ (tCO ₂ /a)	22.38	9.90	19.72	8.70	5.24
Periudha e thjeshtë e vetë-shlyerjes, vite	4.804	4.523	1.363	4.636	4.703

Sektori i dytë i analizuar në detaje me vetë shlyerjen të moderuar të investimeve është sektori i ndërtesave publike, sic tregohet në tabelën 2. Duke rehabilituar pjesën dërmuese (afërsisht 80%) të ndërtesave të këtij sektori në përmjet 8 masave bazike në shumicën e ndërtesave përfitime të rëndësishme arrihen sic edhe janë treguar në tabelën 2. Në tabelën 2 janë dhënë ndërtesat publike komunale që do të jenë prioritet për të zbatuar masat e efikasitetit të energjisë në tre vitet e para të planit të EE.

Tabela 2: Ndërtesat publike komunale që do të jenë prioritet për të zbatuar masat e efikasitetit të energjisë sipas planit të veprimit të EE

Parametrat e ndërtesave publike	1	2	3	4				
Emri i Ndërtesës	Qerdhe "Ganimete Terbeshi"- lokaci "Orize"	Objekte Shkollore SHFMU "Fehmi Agani"	Shkolla e mesme mjeksis "Hysni Zajmi"	Shfmu-Zef Lush MARKU-Brekoc				
Sipërfaqja e ndërtesës	1,320	3,975	3,464	2,004				
Periudha e zbatimit	2019	2019	2019	2019				
Investimet totale të EE (€)	130,258	392,253	341,828	197,755				
Kursimet e energjisë (kWh/vit)	96,888	298,125	259,800	109,138				
Madhësia e reduktimit të CO2 (tCO2/a)	46.841	144.130	125.602	52.763				
Periudha e thjeshte e veteshlyerjes vite	7.96	7.79	7.79	10.72				
Parametrat e ndërtesave publike	5	6	7	8	9	10	11	
Emri i Ndërtesës	Jahe_S alihu_M olliqi	SHFMU "Mazlioni Këpuska" Gjakovë	Shfmu "Ahmet Rrustemi"-Bec	Pallati i Kultures "Asim Vokshi"	Shfmu-Gjergj Fishta-Bishtazhin	Shaban_Golaj_Lipovec	Shfmu "Hazir Ramaj" Kralan	
Sipërfaqja e ndërtesës	2,101	2,636	1,164	4,200	1,236	921	610	
Periudha e zbatimit	2020	2020	2020	2020	2020	2020	2020	
Investimet totale të EE (€)	207,327	260,120	114,864	293,674	121,968	90,884	66,216	
Kursimet e energjisë (kWh/vit)	155,403	197,700	100,896	343,896	153,499	50,158	46,726	
Madhësia e reduktimit tëCO2 (tCO2/a)	75.130	95.579	48.778	166.258	74.210	24.249	22.590	
Periudha e			6.74					

thjeshtë e vetëshlyerjes, vite	7.89	7.79		5.05	4.70	10.72	8.39	
Parametrat e ndërtesave publike	12	13	14	15	16	17	18	19
Emri i Ndërtesës:	SHFMU Ali Hasi_Cermjan	Shfmu_7 Shtatori_Gerçin_e	IP Ganimet e Terbeshi Nr. 2	QMF - 5 Erenik "Gjon Sereql"	QMF_C ermjan	QMF Nr 10_Gjakove	Qmf_Po noshec	Shfmu_Syl ejman Vokshi_Sm olice
Sipërfaqja e ndërtesës	912	964	561	480	224	207	227	471
Periudha e zbatimit	2021	2021	2021	2021	2021	2021	2021	2021
Investimet totale EE (€)	89,996	118,909	60,897	52,104	26,584	26,364	31,181	46,949
Kursimet e energjisë (kWh/vit)	117,475	73,264	41,155	40,608	19,293	15,525	14,703	28,783
Madhësia e reduktimit të CO2 (tCO2/a)	56.794	35.420	19.897	19.632	9.327	7.506	7.108	13.915
Periudha e thjeshtë e vetëshlyerjes, vite	4.53	9.60	8.76	7.59	8.51	10.05	10.16	8.68

Rinovimi termik i ndërtesave Komunale janë ndërhyrje të rëndësishme por me komplekse. Masat në këtë sektor ofrojnë përfitime të shumta në rritjen e komfortit si dhe në kursimet e energjisë e një shtim në jetegjatesinë e ndërtesave publike. Për shkak të kompleksitetit të masave për rehabilitimin e ndërtesave, rekomandohet që të fillohet me disa projekte pilot lehtësisht të zbatueshme në ndërtesat të cilat kanë nevojë urgjente për riparim. Përqasja hap pas hapi në këtë sektor mund të ndihmojë Komunën në përfundimin e experiences dhe kapacitetit të nevojshëm për planifikime në projekte të ardhshme më komplekse e zbatimin e tyre në këtë sektor.

Është e rëndësishme që të theksohet se **për zbatimin e planit aktual të eficientës së energjisë, Komuna duhet të marrë në konsideratë dhe të adresojë disa barrierat.** Fonde prej buxhetit të Komunës me vlerën rreth 150,000-170,000 EURO në vit mund të rialokohen për investime në kursimin e energjisë (i) nga transfertat e pakushtëzuara të shtetit dhe (ii) nga psh operimet e planifikuara dhe kostot e rehabilitimit për ndërtesat publike. Me këtë alokim të buxhetit për investimet në kursimin e energjisë, Komuna e Gjakovës mund të fillojë me disa projekte pilot më të vegjël dhe me profitabilitet më të lartë për projektet pilot në ndricimin e rrugëve dhe rehabilitimin e ndërtesave publike. Përderisa kjo nuk është e mjaftueshme për një projekt me përmasa të mëdha një zbatim hap-pas-hapi i programit të rekomanduar për investim është i realizueshem dhe mund të fillojë me ato investime të cilat gjenerojnë përfitimet më të larta. Në të njëjtën kohë, përshtatjet rregullatore duhet të konsiderohen nga autoritetet Qeverisë Qendrore për të mundësuar rritjen e investimeve në EE nëpërmjet vënies në zbatim të fondit të eficientës së energjisë dhe bashkëpunimit me donatore të ndryshëm. Kompania e Ngrohjes Qendrore në Gjakovë ("NQ – Ngrohja e Gjakovës") (Kosovë), ka filluar të operojë në vitin 1982, dhe ka qenë e projektuar për të furnizuar shtëpitë me një sipërfaqe rreth 100.000 m², ndërtesa komerciale me sipërfaqe totale rreth 12.000 m² dhe ndërtesa publike në sektorin publik me rreth 80.000 m² afër zones. Megjithatë se nuk janë realizuar shumë investime gjatë shumë viteve, DH Gjakova ka siguruar shërbimin e ngrohjes bazuar më shumë në punën e madhe dhe ekspertizën e stafit. Gjithashtu, duhet theksuar se tarifa nuk mbulon koston dhe nuk

mbulon as inflacionin dhe meqenëse kemi pasur një rritje të vazhdueshme të energjisë elektrike, situatë financiare e DH Gjakova sot ka nevojë për një përmirësim shumë të madh. Që nga mesi i viteve 90s DH Gjakova ka operuar me humbje financiare dhe vlera e humbjeve të akumuluar është rritur në mënyrë shumë të madhe. Për pasojë, kthesa financiare për DH Gjakova me qëllim bazë rritjen e kursimit dhe shtimin e të ardhurave është me një urgjencë të madhe.

Impianti/Sistemi i Ngrohjes së Përqendruar (DH - Ngrohtores) të Gjakovës është projektuar të operojë me mazut, çmimi i të cilit është rritur në mënyrë të ndjeshme në vitet e fundit duke e bërë operimin e këtij centrali jo ekonomik dhe me humbje të mëdha financiare. Të gjithë indikatorët shprehen se tendenca e rritjes së çmimit të nënprodukteve të naftës (përfishi edhe mazutin) do të vazhdojë edhe me shumë në të ardhmen. Aktualisht kompania nuk operon me kapacitet të plote duke pasur parasysh koston shumë të lartë të lëndës djegëse. Kapaciteti i centralit 17 MW (i përbërë prej 8 MWth-CHP, 7 MWth HOB dhe 2 MWth HOB, që të dyja do të punojnë me lëndë djegëse e biomase) ndërkohë që centrali aktualisht operon me një kapacitet 20 MW. Rihabilitimi i sistemeve të Ngrohjes Qendrore në Gjakovë do të kërkojë investime të mëdha në instalimet kapitale intensive, jo vetëm në njësitë e prodhimit të ngrohjes me shpenzime më të ulta krahasuar me njësitë aktuale, por gjithashtu edhe në tubacionet e transmetimit dhe shpërndarjes të ndërtuara dhe ruajtura mirë. Rihabilitimi i sistemeve të Ngrohjes Qendrore në Gjakovë, do të ndikojë në shumë aspekte të shoqërisë, siç është: i) përdorimi racional i energjisë; mbrojtja e mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar, si pasojë edhe ndërkombëtar, iii) bilanci i pagesave, iv) shërbimet prodhuese; v) zhvillimi i punësimit dhe zhvillimi demografik dhe vi) rritje të mirëqenies në aspektet e shëndetësisë dhe arsimit.

Llogaritjet ekonomike për të arsyetuar skemat e CHP (koogjenerimi) dhe NQ-së, janë bërë në mënyrë të detajuar. Kushtet më të favorshme për financimin dhe riabilitimin e Skemave të Ngrohjes Qendrore janë gjetur në shërbimet (infrastrukturën) e cila është ndërtuar gradualisht përgjatë shumë viteve. Lidhjet e detyrueshme në sistemet kolektive ekzistuese, shpesh janë të detyrueshme vetëm për ndërtesat që gjenden në zonat e reja. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është që ta përmirësojë furnizimin me ngrohje për konsumatorët rezidencial, privat dhe publik të Komunës së Gjakovës përmes riabilitimit të Sistemit të NQ-së në Gjakovë, bazuar në ndryshimin e lëndës djegëse nga mazuti në biomasë (mbetjet bujqësore apo mbetjet e drurit). Për riabilitimin e planifikuar të sistemit të NQ në Gjakovë dhe tubacionet e bartjes së ngrohjes dhe nënstationin përkatës nga ndërtimi i centralit në një vend të ri 1.2 km larg atij ekzistues si dhe ato negative dhe paraqet vecanerisht ndikimet pozitive potenciale në mjedis nëpërmjet kalimit nga mazuti në biomasë dhe rekomandon masat për parandalimin, zvogëlimin, zbutjen apo kompensimin e ndikimeve të pafavorshme duke përmirësuar kështu performancën mjedisore.

2. INFORMACIONE BAZË RRETH KOMUNËS

2.1. POZICIONI GJEOGRAFIK

Komuna e Gjakovës është në procedurë të fillimit të hartimit të Planit zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale Komunale. Ky Plan do të bazohet në këto parime kryesore:

- Zhvillimi i rrjetit të fuqishëm urban për zhvillim ekonomik. Shumica e zonave urbane janë përmirësuar dhe është themeluar rrjeti i infrastrukturës ndërmjet vendbanimeve të vogla dhe të mëdha. Kujdesi shëndetësorë dhe edukimi u është ofruar qytetarëve, bujqësia dhe industria e lehtë është përkrahur në zonat rurale, industria e rëndë është rehabilituar, tregtia dhe turizmi janë përkrahur.
- Zhvillimi dhe ruajtja e burimeve natyrore.
- Mbrojtjen dhe shfrytëzimin: të mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe natyrore, kualitetin e tokës bujqësore, burimet minerale, dhe kontrollimi i zhvillimit të vendbanimeve.
- Zhvillimi i lidhjeve strategjike.

- Integrimin në rrjetin rajonal dhe Evropian të transportit (TEN-T),
- përmirësimin e nevojave të transportit në Kosovë, furnizim të qëndrueshme me energji elektrike, furnizim me ujë për familjarët dhe industrinë

Zhvillimi social, ekonomik dhe kulturorë po zhvillohet mbi bazën e modernizimit të ekonomisë me teknologji të re, Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) dhe njohurive të reja. Pozita e mirë gjeografike duhet të shfrytëzohet për të marr përfitimet dhe për të udhëheqë me investimeve drejt zhvillimit të turizmit, industrisë dhe shërbimeve. Duhet të zhvillohet dhe thellohet një rrjet koordinues i bizneseve, me rritje dinamike të punësimit, sistem edukativ bashkëkohor, duke i plotësuar nevojat e biznesit të komunës. Qëllimet për rajonin e Gjakovës janë:

- Përmirësimi i një administrimi lokal e më efikase,
- Zhvillimi i tregtisë ndërkuftare dhe koordinimi i shërbimeve me Shqipërinë, dhe më tej në portin detar të Shëngjinit, përmes pikës kuftare në Morinë,
- Për ta përkrahur tregtinë dhe shërbimet me lidhje të shpejta me qytetet tjera brenda Kosovës si dhe jashtë saj, duhet të zhvillohet një infrastrukturë rrugore, hekurudhore, ajrore,
- Zhvillimi i Aeroportit të Gjakovës për përdorim ekonomik, civil dhe shërbime,
- Zhvillimi i industrive bujqësore dhe industrisë së materialit ndërtimor,
- Mbështetje për edukim modern, përkrahe të kërkesave të tregut,
- Mbrojtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore, turizmit kulturor dhe rekreativ,
- Mbrojtja dhe krijimi i mjedisit pa zhurmë dhe ekologjik

Pika e planit hapësinor jashtë zonave të caktuara në Gjakovë, të cilat janë me interes të veçanët për tërë Kosovën, janë:

- Aeroporti i Gjakovës,
- Gryka e Drinit dhe Ura e Shenjët,
- Parku Kombëtarë "Alpet Shqiptare",
- Akumulimi i Liqenit të Radoniqit,
- Çarshia e Madhe,
- Kullat,
- Kufiri që kryqëzohet me Shqipërinë.

Komuna e Gjakovës, sikurse e gjithë Kosova, gjatë këtyre 20 viteve të fundit nuk ka pasur një zhvillim në vazhdimësi normal për shkak të problemeve politike si dhe luftës për çlirim. Përcaktimi i sipërfaqeve të planifikuara, ndërtuara si dhe ndërtimeve ilegale nuk ka mundur të bëhet duke marrë parasysh këto rrethana. Është detyrë permanente për të bërë analiza të tilla. Komuna ka modelin mjaft të qartë të zhvillimit të vendbanimit, me përqendrim në luginën e lumit. Zona më e banueshme është në luginën e lumit Krena, përgjatë rrugës kryesore ndërmjet Gjakovës dhe Deçanit. Shumica e fshatrave përgjatë kësaj rruge p.sh. Skivjan dhe Dujakë, praktikisht janë periferi të qytetit të Gjakovës.

Aksi i dytë i vendbanimit kalon përgjatë lumit Erenik nga Juniku për në Gjakovë, dhe më tej në drejtim të Prizrenit për Xërxë dhe Rogovë. Gjithashtu ekzistojnë shumë vendbanime në zonën jugore përgjatë Drinit të Bardh dhe zonës së Hasit në kufij me komunën e Prizrenit. Shumica e zonave malore në mesë janë jashtëzakonisht rrallë të banuara.

Shumica e vendbanimeve janë ndërtuar në mënyrë të shpërndarë. Disa nga fshatrat e vjetra kanë zanafillën historike, shpeshherë janë të përqendruara përreth një xhamie ose një kisha, por vendbanimet e reja tentojnë që të zgjerohet në tokën bujqësore. Kjo tendencë është më e shprehur në periferitë e qytetit të Gjakovës. Edhe lugina e Erenikut është duke u zhvilluar në këtë drejtim. Qyteti i vjetër i Gjakovës, shtrihet pranë brigjeve të lumit Krena, në fund të kodrës së Çabratit. Qendra e qytetit të vjetër është pazari i madh duke u shtrirë në drejtim të veri-jugut në anën perëndimore të lumit. Pjesa dërmuese e pazarit ishte shkatërruar gjatë luftës së vitit 1999, por rindërtimi është bërë duke e ruajtur stilin e mëparshëm. Qyteti i vjetër është i dominuar nga struktura e vogël dhe e dendur e ndërtesave dhe rrugicave të ngushta.

Komuna shtrihet në pjesën jugperëndimore të fushëgropës së Rrafshit të Dukagjinit, në mes të rrugës Prizren-Pejë. Nëpër këtë vendbanim kalonte në të kaluarën një pjesë e rrugës Via de Zenta, e cila fillonte nga Shën Gjini në Detin Adriatik, vazhdonte nëpër qytetin e Shkodrës e luginës së lumit të Drinit të Bardhë në drejtim të Prizrenit dhe më tutje drejt lindjes në Nish, në Sofje dhe në Konstantinopojë. Te Vau i Spasit kjo rrugë ndahej në dy drejtime: njëri vazhdonte drejt Prizrenit, ndërsa tjetri nëpër luginën e Krumës, anës së djathtë të Drinit të Bardhë, fshatit Letaj dhe Qafës së Prushit arrinte në Gjakovë dhe në Pejë.

Gjakova shtrihet midis gjerësisë gjeografike 42.22 dhe gjatësisë gjeografike 20.26 në bregun e majtë të lumit të Erenikut, në lindje të pllajës së Çabratit, në të dy anët e lumit Krena, në një lartësi mbidetare mesatare prej 365 metrash. Në jugperëndim të Gjakovës shtrihën rrëzët e fundit të maleve të Sharit, ku shtrihet krahina kodrinore e Hasit, e cila përfundon me rrafshinën aluviale (lumore) të Erenikut. Në veri të qytetit shtrihën fushat neogjene të Piskotës dhe të Dushkajës. Sukat e Koznikut, të Cërmjanit, të Babajloqit dhe të Hereçit e ndajnë fushëgropën e Gjakovës nga Rrafshi i Dukagjinit. Në perëndim të Çabratit, që ka një lartësi mbidetare prej 440-460 metrash, shtrihën malet e Junikut dhe të Shkëlzenit-pjesë të Bjeshkëve të Nemuna (Alpeve Shqiptare). Në lindje të Gjakovës, aty ku derdhet Ereniku në Grykën e Drinit të Bardhë shtrihët pllaja gëlqerore e Gradishës, e cila e ndanë fushëgropën e Gjakovës prej asaj të Prizrenit. Malet e ulta me qafa siç janë Qafa e Prushit, ajo e Dobrunës, ajo e Morinës etj., kanë mundësuar ndikimin e erërave të Detit Adratik nëpër luginën e Drinit. Prandaj Gjakova me rrethinë ka klimë të mesme kontinentale me elemente të asaj mesdhetare me verë të nxehtë dhe të thatë (figura 1).




Figura 1: Kufijtë e zonës urbane të Gjakovës

2.2. KLIMA

Në pikëpamje hidrografike, rajoni i Gjakovës është i pasur. Rrjedhat ujore të rajonit më të gjerë të qytetit i përbëjnë lumi i Gjakovës, Erenikut, Lloçanit dhe Deçanit, që së bashku derdhen në Drinin e Bardhe me disa përrenj të përhershëm dhe periodikë. Gjakovës. Temperatura mesatare vjetore është 12.50C kurse për nga lartësia e të reshurave, Gjakova ka mesatarisht 1190 mm reshje vjetore. Sipas një harte dixhitale të llojeve të tokës (shkalla 1:50 000) të ofruar nga Instituti i Shkencave të Tokës të Universitetit të Gjakovës (Elezi et al. 2004) dhe duke iu referuar klasifikimit WRB-tokës (IUSS Grupi Punes WRB, 2006), llojet më të shpeshta të tokës në fusha për zonën e Gjakovës janë toka humurore të tipit fluvisols. Në zonat kodrinore janë të përhapura vertisols, cambisols dhe regosols. Në përgjithësi, tokat bujqësore janë modifikuar në mënyrë të konsiderueshme. Sidomos ujëta (kryesisht në Gjakovë) dhe ndryshimi i tokës janë faktorët vendimtarë që kanë ndikuar në proceset pedogjenetike për shumicën e shekujve. Gjakova posedon toka të ndryshme, edhe pse territori i saj është i vogël. Ky është rezultat i strukturës së peizazhit, bazës gjeografike, flores, klimës dhe hidrografisë. Është vlerësuar se 15% e tokës në Gjakovë është e cilësisë së lartë, 56% është e cilësisë së mesme, dhe 29% është e cilësisë së dobët. Ato përbëhen nga toka humus (11%) që është shpërndarë kryesisht në rrafshnaltë në Gjakovë, toka gri karbonat (8,4%), aluviale (7,8%) dhe toka të tjera të errëta dhe prej gjarpri. Tokat e cilësisë së dobët (varfer) janë kryesisht të përcaktuara në zonat kodrinore dhe malore. Ato përbëhen nga tokat acide gri, tokat diluviale, kënetat dhe toka të tjera jopjellore. Tokat pjellore kanë humbur nga ndërtimet e shtëpive dhe rrugëve, plasjes së minave dhe ndërtimeve të tjera dhe rreth 10-15% e tokës bujqësore të Gjakovës është tokë ugar (pasive) (Mehmeti et al., 2009). Temperatura mesatare e muajit korrik është 21.5 0C, ndërsa e janarit -9 0C. Muajt e verës janë të thatë, ndërsa të dimrit më lagësht. Mesatarja e reshjeve atmosferike është 959,3 mm. Fushëgropën e Gjakovës e përshkojnë 80 rrjedhje të ujërave sipërfaqësore që burojnë në veri nga vargu malor i Çermjanit dhe nga kurorat malore në jug të qytetit. Të 80 projektet derdhen në Erenik, i cili, me degët e tij, e ujiste fushën pjellore të Gjakovës. Trava dhe Trakaniqi janë dy lumenj tipikë fushorë që derdhen në Erenik. Reshjet mesatare mujore dhe vjetore në stacionet meteorologjike të Gjakovës janë paraqitur në figurën 2.




Figura 2: Rreshjet mesatare në zonë n e Gjakovës (mm shi)




Figura 3: Shpejtësia mesatare e erës mujore në drejtim të ndryshëm në rajonin e Gjakovës

Analiza e parametrave të erës në Gjakovë është bërë mbi bazën e matjeve të realizuara në stacionin meteorologjik të Gjakovës dhe është treguar në figurën 3. Temperaturat mesatare mujore dhe vjetore të ajrit për rajonin e Gjakovës janë paraqitur në figurat 4 & 5.




Figura 4: Temperatura mesatare e ajrit në Gjakovë




Figura 5: Temperaturat më të larta, mesatare dhe më të ulta të ajrit në Gjakovë

2.3. POPULLLSIA DHE BANIMET

Zhvillimi i popullsisë bazohet në dy komponentë: shtimi natyror dhe migrimi. Këto komponentë mund të kenë efekte pozitive dhe negative. Zhvillimi natyror i popullatës mund të vlerësohet saktësisht nën kushtet e vazhdueshme të shkallës së lindjeve, që kohë pas kohe ndryshon. Në Kosovë megjithatë, koha e luftës dhe procesi i migrimit i detyruar nga lufta, ka lënë gjurmë në piramidën e popullsisë që tregon një zbritje të moshave të mesme të popullsisë dhe zbritje të shkallës së lindjeve. Zvogëlimi i shkallës së rritjes mund të realizohet në piramidën e popullsisë së Kosovës nga grup-moshat prej njëzet vjet tatëpjetë. Edhe më tej procesi i migrimit i detyruar nga lufta ka rezultuar i pasigurt në numrin e popullsisë banuese. Një numër i konsiderueshëm i refugjatëve që kishin lëshuar Kosovën për të shkuar jashtë saj është kthyer, por është e dyshimtë se ku do të gjejnë vendin e tyre për të qëndruar në Kosovë. Pasiguritë e tilla, megjithatë shpresojmë se do të zgjidhen kur të definohet dhe garantohet statusi final i Kosovës.

Komuna e Gjakovës ka rreth 95.340 banorë në baze të regjistrimit të regjistrimit 2011. Madhësia mesatare e familjes është rreth 6,27 anetarë për familje, pak më të vogla se mesatarja e Kosovës. Si një territor, komuna e Gjakovës zë një sipërfaqe prej 587 km² dhe rrjedhimisht dendësi e popullsisë është në një mesatare prej rreth 259 banorë për km². Më të shumtë në numër janë meshkujt, të cilët përfaqësojnë rreth 50,9% të popullsisë së përgjithshme. Sipas përkatësisë etnike, komuna e Gjakovës është e banuar nga popullsia shqiptare dhe minoritetet etnike përfaqësojnë vetëm një numër të vogël të popullsisë së kësaj komune. Plani i fundit urban i Gjakovës, i njohur si "Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban i Gjakovës" (2006-2015+), është hartuar për popullsinë prej përafërsisht 153.000 banorëve (figura 6). Nga këto, rreth 40 % jeton në zonat rurale, ndërsa 60 % jeton në qytet. Në vitin 2030, kjo kërkon një Perspektivë të II, të skenarit të projeksionit demografik të 190.000 banorëve. Ky vlerësim është bazuar në shtimin natyral prej 9,5% dhe një nivel emigrimi i cili shkon mesatarisht rreth 250 persona në vit, kështu që shtimi natyral për Gjakovën do të jetë rreth 37.000 banorë (gjate gjithë kësaj periudhe).




Figura 6. Plan i Zhvillimit Urban te Gjakovës
(Burimi: Plani Urban Strategjik i Komunes së Gjakoves)

Përkundër ndryshimeve të shumta administrative të ndarjes së qytetit, tek vendasit dominon ndarja e qytetit në lagje sipas vetive në kohëra të caktuara apo themeluesve të tyre:

- Mëhalla e Hadumit - lagja me e vjetër, vendthemelimi i qytetit.
- Mëhalla e Cullakëve
- Mëhalla e Haxhi Ymerit
- Mëhalla e Gerqarve
- Mëhalla e Geces
- Mëhalla e Qylit
- Mëhalla e Honkes
- Mëhalla e Sefes
- Mëhalla e Mulla Jusufit
- Orize
- Blloku i Ri

Komuna e Gjakovës shtrihet në mes të kodrës së Çabratit në perëndim, përroit Llukac në lindje dhe lumit Erenik në jug dhe jug-perëndim. Përroi Krena e përshkon përmes qytetit. Sipas nenit 8 të status projektit komunës së Gjakovës, territori i kësaj komune ka këto vendbanime (në zonen rurale):

Bardhaniq	Bardhaniq	Gërquinë	Moglicë	Rogovë
Batusha	Batusha	Gërgoç	Morinë	Rracaj
Beci	Beci	Goden	Molliq	Rrypaj
Berjah	Berjah	Guskë	Nec	Madanaj
Bardosan	Bardosan	Hereq	Nivokaz	Skiqjan
Bishtazhin	Bishtazhin	Jabllanicë (Shqiponjë)	Novosella Epërme	Smaq
Bitesh	Bitesh	Jahoc	Novosellë Poshtme	Smolic
Brekoc	Brekoc	Janosh	Osek Hyla	Sopot
Brovinë	Brovinë	Kodralli	Osek Pasha	Sheremetaj
Cërmjan	Cërmjan	Korenicë	Pacaj	Shishmani i

				Bokës
Dallashaj	Dallashaj	Koshare	Palabardhë	Shishmani Rrafshit
Demjan	Demjan	Kralan	Pjetërshan	Ujëz
Devë	Devë	Kusar	Planqor	Trakaniq
Doblibare	Doblibare	Kushavec	Ponoshec	Vogovë
Dobrixhe	Dobrixhe	Lipovec	Popoc	Vraniq
Dobrosh	Dobrosh	Llugagji	Raqa	Zhabel
Dol	Dol	Guskë	Qerim	Zhdrellë
Dujaka	Dujaka	Marmull	Rakoc	Zhub
Duzhnje	Duzhnje	Meje	Rakovinë	Zylfaj
Firajë	Firajë	Orize	Ramoc	
Firzë	Firzë	Meqe	Rashkoc	

2.4. STRUKTURA ORGANIZATIVE

Komuna e Gjakovës funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040), Statutit dhe akteve të tjera nënligjore. Ky ligj ka për qëllim ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale dhe të përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve publike në të gjitha komunat në Republikën e Kosovës. Neni 2.1 i këtij ligji përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndër komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror. Komunitat i ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të bashkëpunimit dhe të ndarjes së pushteteve: kompetencat vetjake, kompetencat e deleguara, dhe kompetencat e zgjeruara, në përputhje me ligjin. Komunitat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislativonin e zbatueshëm. Kuvendi i Komunës së Gjakovës është organi më i lartë në komunë, i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale. Organigrami i Komunës së Gjakovës tregohet në figurën 7.

ORGANOGRAMI I KOMUNËS - GJAKOVË




Figura 7: Organogrami struktural i Komunës së Gjakovës

Ky Plan i Eficiencës së Energjisë për Komunën e Gjakovës është zhvilluar nga EECG në bashkëpunim me departamentet e Komunës dhe mbështetjen financiare të GIZ. Projekti i GIZ fokusohet në përmirsimin e infrastrukturës Komunale të Gjakovës.

2.5. TREGUESIT EKONOMIK DHE FINANCIAR

Procesi i Diagnostifikimit të Eficiencës së Energjisë filloi me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave në Qershor 2018 dhe u mbështet nga Komuna e Gjakovës si dhe departamentet e shërbimeve komunale.

Të dhënat determinuese për identifikimin dhe priorizimin e sektorëve janë të dhënat e shpenzimeve Komunale për energji, potenciali i kursimeve të energjisë dhe niveli i autoriteteve Komunale mbi buxhetet sektoriale dhe fuqia rregulluese dhe zbatuese për masat e eficiencës së energjisë.

Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe intervistat, u kompilua një listë e gjatë me rekomandime për potencialet sektoriale të eficiencës së energjisë sipas nevojave të Komunës së Gjakovës. Këto rekomandime janë dhënë në detaje në këtë Plan të EE për Komunën e Gjakovës.

Planin i rekomanduar të Eficiencës së Energjisë (a) reflekton



nevojat me një set reflektimesh dhe ndërhyrjesh.; (b) analizon potencialet e efikasitetit të energjisë dhe përfitimet sipas një liste të përzgjedhur të masave të efikasitetit të energjisë dhe investimeve dhe (c) paraqet një strategji zbatimi të planit të efikasitetit të energjisë. Tabela 3 paraqet buxhetin e komunës së Gjakovës për vitin 2018 dhe analiza e saj tregon në mënyrë të qartë këto konkluzione:

1. Komuna e Gjakovës ka futur dy linja shumë të rëndësishme në buxhetin e saj: linjen për investimet për EE në ndërtimet publike komunale dhe linjen për investimet për EE në ndriçimin rrugor publik.
2. Vlera e investimeve të efikasitetit të energjisë të barabarta me 168,884 € është 2.38% përkundëjt vlerës totale të investimeve (të barabarta me 6,959,968 €).
3. Vlera e shpenzimeve energjetike për të gjithë shërbimet komunale është 303,455 € dhe kjo vlerë është 3.442% përkundëjt vlerës totale të shpenzimeve (të barabarta me 8,815,959 €).

Tabela 1. Buxheti i komunës së Gjakovës për vitin 2018

Gjakovë	2018 në €	
Buxheti total	Planifikuar	23,266,602 €
	Realizuar	23,199,892 €
1. Totali i faturave të energjisë	1. Totali (2+3+4) = 303,455 €	
2. Objekte publike – (shpenzimet për burimet energjetike për ngrohje, përfshi energjinë elektrike)	2. Totali (2.1+2.2+2.3)	120,522 €
	2.1 Energji elektrike	23,500 €
	2.2 Lende djegëse	74,822 €
	2.3 Ngrohje përqendruar	22,200 €
3. Shpenzimet për ndriçimin publik	163,337 €	
4. Shpenzimet për flotën komunale të automjeteve (karburant për automjete)	19,596 €	
5. Totali i investimeve për EE në Komune	5. Totali Investimeve (5.1+5.2) = 168,884.2 €	
5.1 Investime në masa të EE në ndërtimet publike	93,852.95 €	
5.2 Investime i rrjetit të ndriçimit publik	75,031.20 €	

Në vijim janë dhënë investimet e realizuara në masat e EE në periudhën 2016-2018 në komune.

Investimet	Vlera e Investimeve në Euro në vit			
	Viti	2016	2017	2018
24, 6, 9 ndertesa janë përmirësuar nga ana e EE respektivisht në vitet 2016, 17 dhe 18		224,440.42	90,525.49	93,852.95
913, 1013, 376 llamba LED për ndriçim rrugor janë instaluar nga ana e EE respektivisht në vitet 2016, 17 dhe 18		94,988.00	77,274.70	75,031.20
Totali i investimeve për EE në Komune		319,428.42	167,800.19	168,884.15

2.6. POLITIKAT ENERGETIKE RELEVANTE SHITETËRORE DHE LOKALE

Zhvillimi i programit të efikasitetit të energjisë është bazuar në analizën e të dhënave Komunale për energjinë për vitin bazë 2017 dhe parashikon një periudhë zbatimi nga 2017 deri në 2030. Periudha e zbatimit është zgjedhur në përputhje me (i) Planin Komunal për

Zhvillimin e Gjakovës deri në 2030 dhe (ii) Planin e EE të Kosovës dhe (iii) Strategjinë e Energjisë të Kosovës. Ligji aktual i EE i kërkon Komuneve të Kosovës të a) përgatisin planet Komunale për efikasitetin e energjisë dhe të përcaktojnë një departament për energjinë. Është Dokumenti aktual i hartimit të planit Komunal për efikasitetin e energjisë për Komunën e Gjakovës kontribuon në çelësimin e këtyre detyrimeve.

Për më tepër, Plani Komunal i EE për Komunën e Gjakovës mund të krijojë vulltin e nevojshëm për arritjen e targeteve të BE-së në lidhje me energjinë dhe klimën tek nivelet lokale duke marrë pjesë në Konventën e Komunitetit Europian për Nismën e Kryetareve Komunal (CoM). Pjesë marrja në CoM mund të rrisë mundësitë që Komuna e Gjakovës të shkëmbejë eksperiencë, të përfitojë njohuritë e duhura, të ndërtojë kapacitete si dhe të marrë mbështetje financiare nga programet e paraanëtarësimit në BE për realizimin e investimeve të nevojshme në fushën e EE.

2.7. EKSPERIENCA NË ZBATIMIN E MASAVE TË EFIÇENCËS SË ENERJISË

2.7.1. KAPACITETI NË ZBATIMIN E PROJEKTEVE TË EFIÇENCËS SË ENERJISË

Komuna e Gjakovës ka një eksperiencë bazë për zbatimin e projekteve të efikasitetit të energjisë, eksperiencë të cilën e ka fituar nëpërmjet realizimit të disa projekteve:

1. Futjen e masave të efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike nëpërmjet fondeve të Qeverisë Qendrore dhe fondeve të vetë Komunës;
2. Futjen e masave të efikasitetit të energjisë në transportin e pasagjerëve nëpërmjet fondeve të Qeverisë Qendrore dhe fondeve të vetë Komunës;
3. Futjen e masave të EE në ndërmarrjet e furnizimit me ujë, mbledhjen e mbetjeve urbane nëpërmjet fondeve të Qeverisë Qendrore dhe fondeve të vetë Komunës;
4. Krijimin e sektorit dhe stafit të Managjerit të EE në komunën e Gjakovës.

3. FURNIZIMI ME ENERJJI, PRODHIMI DHE SHPËRNDARJA

3.1. FURNIZIMI ME ENERJJI

3.1.1. ENERJIA ELEKTRIKE

3.1.1.1. Furnizimi me energji elektrike

Problemi i furnizimit me energji elektrike në Kosovë e ka gjenezën në shkatërrimin e qëllimshëm të sistemit të energjisë elektrike, në të gjitha elementet e tij nga regjimi pushtues, veçanërisht në vitet e 90-të. Që nga viti 1984 nuk ka pasur ndërtime të kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, me përjashtim të disa kapaciteteve të vogla hidrike, por që nuk kanë pasur ndikim në zgjidhjen e problemit të sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Aktualisht shumica e blloqeve të termocentraleve janë në fundin e jetës teknike të tyre.

Me gjithë problemet dhe vështirësitë me të cilat është përballur sistemi i prodhimit të energjisë elektrike, në 15 vitet e fundit ka pasur rritje të vazhdueshme në prodhimin e energjisë elektrike, me përjashtim të vitit 2014. Në figurat 8-9 është paraqitur konsumi i energjisë sipas gjithë sektorëve ekonomikë në nivel të Kosovës dhe për Komunën e Gjakovës për të pasur një krahasim ndërmjet tyre.




Figura 8: Konsumi i energjisë sipas gjithë sektoreve ekonomik në nivel të Kosovës

Burimi: Mbështetja në zbatimin e paketës të tretë të energjisë me fokusim në EE dhe BRE Europeaid/136562/dh/ser/xk




Figura 9: Konsumi i energjisë sipas gjithë sektorëve ekonomik në nivel për Komunën e Gjakovës

Analiza tregon se sektori i Avisnise paraqet konsumin më të lartë me 40.50%, ndjekur nga sektori i transportit me 23.21%, industrisë dhe me një kontribut më të vogël sektori i shërbimeve me 13.01%. Shërbimet publike në Komunën e Gjakovës janë pjesë e sektorit të shërbimeve (që përfshin shërbimet publike dhe shërbimet private).

3.1.1.2. Shpërndarja e energjisë elektrike

Në vitet e mëparshme, mbulimi i kërkesave për energji elektrike është bërë në masën dërmuese nga prodhimi vendor dhe një pjesë nga importi. Në situata kryesisht të tejngarkesave të sistemit elektroenergjetik dhe/apo mungesës së energjisë nga importi në disponim me çmim të arsyeshëm atehere ka pasur reduktime të planifikuara (sipas planit ABC). Reduktimet janë anuluar ë vitet e fundit për arsye të rritjes së prodhimit vendor, rritjes së importit dhe fillimit të kursimit të energjisë, sidomos në sektorin familjar.

Prej vitit 2000 deri në vitin 2018 janë shpenzuar mbi 600 milion euro për importin e energjisë elektrike. Në disa raste ka pasur ndërhyrje të Qeverisë për subvencionimin e importit, që nga viti 2012 janë ndërprerë subvencionimet për import. Pas privatizimit të kompanisë për shpërndarje dhe furnizim të energjisë elektrike, kostoja e importit të energjisë elektrike ka rënë ndjeshëm, veç tjerash edhe si pasojë e procedurave më efikase të blerjes së energjisë elektrike.

Kapacitetet infrastrukturore të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike nuk kanë mundur të përcjellin në masën e duhur rritjen e kërkesës, si pasojë, në radhë të parë, e investimeve të pakta në rrjetin shpërndarës. Për pasojë sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike është tej ngarkuar vazhdimisht, veçanërisht gjatë sezonit të dimrit. Në maj të vitit 2013 sistemi i shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike ka kaluar në pronësi private. Në fund të vitit 2014 ka përfunduar procesi i shturjes ligjore të OSSH-së nga aktiviteti i furnizimit. Në vitet e fundit, sidomos pas privatizimit të rrjetit të shpërndarjes, janë bërë investime mjaft të mëdha në rrjetin e shpërndarjes (rreth 20 milion euro në vit) dhe vazhdohet të investohet në projekte të planifikuara nga KEDS. Pavarësisht përmirësimeve në vitet të fundit, humbjet teknike dhe komerciale në vitin 2015 kane qenë 31.8 %. Për shkak të pamundësisë për të kontrolluar sistemin e shpërndarjes dhe furnizimit në disa komuna në veri të Kosovës ngelet e pafaturuar një sasi e energjisë elektrike në masën rreth 5% të të gjithë sasisë së energjisë elektrike me të cilën ngarkohet sistemi i shpërndarjes. Një tregues

pozitiv është fakti se Furnizuesi public (KESCO) ka arritur të përmirësoj në vazhdimësi performancën.

Hallka më e shëndetshme e sistemit të energjisë elektrike është sistemi i transmetimit. Falë investimeve të mëdha në këtë sistem sot konsiderohet një nga sistemet më efikase dhe më të qëndrueshëm në rajon. Por, për fat të keq për shkaqe politike si pasojë e mos anëtarësimit të KOSTT-it në ENTSO-E ai kryen aktivitete të kufizuara për shkak të pamundësisë për të kontrolluar rrjedhat ndërkufitare. Kësisoj, kjo ka vazhduar të jetë sfidë në vijim për të kryer me sukses të gjitha detyrat obligative operacionale si operator i sistemit të transmetimit në territorin e vet, derisa formalisht akoma trajtohet si një përgjegjësi e palës së tretë.

Në figurat 10-11 është paraqitur konsumi i energjisë elektrike sipas gjithë sektoreve ekonomike në nivel të Kosovës dhe për Komunën e Gjakovës për të pasur një krahasim ndërmjet tyre.




Figura 10: Konsumi i energjisë elektrike sipas gjithë sektoreve ekonomike në nivel të Kosovës

Burimi: Mbështetja në zbatimin e paketës së tretë të energjisë me fokusim në EE dhe BRE Europeaid/136562/dh/ser/xk




Figura 11: Konsumi i energjisë elektrike sipas gjithë sektoreve në nivel për Komunën e Gjakovës

Analiza tregon se sektori i Avisnisë, si për Kosovën ashtu edhe për Komunën e Gjakovës, paraqet konsumin më të lartë të energjisë elektrike (me 56.13%), ndjekur nga sektori i industrisë (me 18.54%) dhe me një kontribut jo të vogël edhe nga sektori i shërbimeve (me 15.71%).

3.1.2. NËN PRODUKTET E NAFTËS

Në Kosovë nuk ka prodhim të naftës dhe gazit natyror. Në Kosovë, gjithashtu nuk ka rafineri naftë dhe duhet theksuar se nën produktet e naftës zënë një pjesë të rëndësishme të furnizimit të burimeve energjetike në nivel vendi dhe në nivel komune. Gjithashtu, në Komunën e Gjakovës nuk ekziston asnjë rafineri apo prodhim naftë dhe gaz natyror. Ndërkohe, ashtu sic edhe në të gjithë Kosovën, edhe në territorin e Kosovës ekzistojnë pika të shumta të furnizimit me nënprodukte të naftës. Në figurat 12-13 është paraqitur konsumi i të gjithë burimeve të energjisë sipas gjithë sektoreve ekonomike në nivel të Kosovës dhe për Komunën e Gjakovës për të pasur një krahasim ndërmjet tyre.




Figura 12: Konsumi i burimeve të energjisë në nivel të Kosovës




Figura 13: Konsumi i burimeve të energjisë në nivel për Komunën e Gjakovës

Burimi: Mbështetja në zbatimin e paketës të tretë të energjisë me fokusim në EE dhe BRE Europeaid/136562/dh/ser/xk

Analiza tregon se nënproduktet e naftës paraqesin konsumin/kontributin më të lartë të si në nivel të Kosovës ashtu edhe në nivel të Gjakovës (me 34.06%), ndjekur nga biomasat (me 36.86%) dhe nga energjia elektrike dhe me një kontribut jo të vogël (me 24.86%).

3.1.2.1. Thëngjill

Kosova posedon rreth 12.5 miliard tona të linjtit si rezerva gjeologjike, duke vendosur Kosovë në vendin e dytë në Evropë dhe në vendin e pestë në botë me këto rezerva. Linjiti është resursi më i rëndësishëm energjetik i Kosovës, i cili furnizon 97% të prodhimit total të energjisë elektrike (TC "Kosova A" dhe TC "Kosova B"). Në figurën 14 janë paraqitur basenet e linjtit në Republikën e Kosovës nga Basenet: i) Fushe-Kosovës; ii) Dukagjinit dhe iii) Drenicës.



Figura 14: Basenet e linjtit/thëngjillit në Kosovë

Resurset e vlerësuara të linjtit në gjithë Kosovën janë dhënë në tabelën 4.

Tabela 4.: Rezervat e linjtit në Republikën e Kosovës

Basenet e linjtit	REZERVAT (ton)		
	Gjeologjike	Bilance	Jo bilance
Kosovës	10,091,000,000	8,772,000,000	1,319,000,000
Dukagjinit	2,244,830,000	2,047,700,000	197,130,000
Drenicës (f. Skenderaj)	106,631,000	73,188,000	33,443,000
Gjithsej	12,442,461,000	10,892,888,000	1,549,573,000

Hapja e mihjes së re do të sigurojë furnizim të sigurt dhe të mjaftueshëm për kapacitetet ekzistuese dhe kapacitetet e reja gjeneruese. Qeveria ka vendosur në rangun e prioriteteve të larta hapjen e Fushës së Sibovcit Jugor që ka një kapacitet thëngjilli 430 milion ton. Ky projekt është miratuar nga KKI dhe Qeveria e Kosovës. Nga e tërë sasia e prodhuar e linjtit 97.5% e sasisë së përgjithshme në dispozicion e linjtit shpenzohet për furnizimin e termocentraleve të Kosovës, ndërsa 2.5 % i dedikohet tregut për plotësimin e nevojave të konsumit në industri, amvisëri, bujqësi dhe shërbime. Vendburimi i Dukagjinit, në afërsi të Gjakovës, ka afërsisht rreth 16-17% të rezervave shtetërore të qymyrit dhe këto ekplotimi i tyre akoma nuk ka filluar.

Analiza tregon se qymyri paraqet konsumin/kontributin më të ulët si në nivel të Kosovës ashtu edhe në nivel të Gjakovës, kjo ndodh sepse pjesa dërmuese e linjtit shkon për prodhimin e energjisë elektrike.

3.1.2.2. Biomatat

Sipërfaqja pyjore është përcaktuar si tokë me drurë me kurorë që mbulon më shumë se 10% dhe sipërfaqe prej më shumë se 0.5 ha. Drurët duhet të jenë në gjendje të arrijnë lartësinë minimale prej 5 metër në pjekuri në vend sipas përkufizimit ndërkombëtar FAOs. Në tabelan 4 është dhënë sipërfaqja pyjore sipas origjinës së grumbullit dhe pronësisë (ha).

Tabela 4: Sipërfaqja pyjore sipas origjinës së grumbullit dhe pronësisë (ha)

Origjina grumbullit	Pronësia			Totali
	Publike	Private	Panjohur	
Farim natyral	58 400	13 600	1 000	73 000
Pyllëzim dhe farim artificial	2 000	800	0	2 800
Cungishte	229 000	164 800	4 000	397 800
Cungishte me standarde	5 800	1 600	0	7 400
Totali	295 200	180 800	5 000	481 000

Një total 180 800 ha (38%) e pyjeve të Kosovës është klasifikuar si pronë private, dhe 295 200 ha (62%) është klasifikuara si pyje publike. Ndesa, vlerat për Komunën e Gjakovës janë 28500 ha si pyje private dhe 46600 ha si pyje publike. Pyjet cungishte mbulojnë 84% të sipërfaqes pyjore totale. Ky është rezultat i një prerie të gjerë, në veçanti si rotacionit të shkurtër i pyjeve cungishte për prodhimin e drurëve zjarri. Pyjet të cilat regjenerohen në mënyrë naturale është normalisht ahu (*Fagus spp.*), të përziera ahu dhe halorët, pyjet halore dhe të pastër të vendosura në lartësi të larta.

Mirëmbajtja apo rritja e vëllimit në këmbë si bazë për furnizim me dru është kriter kyç i menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Në mënyrë për të ruajtur produktivitetin, largimi i drurit nuk mund të tejkalojë rritjen vjetore për afat të gjatë. Të gjitha vëllimet e rritjes dhe

largimeve të drurit janë dhënë në metër kub mbi lëvore. Rritja vjetore në vitin 2018 është e ngjashme me vitin 2012, kur rritja vjetore e pyjeve që gjenden në sipërfaqe të paarrishme për një masë të madhe ishte klasifikuar si "fletorë të padefinuar". Pjesa më e madhe e këtij vëllimi tanimë me gjasë është klasifikuar ose si ahu apo specie të tjera fletore. Rezultatet tregojnë se rritje vjetore të *Quercus* spp. ka rënë paksa, ndërsa rritja e specieve halore është rritur. Shfrytëzimi i masës drunore nga pyjet qoftë për djegie apo edhe për qëllime tjera është një nga format e shfrytëzimit të resurseve natyrore që ka ndikim të drejtpërdrejtë në gjendjen e mjedisit kur dihet roli dhe rëndësia që kanë pyjet në cilësisë e ajrit, rregullimin e regjimit ujor por edhe për klimën. Biomasa e drunjtë është gjetur të jetë e bollshme rreth Gjakovës.

s. Studimet e kryera së fundi:

- Vlerësimi i Potencialit të Biomassës dhe Zinxhirit i Furnizimit për Sistemin e Ngrohjes së Përqendruar dhe Centrali (koogjenerues) i bashkëprodhimit të enegjisë elektrike dhe termike në Gjakovë bazuar në variantin e publikuar nga Holzcluster Steiermark GmbH, 18.07.2017;
- Projekti paraprak dhe Zinxhiri i Furnizimit për Sistemin e Ngrohjes së Përqendruar dhe Centrali (koogjenerues) i bashkëprodhimit të enegjisë elektrike dhe termike në Gjakovë bazuar në variantin e publikuar nga Holzcluster Steiermark GmbH, 18.08.2017;

Krasitja e vreshtave/hardhive (mbetjet bujqesore);

1. Mbetjet drusore nga ndërmarrjet e sharrave;
2. Mbetjet e pyllit nga pyjet publike;
3. Mbetjet e pyllit nga pyjet private;

Krasitja e vreshtave/hardhive i referohet heqjes të degeve të vreshtave pas mbledhjes së prodhimit të rrushit, që bëhet gjatë stinës të dimrit midis Dhjetorit dhe Marsit. Vetitë e lëndës djegëse të krasitjes të hardhive (Tabela 5) janë të ngjashme me drurin dhe mund të përdoren si biomasa në të njëjtat kalidaja.

Tabela 5: Vetitë fizike dhe kimike të krasitjes të vreshtave/hardhive

Krasitja vreshtave/hardhive		
Nr	Fuqia Kalorifike Neto (MJ/kg-masë e thate)	17.5-18.2
1	Përmbajtja e Hirit (% në masën e thate)	2.2-3.5
2	Përmbajtja e Lageshtires (% në masën e thate)	15
3	Temperatura e zbutjes së Hirit (°C)	795-1200
4	Përmbajtja e Azotit (% në masën e thate)	0.5-0.75
5	Përmbajtja e Squfurit (% në masën e thate)	0.02
6	Përmbajtja e Klorit (% në masën e thate)	0.05-0.07

Potenciali i disponueshëm i biomassës nga krasitja e hardhive është prezantuar në tabelën 6.

Tabela 6: Potenciali i Biomassës që rezulton nga Krasitja e Hardhive

Vreshtat	Vreshtat [ha]	Rrënjë hardhi/ ha	Krasitja e llogaritur e hardhive [ton]	Faktori i mbledhjes	Krasitja e disponueshme në DH Gjakovë [ton]	Vlera e fuqisë neto kalorifike [MWh]
Kompania kryesore A	650	3,000	2,535	0,9	2,282	7,925
Kompani kryesore B	400	3,600	1,872	0,9	1,685	5,852
Te tjera	2,150	3,600	10,062	0,4	4,025	13,981
Totali	3,200				7,991	27,758

Dy kompanitë kryesore bënë krasitjen gjatë Dhjetorit dhe Marsit. Në Janar krasitja është zakonisht e limituar për shkak të kushteve të ashpra të motit. Krasitja në vreshtat e vegjel është skeduluar duke u varur nga burimet e kohës dhe, kështu, duhet të koordinohet nga furnizuesi i ashklave të drurit sipas nevojave të centralit DH Gjakova për të shmangur pasje piku në furnizim. Vlerësimi i furnizimit të biomasës nga përpunuesit primare të drurit sygjeron, që 44% e kompanive të regjistruara janë vendosur në zonën e studimit duke korresponduar me një konsum total të drurit të afërsisht në 44.000 m³/year. Nëse tregu jo-formal konsiderohet, potenciali mund të rritet nga 66.000 m³ deri në 79.000 m³. Numri i përpunuesve të drurit në zonën e studimit është llogaritur në 80 (përfshirë tregun jo-formal). Katër zonat lokale me një përqendrim të lartë të ndërmarrjeve të sharrave mund të identifikohen, konkretisht Gjakova, Decani, Peja dhe Istog. Potenciali i disponueshem i mbetjeve të ndërmarrjeve të sharrave është prezantuar në tabelën 7.

Tabela 7: Potenciali i biomasës i mbetjeve të drurit nga kompanitë e përpunimit të drurit (ndërmarrjet e Sharrave)

Konsumi i drurit të [m ³]	Mbetjet e ngurta [%]	Mbetjet e ngurta [m ³]	Lloji i Drurit llojetet e drunjve	Densiteti përmbajtje lagështirës 18% [t/m ³]	Të disponueshm për DH Gjakovë [ton] Gjakovë [tons]	VleraFuqia neto kalorifike [MWh] [MWh]
44,000	18%	7,920	Bredh (Pishe)	0,507	4,015	15,259

Shumica e kompanive raportuan që sdruri kryesor i përpunuar është bredhi/ fir (megjithëse i referuar si pisha) dhe në një masë më të vogël Ahu dhe Lisi. Pjesa më e madhe e përpunuesve të drurit të aportuar për të operuar midis Marsit dhe Nëntorit. Vetëm disa kompani zgjeruan operimet e tyre deri në Dhjetor (4 nga 15 intervista). Repartet e punës mbyllën zakonisht në Janar dhe Shkurt.

Zona e pyjeve publike të Gjakovës është pylli i korijsve i degraduar i mbizotëruar nga lisat (80% të tokës të pyllit) me një produktivitet të ulët (1.5-2 m³/ha) dhe një volum të mesatar të stokut prej 40-50 m³/ha. Afërr rruget të pyllit volumi i stokut është tipikisht më i ulët për shkak të operimeve të pyllit, ndërsa zonat më pak të aksesueshme tregojnë një stok shumë më të lartë të rritjes vjetore. Ky lloj pylli mbizotëruar nga lisi do të ngelet në këtë gjendje të degraduar pa ndërrhyrjen njerezore, dhe kështu, planet e menaxhimit të pyllit me operimet e rrallimit (deri në 60% rrallim ose edhe më lart) do të aplikohet gjatë 20 viteve të ardhshme. Në përgjithësi, kushtet në pyjet private janë më të mira (stoku më i lartë i rritjes, operimet e rregullt të pyllit për drutë e zjarrit dhe drunjte e sharrave). Operimet e rrallimit po kryhen. Mbetjet e logging po mbildhen dhe grumbullohen në skajet e pyllit. Operimet e pyllit kryhen zakonisht midis Marsit/ Prillit deri në Tetorit/ Nëntorit duke u varur nga kushtet e motit. Nga llogaritjet e përafërta të kryera nga konsulentë konsumi i pelletave në Kosovë është në nivelin 20,000-25,000 ton në vit. Ndërsa konsumi i pelletave në Gjakovë është në nivelin 1,000-1,500 ton/vit dhe përdoret gjerësisht për ngrohje. Cmimi i pelletave varion në funksion të muajit dhe është në intervalin 170-300 Euro/ton dhe cmimi i drutë të zjarrit është 45-60 Euro/m³ stere.

3.2. PRODHIMI ENERGJISË

3.2.1. PRODHIMI I ENERGJISË NGA BURIME TË RINOVUESHME (SHPP, PV, SISTEMET E UJIT TË NGROHTË, POMPAT E NXEHTESISË, IMPIANTET E ENERGJISË SË ERËS)

Në Komunën e Gjakovës nuk ekzistojnë objekte të cilat gjenerojnë energji elektrike, por ekziston vetëm një objekt që gjeneron energji termike (më në detaje është dhënë në vijim për impiantin e ngrohjes së përqendruar "Ngrohtorja e Gjakovës"). Aktualisht nuk ekziston një furnizues i gazit natyror për asnjë zonë të Kosovës dhe as për Gjakovën.

Ekzistojne disa sisteme të vogla të paneleve diellore për prodhimin e ujit të ngrohtë dhe disa sisteme shumë të vogla në numër panelesh diellore fotovoltaike.

3.2.2. IMPIANTET E NGROHJES SË PËRQENDRUAR DHE SHPËRNDARJA E NXEHTESISË

I ngjashëm me pjesë të tjera të sektorit të energjisë në Europën Lindore, sistemi i Ngrohjes Qendrore në Gjakovë ka vuajtur nga mungesa e investimeve dhe planifikimit strategjik që nga viti 1980. Disa pjesë të rrjetit të tubacioneve të transmetimit dhe shpërndarjes së nxehtësisë, nënstationeve dhe kontrollimi i paisjeve janë afër fundit të përdorshmerisë të zakonshme teknike, duke shaktuar nivele të larta joefikasiteti, vecanerisht në aspektet e humbjeve në ujë dhe në energji termike. Kompania e Ngrohjes Qendrore në Gjakovë ("NQ – Ngrohja e Gjakovës") (Kosovë), ka filluar të operojë në vitin 1982, dhe ka qenë e projektuar për të furnizuar shtëpitë me një sipërfaqe rreth 100.000 m², ndertesa komerciale me sipërfaqe totale rreth 12.000 m² dhe ndertesa publike në sektorin publik me rreth 80.000 m² afër zones. Mund të dallohet qartësisht që rehabilitimi i ngrohjes qendrore në Gjakovë është shumë i rëndësishëm, për shkak se do të ketë ndikim në zvogëlimin e rritjes së kërkesës për energji elektrike, që është konsiderim vital në Kosovë dhe në rajon. Rihabilitimi i ngrohjes qendrore në Gjakovë, do të jetë kompleks dhe intensiv në lidhje me aspektin e investimeve, dhe në të njëjtën kohë do ta zvogëlë në mënyrë drastike ndikimin mjedisor, krahasuar me situatën aktuale.

Për shkak mungesës së riinvestimeve përgjatë shumë viteve, NQ e Gjakovës ka qenë në gjendje që të ofrojë shërbime bazike të ngrohjes qendrore, për shkak të ekspertizës së stafit të saj teknik. Si rezultat i tarifave, që nuk i mbulonin shpenzimet dhe që mbaheshin vazhdimisht nën normën e inflacionit, duke ngritur vazhdimisht shpenzimet për mazut dhe shpenzimet shumë të vogla nga ana e qytetareve në se sigurohet ngrohja nga energjia elektrike (që shpesh përdoren për qëllime të ngrohjes), situata financiare e NQ në Gjakovë, sot ende ka nevojë të përmirësohet. Që nga mesi i vitit të 1990, NQ në Gjakovë ka operuar me humbje financiare. Detyrimet aktuale të akumuluar për gjatë viteve, tani janë ngritur në një nivel të konsiderueshem. Kështu që, përmirësimi financiar i DH e Gjakova me reduktime të menjëhershme të shpenzimeve dhe rritje të të ardhurave është çështje që kërkon trajtim me urgjencë së lartë.

Impianti/Sistemi i Ngrohjes së Përqendruar (DH - Ngrohja) të Gjakovës është projektuar të operojë me mazut, çmimi i të cilit është rritur në mënyrë të ndjeshme në vitet e fundit duke e bërë operimin e këtij centrali jo ekonomik dhe me humbje të mëdha financiare. Të gjithë indikatorët shprehin se tendenca e rritjes së çmimit të nënprodukteve të naftës (përfshi edhe mazutin) do të vazhdojë edhe më shumë në të ardhmen.

Rihabilitimi i sistemeve të Ngrohjes Qendrore në Gjakovë do të kërkojë investime të mëdha në instalimet kapitale intensive, jo vetëm në njësitë e prodhimit të ngrohjes me shpenzime më të ulta krahasuar me njësitë aktuale, por gjithashtu edhe në tubacionet e transmetimit dhe shpërndarjes të ndërtuara dhe ruajtura mirë. Rihabilitimi i sistemeve të Ngrohjes Qendrore në Gjakovë, do të ndikojë në shumë aspekte të shoqërisë, siç është: i) përdorimi racional i energjisë; mbrojtja e mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar, si pasojë edhe ndërkombëtar; iii) bilanci i pagesave; iv) shërbimet prodhuese; v) zhvillimi i punësimit dhe zhvillimi demografik dhe vi) rritje të mirëqenies në aspektet e shëndetësisë dhe arsimit.

Qëndrueshmëria e shpenzimeve të ardhshme të ngrohjes është një faktor i rëndësishëm për konsumatorët e ngrohjes qendrore në qytetin e Gjakovës. Llogaritjet ekonomike për të arsyetuar skemat e CHP (koogjenerimi) dhe NQ-së, janë bërë në mënyrë të detajuar. Kushtet më të favorshme për financimin dhe riabilitimin e Skemave të Ngrohjes Qendrore janë gjetur në shërbimet (infrastrukturën) e cila është ndërtuar gradualisht përgjatë shumë viteve. Sa më shpejt që konsumatorët të mund të rilidhen në rrjetin e ngrohjes qendrore, aq më e mirë do të jetë situata ekonomike e funksionimit të kompanisë. Lidhjet e detyrueshme në sistemet kolektive ekzistuese, shpesh janë të detyrueshme vetëm për ndërtesat që

gjenden në zonat e reja. Parimisht, kompanitë e NQ-së, garojnë në treg dhe i balancojnë tarifën karshi konkurrenteve si HFO (mazut), mirëpo ekonomia e tregut është modifikuar nga masa të tilla politike të energjisë si p.sh tatimet, subvencionet dhe rregulloret, duke përfshirë këtu dhe ligjet që kanë të bëjnë me furnizimin me ngrohje. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është që ta përmirësojë furnizimin me ngrohje për konsumatorët rezidencial, privat dhe publik të Komunës së Gjakovës përmes riabilitimit të Sistemit të NQ-së në Gjakovë, bazuar në ndryshimin e lëndës djegëse nga mazuti në biomasë (mbetjet bujqësore apo mbetjet e drurit).

Për riabilitimin e planifikuar të sistemit të NQ në Gjakovë dhe tubacionet e bartjes së ngrohjes dhe nënstationin përkatës Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Shoqëror (VNMS (ESIA)) aktual është përgatitur në përputhshmëri me kërkesat e këtij institucioni financiar, ato të Kosovës si edhe me standardet e EBRD/Bashkimit Europian. VNM-ja për projektin e riabilitimit të NQ-së në Gjakovë, i ekzaminon ndikimet e mundshme minimale negative dhe paraqet vecanerisht ndikimet pozitive potenciale në mjedisin e përmjet kalimit nga mazuti në biomasë dhe rekomandon masat për parandalimin, zvogëlimin, zbutjen apo kompensimin e ndikimeve të pafavorshme duke përmirësuar kështu performancën mjedisore.


Pavarësisht mungesës së ri-investimeve përgjatë shumë viteve, NQ e Gjakovës ka qenë në gjendje që të ofrojë shërbime bazike të ngrohjes qendrore, për shkak të ekspertizës së stafit teknik. Si rezultat i tarifave që nuk i mbulonin shpenzimet dhe mbaheshin vazhdimisht nën normën e inflacionit, shpenzimet vazhdimisht në rritje për naftë dhe shpenzimet shumë të vogla për energji elektrike (që shpesh përdoren për qëllime të ngrohjes nga ana e qytetareve të komunes), situata financiare e NQ në Gjakovë sot ende vazhdon të ketë nevojë për përmirsim. Që nga mesi i vitit të 1990, NQ në Gjakovë ka operuar me humbje financiare. Borxhet e akumuluar, tani janë ngritur në një nivel të pa përballueshëm. Kështu që, situata financiar në NQ të Gjakovës kërkon kursime të menjëhershme të shpenzimeve dhe rritje të të ardhurave vlerësohet si çështje që kërkon trajtim urgjent. Kompania e Ngrorjes Qendrore sh.a., në Gjakovë, e zotëron dhe operon me rrjetin e ngrohjes qendrore dhe kaldajat shërbëjnë për ngrohjen në Gjakovë dhe furnizon zonat e qytetit të paraqitura në figurën 15. Konsumatorët përbehen nga tre kategoritë e përshkruara mëposhtë.




Figura 15: Skema ekzistuese e Ngrorjes së Gjakovës j.s.c.

Meqë, ngrorhtorja e rehabilituar do të instalohet në lokacionin e ri me nje distance 1.2 km nga centrali ekzistues (sic tregohet ne fotot perkatese) pritet të kryhet një varg i punëve civile, në mënyrë që të akomodohen bolllerët e rinj dhe paisjet brenda hapësirës ekzistuese. Së pari, një pjesë e caktuar e ngrorhtores ekzistuese është paraparë që të çmontohet bashkë me prishjet e tjera të nevojshme të hapësirës ekzistuese që nuk është më e dobishmepasi ngrorhtorja që do të ndërtohet në vendin e ri do të jetë në operim.

Për të bërë një shfrytëzim eficient të Ngrorhtores së Gjakoves si dhe për të dhënë sinjale të drejta në drejtim të kursimit të energjisë është e domosdoshme që për pallatet e vjetra (ndërrtesat shumë katëshe) si dhe për ndërtesat publike në të cilat kryejnë aktivitetin disa subjekte tek të cilat instalimet e ngrorhtjes qendrore janë të tipit klasik me shumë kolona në afersi të çdo radiatorit dhe si pasojë është instalimi i demoduar shumë nga këto palate kane ngelur pa furnizim me energji termike nga Ngrorhtorja e qytetit. Ndërrimi i këtij sistemi me sistem të ri me vetëm një kolonë (me kolektorë nëpër koridore) për çdo hyrje të pallateve/banesave do jetë zgjidhje perfekte. Në figurën që pason është dhënë mënyra si mundsi e ndryshimit të këtyre sistemeve në projektet e rradhës (figura 16).



SISTEMI I VJETËR I NGRORHTJES QENDRORE ME SHUMË KOLONA



SISTEMI I RI I NGRORHTJES QENDRORE ME VETËM NJË KOLONË ME KOLEKTORË

Figura 16: Skemat e brendëshme e vjetër (jo eficiente) dhe ajo e re (eficiente) të ngrorhtjes për ndërtesat shumë-katëshe që furnizohen

Përveç punëve të prituara civile që duhet të kryhen lidhur me HoB, CHP dhe paisjet e tjera, lokacioni i ri është projektuar në mënyrë të tillë që të përshtasë dy boiler të mëdhej, me hapësirë për depo për biomasë, totali i sipërfaqes së të cilës është 1,400 m². Prania e

hapësirave të reja dhe e deponisë së biomasës krijon nevojën për qasje të re rrugore brenda lokacionit të ri, dhe modifikime të tjera të nevojshme të peisazhit. Këto punime modifikuese/rehabilituese janë vlerësuar dhe janë paraqitur në raportin teknik. Hapësira për ndërtimin e centralit të ri ka formë drejtkëndësh 300 m të gjatë dhe 75 m e gjerë. Zona në dispozicion përcaktohet sipas masës dhe formës të përcaktuar nga Bashkia dhe ndërtimet e mundshme në zonë. Bazuar në këtë kufizim hapësinor u përgatit një marrëveshje konceptuale e objekteve, e cila është përshkruar në skicën më poshtë. Zonat me të verdhe janë zona të blera nga bashkia. Autostrada e re që do të ndërtohet e projektuar nga bashkia është paraqitur në anën e majtë të centralit DH. Vijat e kuqe paraqesin linjen ajrore egzistuese 110 kV. Bazuar në situatën e tanishme në zonë (figura 17) ka mundësi për zgjerim të zones në kufirin me lindjen e zones, në qoftë se do të jete e nevojshme.



Figura 17: Lokacioni i Ri i Ngrohtores së Gjakovës

Përparësitë e Projektit të me skeme Koogjeneruese të Ngrohtores se Gjakoves jane:

- Sigurimi i ngrohjes së mjaftueshme dhe cilësore përgjatë gjithë sezonit ngrohës.
- Reduktimi i kostos operative të prodhimit të ngrohjes
- Zëvendësimi i mazutit me biomasë e mbeshteteshme karshi mjedisit
- Përmirësimi i cilësisë së ajrit për banorët e Gjakovës duke e reduktuar CO2 dhe gazrat e tjera të dëmshme
- Zvogëlimi i kërkesës për përdorim të energjisë elektrike për ngrohje, duke reduktuar kështu edhe shpenzimin e energjisë elektrike.

Si rezultat i këtyre vlerësimeve është bërë e mundur që të llogariten shpenzimet totale të nevojshme për ta materializuar rehabilitimin e Ngrohtores se Gjakoves, me investimin total për një HoB dhe një njësi CHP përfshirë të gjitha punët civile dhe rehabilitimin e rrjetit (Alternativa B) është vlerësuar të jetë 14,168,000 Euro. Më poshtë, është dhënë tabela 8, që paraqet shpenzimet e këtyre artikujve kryesor për secilën alternativë.

Tabela 8: Permbledhje e zerave te koston per rehabilitimin e Ngrohtores se Gjakoves

Zerat e kostove	Madhesia e Investimit, EUR
Instalimi i HoB	1,015,000
Instalimi i HoB dhe CHP	6,109,000
Pajisjet ndihmëse të sistemit të DH	227,000
Instalimet Elektrike dhe Sistemi i kontrollit në Distançë	537,000
Dekomisionimi	79,000

Punimet civile, Nd ë rtesa e Kaldajave	608,000
Punimet civile, Nd ë rtesa e CHP	821,000
Punimet civile, Nd ë rtesa e Storzhit të Biomasës	277,000
Rregullimet e peisazhit (si kosto për të realizuar planin e zbutjes së ndikimeve negative) në kantjerin e ri	245,000
Rrjetat e tubacioneve termike te DH	1,185,000
Nënstacionet e këmbyesve të nxehtesise për lidhjen e konsumatorëve	705,000
Kosto Totale	11,808,000
Konsulenca (10% e koston totale)	1,180,000
Fondi rezerve (10% e koston totale)	1,180,000
Kosto e Pë rgjithshme Totale	14,168,000

3.2.3. PRODHIMI I ENERGJISË SIPAS SEKTOREVE

3.2.3.1. Prodhimi i Energjise nga sektori residencial

Në sektorin residencial të Komunes së Gjakovës nuk ekzistojnë centrale të cilat gjenerojnë energji elektrike, por ekzistojnë generatorë diesel të cilët shërbejnë si back up (sisteme reserve) kur mungon energjia elektrike. Vlen të theksohet se në 4-5 vitet e fundit përdorimi i tyre është minimizuar dhe bazuar në survejimin e kryer nga projekti i EU në lidhje me konsumin e energjisë në sektorin residencial shfrytëzimi i tyre ka qenë vetëm 180-200 orë në vit për Komunën e Gjakovës.

Gjithashtu, në sektorin residencial, ekzistojnë disa sisteme të vogla të paneleve diellore për prodhimin e ujit të ngrohtë dhe disa sisteme shumë të vogla në numër panelesh diellore fotovoltaike. Vlen të theksohet se bazuar në survejimin e kryer nga projekti i EU në lidhje me konsumin e energjisë në sektorin residencial shfrytëzimi i paneleve diellore për ujë të ngrohtë është në nivelin 0.55-0.6% për Komunën e Gjakovës.

3.2.3.2. Prodhimi i Energjisë nga sektori shërbimeve

3.2.3.2.1. Prodhimi i Energjisë nga ndërtesat publike

Në sektorin e ndërtesave publike të Komunës së Gjakovës nuk ekzistojnë centrale të cilat gjenerojnë energji elektrike, por ekzistojnë generatorë diesel të cilët shërbejnë si back up (sisteme reserve) kur mungon energjia elektrike. Vlen të theksohet se në 4-5 vitet e fundit përdorimi i tyre është minimizuar dhe bazuar në survejimin e kryer nga projekti i EU në lidhje me konsumin e energjisë në sektorin e ndërtesave publike shfrytëzimi i tyre ka qenë vetëm 220-250 orë në vit për Komunën e Gjakovës.

Gjithashtu, në sektorin e ndërtesave publike, ekzistojnë disa sisteme të vogla të paneleve diellore për prodhimin e ujit të ngrohtë dhe disa sisteme shumë të vogla në numër panelesh diellore fotovoltaike. Vlen të theksohet se bazuar në survejimin e kryer nga projekti i EU në lidhje me konsumin e energjisë në sektorin e ndërtesave publike shfrytëzimi i paneleve diellore për ujë të ngrohtë është në nivelin 0.5-0.75% për Komunën e Gjakovës.

3.2.3.2.2. Prodhimi i Energjisë nga ndërtesat komerciale dhe sme

Në sektorin e ndërtesave komerciale dhe SME të Komunës së Gjakovës nuk ekzistojnë centrale të cilat gjenerojnë energji elektrike, por ekzistojnë generatorë diesel të cilët shërbejnë si back up (sisteme reserve) kur mungon energjia elektrike. Vlen të theksohet se në 4-5 vitet e fundit përdorimi i tyre është minimizuar dhe bazuar në survejimin e kryer nga

projekti i EU në lidhje me konsumin e energjisë në sektorin e ndërtesave komerciale dhe SME shfrytëzimi i tyre ka qenë vetëm 250-400 orë në vit për Komunën e Gjakovës. Gjithashtu, në sektorin e ndërtesave komerciale dhe SME, ekzistojnë disa sisteme të vogla të paneleve diellore për prodhimin e ujit të ngrrohtë dhe disa sisteme shumë të vogla në numer panelesh diellore fotovoltaike.

3.2.3.2.3. Prodhimi i Energjisë nga sektori i ndërmarrjeve e shërbimeve publike

Në sektorin e ndërmarrjeve të shërbimeve publike (furnizimit me ujë, ujrave të zeza, mbledhjes sëmbetjeve urbane) të Komunes së Gjakovës nuk ekzistojnë centrale të cilat gjenerojnë energji elektrike, por ekzistojnë generatorë diesel të cilët shërbejnë si back up (sisteme reserve) kur mungon energjia elektrike. Gjithashtu, në sektorin e ndërmarrjeve të shërbimeve publike, ekzistojnë disa sisteme të vogla të paneleve diellore fotovoltaike.

3.2.3.3. Prodhimi i Energjisë nga sektori industrisë

Në sektorin industrial të Komunës së Gjakovës nuk ekzistojnë centrale të cilat gjenerojnë energji elektrike, por ekzistojnë generatorë diesel të cilët shërbejnë si back up (sisteme reserve) kur mungon energjia elektrike. Gjithashtu, në sektorin industrial, ekzistojnë disa sisteme të vogla të paneleve diellore fotovoltaike. Shtimi i sistemeve fotovoltaike do të rritet ndjeshëm në të ardhmen bazuar në vendimin administrativ të lejitimit të konceptit net-meter për këto sisteme.

3.2.3.4. Prodhimi i Energjisë nga sektori bujqesisë

Në sektorin bujqësor (sidomos në stallat e sektorit të blektorisë) të Komunës së Gjakovës nuk ekzistojnë centrale të cilat gjenerojnë energji elektrike, por ekzistojnë generatorë diesel të cilët shërbejnë si back up (sisteme reserve) kur mungon energjia elektrike. Gjithashtu, në sektorin bujqësor (sidomos në stallat e sektorit të blektorisë), ekzistojnë disa sisteme të vogla të paneleve diellore fotovoltaike dhe disa sisteme të paneleve diellore që bëjnë të mundur tharjen e frutave.

4. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTOREVE

Konsumi i energjisë në Komunën e Gjakovës shkon për plotësimin e nevojave për sektorët që vijojnë:

1. Sektorin e ndërtesave publike komunale – objekt i analizës sasiore dhe cilësore të detajuar në këtë Plan të Veprimit të EE për komunën e Gjakovës;
2. Sektorin e ndricimit rrugor publik – objekt i analizës sasiore dhe cilësore të detajuar në këtë Plan të Veprimit të EE për komunën e Gjakovës;
3. Sektorin e ujit të pishëm dhe ujrave të zeza – objekt i analizës së përgjithshme cilësore në këtë Plan të Veprimit të EE për komunën e Gjakovës;
4. Sektorin e mbledhjes dhe përpunimit të mbetjeve urbane – objekt i analizës së përgjithshme cilësore në këtë Plan të Veprimit të EE për komunën e Gjakovës;
5. Sektorin e transportit publik – objekt i analizës së përgjithshme cilësore në këtë Plan të Veprimit të EE për komunën e Gjakovës;
6. Sektorin Residential – objekt i analizës së përgjithshme cilësore në këtë Plan të Veprimit të EE për komunën e Gjakovës;
7. Sektorin e Shërbimeve Komerciale – objekt i analizës së përgjithshme cilësore në këtë Plan të Veprimit të EE për komunën e Gjakovës;
8. Sektorin e Industrisë – objekt i analizës së përgjithshme cilësore në këtë Plan të Veprimit të EE për komunën e Gjakovës;

Bazuar në ToR dy sektorët të cilët janë analizuar në mënyrë të detajuar nga pikpamja cilësore dhe sasiore janë sektorët e ndërtesave publike komunale dhe të ndricimit rrugor publik.

Spektori i ndërtesave komunale përbëhet nga këto kategori ndërtesash:

- Komunë/Administrate
- Shkollë fillore-e mesme e ulët
- Bibliotekë
- Shkollë e mesme
- Cerdhe
- Shëndetësi Familjare

Në Aneksin 6.1 është dhënë Lista e Ndërtesave Publike Komunale (PB). Ndërsa në Aneksin 6.2 janë dhënë të gjitha të dhënat bazë të Ndërtesave Publike Komunale si nga pikpamja konstruktive ashtu edhe për lidhjet me konsumin e burimeve energjetike. Konsumi total për 81 ndërtesa është i energjisë i barabartë me 5.63 GWh në 2017 prej të cilave 24.15% mbulohen nga dieseli, 14.29% e konsumit mbulohen për energjinë elektrike, 12.37% mbulohen nga Ngrrohtorja e Gjakovës, 61.17% mbulohen nga drutë e zharrit dhe zero mbulohen nga peletat. Një analizë shumë më e detajuar jepet në sesionet pasuese të këtij raporti.

4.1. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDËRTESET PUBLIKE

4.1.1. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDËRTESET E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Konsumi specifik i energjisë në ndërtesat publike, është në intervalin 20-220 kWh/m² (sigurisht sic do të tregohet në grafik ka edhe vlera më të larta sic tregohet në figurat 18.1 dhe 18.2) përfaqëson performancë nga shumë e mirë deri në vlera të larta (për 10 ndërtesa janë vlera pa pranueshme (si rezultat i të dhënave). Duhet patur parasysh se vlerat shumë të ulta janë lidhur gjithashtu edhe për shkak të limitimeve të konsumit të energjisë dhe në disa raste janë gjithashtu edhe për shkak të performancës së mirë të objekteve. Nëse temperaturë e dhomes do të furnizohet sipas normave, sektori do të tregojë një performancë shumë të ulët me potencial kursimi prej 60-70%. Krahasimi i ndërtesave publike të sipas treguesit të konsumit specifik të energjisë [kWh/m² vit] jepet në figurat 18.1 & 18.2 dhe një

analizë më e detajuar për këtë tregues për të gjitha ndërtesat do të jepet në sesionet në vijim. Komuna ka kontroll të plotë në 81 ndërtesa, siguron mirëmbajtjen e ndërtesave, rinovimin, ujin si dhe furnizimin me lëndë djegëse dhe energji elektrike. Komuna nuk ka autoritet mbi operimin dhe furnizimin me energji të ndërtesave të Qeverisë qendrore në Gjakoves. Konsumi vjetor energjistik i këtyre ndërtesave publike jo-Komunale shkon në afersisht 5.8 GWh.

Në grafikun e paraqitur në figurat 18 tregohet se janë 5 ndërtesa publike me një konsum më tël artë se 220 kWh/m² vit. Konsumi i këtyre ndërtesave shkon deri në 300 kWh/m² vit dhe mundësia më e madhe ekziston që ky konsum është shumë më i lartë se ai qëë ndodh aktualisht dhe mund të ndodhë si pasojë e mos mbajtjes së shënimeve të konsuit të lëndëve djegëse jo në mënyrë të saktë. Ndërtesat e Gjakoves mund të ndahen në dy lloje sipas fondeve të përdorura nga buxheti: që i përkasin Qeverisë Qendrore dhe ato që i përkasin Komunes. Për shkak të qenies Kryeqytet i Republikës së Kosovës një pjesë e rëndësishme e ndërtesave mund të klasifikohet si ndërtesa të cilat përgjithësisht janë në pronësi të Qeverisë. Në vecanti këto përfshijnë ndërtesat në zonat trashëgimore, të cilat operojnë nën përgjegjesinë e Ministrisë së Kulturës. Ndërtesa të tjera publike të cilat i përkasin agjensive dhe Ministrive të Qeverisë Qendrore janë spitalet, siguria publike, si dhe ndërtesat e drejtësisë dhe administratës tatimore. Komuna e Gjakovës është përgjegjëse për operimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave që ndodhen brenda kufijve të saj, përfshire këtu ndërtesat administrative lokale, shkollat, kopshtet, muzete dhe librarite të ndodhura në fshatra të ndryshëm të cilët i përkasin Komunes, etj. Konsumi energjistik i ndërtesave Komunale matet çdo muaj dhe ai raportohet tek departamenti Komunal për financë dhe buxhet. Furnizimi vjetor me lëndë djegëse si dru/peleta dhe karburant si benzina/nafta vendoset nga Komuna duke u bazuar mbi të dhëna historike dhe buxhetin e disponueshëm. Megjithatë, nevoja reale zakonisht nuk përmbushet për shkak të humbjeve të mëdha.

Shkollat dhe kopshtet operohen nga Departamenti i Zhvillimit Social dhe Edukativ. Në total, Komuna operon 80 ndërtesa Komunale me një sipërfaqe totale prej 92,481 m² përfshirë këtu ato ndërtesa publike të ndodhura në fshatra. Në figurat 19-22 është paraqitur inventari i ndërtesave publike të komunës. Pjesën më të madhe të ndërtesave e përbëjnë Shkollat, më pas Qendrat Shëndetësore Familjare dhe numrin më të vogël bibliotekat.




Figura 19: Konsumi i energjisë nga ndërtesat administrative në Gjakovë (kWh/vit)




Figura 20: Konsumi i energjisë nga ndërtesat administrative në Gjakovë (%)




Figura 21: Sipërfaqia totale e stokut të ndërtesave publike për secilën kategori në Gjakovë (m²)




Figura 22: Sipërfaqia totale e stokut të ndërtesave publike për secilën kategori në Gjakovë (%)

Sipërfaqia totale për të gjithë ndërtesat është 92,481 m² dhe shkollat fillore përbëjnë pjesën më të madhe me 63%, shkollat e mesme me 9% dhe me pas qendrat shëndetësore familjare me 9%. Komuna ka një buxhet të mjaftueshëm në lidhje me ngrohjen e ndërtesave publike dhe të gjitha faturat e energjisë elektrike, druve, peletave, diezel, ujit dhe të gjitha faurave të tjera realizohen nëpërmjet departamentit të financës.

Sasia totale e energjisë së konsumuar në 2017 nga ndërtesat Komunale ishte 5.63 GWh, vlerë e cila përfshin konsumin e energjisë për ngrohjen e hapësirave, ndricim dhe paisjet elektroshtëpiake, si dhe disa bolierë të vegjël elektrik për ngrohjen e ujit. Energjia e konsumuar për ngrohje është 48.38-103.47 kWh/m² për vit, dhe energjia e konsumuar për ndricim është rreth 10.45 kWh/m². Sezoni i ngrohjes zgjat nga 1 Tetor deri në 15 Prill.

Konsumi i energjisë në ndërtesat administrative mbulohet 9.13% nga energjia elektrike dhe 90.87% nga diezeli. Kjo analizë është treguar ne figurat 8-9 dhe tregon në mënyrë të qartë që ngrohja nëpjesë n mëte madhe është prej sistemeve qendrore me diezel.

Konsumi i energjisë është me 68.30% nga shkollat fillore, shkollat e mesme me 6.72% dhe pjesa tjetër konsumohen nga qendrat shëndetësore familjare, cerdhet, ndërtesat administrative dhe në fund bibliotekat me 1.58%. Kjo analizë është treguar në figurat 23-24.




Figura 23: Konsumi i energjisë nga të gjitha kategoritë e ndërtesave në Gjakovë (kWh/vit)




Figura 24: Konsumi i energjisë nga të gjitha kategoritë e ndërtesave në Gjakovë (%)

Ndricimi i brendëshem i të gjitha ndërtesave sigurohet zakonisht sigurohet me llamba inkadashente, CFL-te dhe tuba T5 FL me nivel të mjaftueshëm ndricimi në shumicën e hapësirave. Instalimet elektrike në ndërtese janë në gjendje të pranueshme për shkak të shërbimeve të duhura për mirëmbajtje nga ekipi i Komunës.

4.1.2. KONSUMI I ENERJISË NGA NDËRTESTAT PUBLIKE TË EDUKIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLLOJISË

Konsumi i energjisë nga shkollat e mesme mbulohet 17.51% nga energjia elektrike, 38.33% nga drutë e zjarrit, 0.001% nga ngrohja e përqendruar dhe 44.16% nga diezeli. Kjo analizë është treguar në figurat 25-26 dhe tregon në mënyrë të qartë që ngrohja në pjesën më të madhe është prej sistemeve të ngrohjes qendrore dhe ngrohjes së përqendruar.

Konsumi i energjisë në cerdhe mbulohet 51.51% nga energjia elektrike, 5.69% nga drutë e zjarrit dhe 42.80% nga diezeli. Kjo analize është treguar ne figurat 27-28 dhe tregon në mënyrë të qartë që ngrohja në pjesën më të madhe është prej sistemeve të ngrohjes individuale dhe ngrohja e përqendruar zë gjithashtu një pjesë të rëndësishme të konsumit vjetor energjetik.

Konsumi i energjisë në shkollat fillore mbulohet 7.77% nga energjia elektrike, 0.001% nga ngrohja e përqendruar, dru zjarri me 78.68%, peleta me 0.00% dhe 13.55% nga diezeli. Kjo analizë është treguar në figurat 29-30 dhe tregon në menyrë të qartë që ngrohja në pjesën më të madhe është prej sistemeve individuale në shkollat fillore.



Figura 25: Konsumi i energjisë nga shkollat e mesme (kWh/vit)




Figura 26: Konsumi i energjisë nga ndërtesat e shkollat e mesme në Gjakovë (%)




Figura 27: Konsumi i energjisë nga ndërtesat e cerdheve (kWh/vit)




Figura 28: Konsumi i energjisë nga ndërtesat e cerdheve në Gjakovë (%)




Figura 29: Konsumi i energjisë nga filllore mesme e ulët (kWh/vit)




Figura 30: Konsumi i energjisë nga ndërtesat e shkollave filllore-e mesme e ulët (%)

Ndertesat e drejtorise se Arsimit, Shkences dhe Teknologjise, sic edhe u tregua me siper perfshijne Cerdhet, Shkollat fillore, shkollat e mesme, per pasoje per te pasur nje permbledhje jane dhene ne figurat 27-28 gjendja e konsumit per drejtorine e Arsimit. Konsumi i energjise ne te gjitha ndertesat e sektorit te arsimit mbulohet 18% nga nenproduktet e naftes, 4% nga ngrohja e perqendruar, 68% nga drute e zjarrit dhe 10% nga energjia elektrike. Kjo analize eshte treguar ne figurat 31-32 dhe tregon ne menyre te qarte qe ngrohja ne pjesen me te madhe eshte prej sistemeve te ngrohjes individuale/qendrore dhe ngrohjes se perqendruar.




Figura 21: Konsumi i energjisë nga ndertesat e sektorit te arsimit (kWh/vit)




Figura 32: Konsumi i energjisë nga ndertesat e sektorit te arsimit (%)

4.1.3. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDËRTESTAT E SHËNDETIT PUBLIK

Konsumi i energjisë në qendrat e shëndetësise familjare mbulohet 41.24% nga energjia elektrike, 3.16% nga ngrohja e përqendruar, dru zjarri me 37.83% dhe 17.77% nga diezeli. Kjo analizë është treguar në figurat 33-34 dhe tregon në mënyrë të qarte që ngrohja në pjesen më të madhe është prej sistemeve individuale ne qendrat e shëndetësise familjare.




Figura 33: Konsumi i energjisë nga ndërtesat e Shëndetësise Familjare në Gjakovë (kWh/vit)




Figura 34: Konsumi i energjisë nga ndërtesat e Shëndetësise Familjare në Gjakovë (%)

4.1.4. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDËRTESET PUBLIKE TË KULTURËS DHE SPORTIT

Konsumi i energjisë në bibliotekë (pjesë e ndërtesave të kulturës) mbulohet 13.65% nga energjia elektrike dhe 86.35% nga diezeli. Kjo analizë është treguar në figurat 35-36 dhe tregon në mënyrë të qartë që ngrohja në pjesën më të madhe është prej sistemeve qendrore me diezel.




Figura 35: Konsumi i en. nga ndërtesat e bibliotekave (kWh/vit)




Figura 36: Konsumi i energjisë nga ndërtesat e bibliotekave në Gjakovë (%)

4.1.5. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDRICIMIN PUBLIK TË RRUGEVE

Në Aneksin 6.3 është dhënë Lista e Rrugeve me Ndricimin Publik përkatës si nga pikpamja e numri të llambave ashtu edhe për sa lidhet me kapacitetin mesatar të llambave për secilin rrugë. Konsumi total i energjisë elektrike për 4,958 pika ndricuese është i barabartë me 1.287 GWh si mesatare e tre viteve (2015-2017). Një analizë shumë më e detajuar jepet në sesionet pasuese të këtij raporti (figura 37). Në grafikun e paraqitur në vijim tregohet se janë 7 rrugë me ndricim publik me një konsum më të lartë se 11,000 kWh/km vit. Konsumi energjetik për këto rrugë shkon deri në 25,000 kWh/km vit dhe mundësia më e madhe ekziston që ky konsum është shumë më i lartë se ai që ndodh aktualisht dhe mund të ndodhë si pasojë e mos mbajtjes së shënimeve të konsumit të energjetik jo në mënyrë të saktë.

Kosumi specifik i energjisë nëndricimin e rrugëve është 5134 kWh/km Energjia Elektrike e Konsumuar për çdo km rrugë të ndërruar përfaqëson një performancë mesatare të lartë, për shkak të përdorimit të llambave inefficente për pasojë potenciali i kursimit të energjisë duke zëvendësuar ndricuesit me teknologji LED do të jetë 55 deri në 70%. Krahasimi i rrugëve në bazë të konsumit specifik të energjisë së konsumuar për 1 km rrugë jepet në figurën 34 dhe një analizë më e detajuar për këtë tregues për të gjitha rrugët do të jepet në sesionet në vijim.

4.2. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDËRRMARRJET PUBLIKE

4.2.1. KONSUMI I ENERGJISË NGA NDËRRMARRJET PUBLIKE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË UJRAVE TË ZEZA

KRU Radoniq Sh.A. Gjakovë ka kapacitet dhe mund të furnizojë me ujë të pijshëm rreth 230.000 banorë, me kapacitet 1000 lit/sec, apo prodhim të ujit të pijës në sasi prej 43.200 m³ në ditë. Në vitin 2018 përfundoi ekuizhimi i fazës së II të Fabrikës për Përpunimin e ujit, që nënkupton prodhimin e ujit edhe për 500 lit/sec duke arritur një kapacitet të furnizimit total 1000 lit/sec. KRU Radoniq Sh.A. Gjakovë ka në zotërim këto asete:

- Kaptazhën në lumen Bistrica të Deçanit,
- Kanalin derivues prej 9 km
- Liqenin e Radoniqit si i vetmi burim dhe burimet e fshatrave Damjan 1 & 3, Gërquinë, Optrushë, Hoqë e Madhe, Senoc, Drenoc, që shërbejnë për furnizim për këto fshatra. Në hartën e dhënë tregohen të gjithë vendbanimet përkatëse që furnizohen me ujë të pijshëm nga KRU Radoniq Sh.A. Gjakovë.

- Kapaciteti (Maksimal) i Liqenit është **117 milion m³** kur është i mbushur plotë, në kotën mbidetare prej **456 m**,

- Gjatësia maksimale e Liqenit është **5.035m**

- Gjerësia maksimale e Liqenit është **2.100 m**

- Thellësia maksimale është **61m**

- Sipërfaqja e Liqenit me ujë në kuotën maksimale është **644 hektar**

- Stacione filtrave për trajtimin e ujit

- 30 rezervuarët e ujit

- 35 stacione pompimi

- **741.278 km rrjet kryesor të ujesjellësit**

Përveç furnizimit me ujë të pijshëm KRU Radoniq bënë shërbime për largimin e ujërave të përdorura me: Gjakovë 56 km rrjet kanalizim fekalesh, Rahovec 25

km rrjet kanalizim fekalesh dhe 1250 puseta të kanalizimit fekalesh. KRU Radoniq -Sh.A. ka për synim furnizim të qëndrueshëm me ujë të pijshëm dhe cilësor, shërbime të efektshme me përkujdesje mjedisore si dhe të kërkojë më donacione për projektet rimëkëmbëse:

- T'u ofrojmë konsumatorëve shërbime të mira dhe t'i bindim ata për pagesën e faturave
- Ta ruajmë dhe përmirësojmë mjedisin gjithandej ku veprojmë,
- T'u mundësojmë punëtorëve tanë zhvillim personal dhe karrierë të kënaqshme,
- Të bindim donatorët dhe huamarrësit që investimet e tyre do të shlyhen,
- Zgjerimi i rrjetit në Rajone tjera nën juridiksionin e KRU Radoniq Sh.A. Gjakovë.



Në kuadër të kësaj vlen të përmendet edhe realizimi me sukses i Projekteve të financuara të financuara nga Qeveria e Kosovës ; Linja e ujit të pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit, linjat dhe infrastruktura mbështetëse.

Nëpërmjet ngritjes së fabrikës së re, e cila shumë do të rezultoi në rritjen e kapaciteteve prodhuese të ujit në 500 lit në sec gjë që do të mundësonet furnizim 24 orë panderprerë gjetë tërë vitit si dhe do të zgjerohet furnizimi në masë të madhe i rrjetit të ujësjellësit në fshatrat e regjionit me të cilën është i shtrirë KRU Gjakova. Ky është një projekt i vjetër i hartuar që nga themelimi i Hidrosistemit dhe i pa realizuar deri më sot, për arsye financiare. Projekti në fjalë do të ndikoi në avancimin e Kompanisë në arritjen e treguesve të performancave operative dhe financiare; në rritjen e numrit të konsumatorëve, rritjen e faturimit si dhe inkasimit për konsumatorët e ketyre fshatrave.

Kanali derivues i basenit të Radoniqit, linja dhe infrastruktura mbështetëse. Ky Projekt është e arritur kolosale për KRU Gjakova ,bazuar në faktin e njohur që 40 vite të ndërtimit të këtij sistemi kanali derivues si projekt i financuar nga Banka Botërore nuk është arrit të përmbyllet që uji i lumit përmes kanalit të betonuar të derdhet deri në liqen, 3000 metra gjatësi të kanalit kanë qene të pa përfunduara,gjë që kjo gjendje ka bërë që rrjedhja e ujit të bart me vete sasi të mëdha të dheut në liqe si dhe të ketë humbje të mëdha të ujit në Liqen. Punët e zhvilluara rreth realizimit të këtij Projekti kanë shkuar në çdo vit me një realizim prefekt si: realizimin me kohën e planifikuar, kualitetin e kërkuar të ndërtimit ashtu edhe me kuantitetin e ndërtimit.

Shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe ujrave të zeza sigurohen nga Kompania KRU Radoniq Sh.A. Gjakovë, e cila është në shërbim të të gjithë grupeve të klienteve në të të gjithë komunave të sipër përmendura. Për shkak të përdorimit mbizotërues të rrjedhes së gravitetit, konsumi mesatar specifik i energjisë elektrike për furnizimin me ujëtek zona e shërbimeve komunale është i ulët me vlerë 0.175-0.25 kWh/m³.

Kanalizimi i ujërave të zeza në pjesën urbane të Gjakovës është 45km i gjatë. Për momentin funksionon mirë. Ekziston edhe kanalizimi i ujërave atmosferik me gjatësi prej 42km. Trajtimi i ujërave të zeza nuk bëhet fare pasi që impianti ekzistues edhe pse ka kapacitet të vogël, ai nuk funksionon fare. Ka zona në pjesën urbane të qytetit të cilat fare nuk kanë rrjet të kanalizimit. Në pjesën rurale gjendja është edhe më e vështirë pasi që kanalizimi në shumicën e fshatrave nuk ekziston fare.

KRU Radoniq Sh.A. Gjakovë realizon edhe operimin e sistemit të mbledhjes së ujërave të zeza. Komuna, si pronar i Kompanisë kontrollon operimin, performancën dhe financimin e sektoreve të furnizimit me ujë dhe ujrave të zeza. Disa pjesë të gjithë fshatrave të sipërpërmendura kanë disa kolektorë shumë të vjetër për ujrat e zeza, të cilët kanë një kapacitet prej 2,000 m² dhe që lidhin afërsisht 20,000 abonentë të ujërave të zeza. Për shkak të gjendjes së keqe të sistemit dhe mungesës së një impianti për trajtimin e ujërave të zeza, këto ujra humbin në sistemin e kolektorit ndërsa pjesa e mbetur depozitohet në lumin Sitnica. Ndërtimi i një impianti për ujrat e zeza është emergjent. Komuna nuk ka mundur të sigurojë konsumin energjetike vjetor të ujësjellësit.

4.2.2. KONSUMI I ENERGJISE NGA MBLEDHJA E METJEVE URBANE

Rajoni i Gjakovës përbëhet nga tri komuna: Gjakova, Juniku dhe Deçani. Ai ka një sipërfaqe prej 959 km², ndërsa, në bazë të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, i ka 140,659 banorë. KRM "Çabrat" operon vetëm në territorin e Komunës të Gjakovës. Komuna e Junikut shërbehet nga një kompani private, ndërsa në Deçan ofruet të shërbimeve janë kompania publike komunale dhe një kompani private. Komunitat e Deçanit dhe Junikut i deponojnë mbeturinat e tyre në deponinë e Pejës, ndërsa Gjakova mbeturinat e mbledhura i deponon përkohësisht në stacionin e saj të transferit, ndërsa ato pastaj transportohen në deponinë e Prizrenit. Mbulimi i rajonit të Gjakovës me shërbimet e mbledhjes së mbeturinave është 37.6%, që është shkalla më e ulët e mbulimit në vend. Shkalla më e ulët e mbulimit është në

Deçan, ndërsa më e larta është në Junik (57.6%). Shkalla e arkëtimit është 88.4%, e cila është mjaft e lartë krahasuar me rajonet e tjera, ndërsa shkalla më e lartë e arkëtimit është në Deçan dhe më e ulëta në Junik (66.8%).

Në anketën për deponitë ilegale të pranverës së vitit 2017, në këtë rajon janë identifikuar 95 deponi ilegale, që do të thotë 0.14 deponi ilegale për km². Komuna më e ndotur është Juniku (0.28 di/km²), ndërsa komuna më e pandotur në rajon është Gjakova (0.07 di/km²). Përafërsisht 580.000 tonë (0.9 kg / ditë, për kokë banori) të mbeturinave gjenerohen në Kosovë. Ndërsa në Gjakovë gjenerimi i mbetjeve për banorë është 0.63 kg / ditë. Nga 580,000 tonë të gjeneruar, afërsisht 420,000 tonë (72%) të mbeturinave grumbullohen nga operatorë public e privat dhe më pas deponohen në deponitë sanitare ose josanitare. Ndërsa në Gjakovë grumbullohen rreth 86.5% e të gjitha mbetjeve urbane. Komuna nuk ka mundur të sigurojë konsumin energjetike vjetor të mbledhjes së mbetjeve urbane.

4.3. KONSUMI I ENERGJISË NGA SEKTORI BUJQESISË

Komuna e Gjakovës shtrihet përgjatë hapësirës tektonike të rrafshit të Dukagjinit, i cili gjendet në mes të bjeshkëve të: Pashtrikut, Mokrra Gorës dhe Sharrit, në lartësi nga 360m deri në mbi 2650m mbi nivelin e detit. Luginat e lumenjve Drini i Bardhë, Ereniku, Krena, Trava dhe Trakaniqi, si dhe të disa përroskave, krijojnë në Komunën e Gjakovës rrafshina, shumica e të cilave me tokë të punueshme e shumë pjellore. Nisur nga këta faktorë dhe nga kushtet e përshtatshme klimatike, bujqësia përfaqëson një potencial të madh zhvillimi për ekonominë e komunës. Kjo degë e ekonomisë e Komunës së Gjakovës ka një perspektive të madhe për zhvillim duke pasur për bazë kushtet klimatike, tokësore, sistemin e ujitjes si dhe traditën e popullatës që merret me bujqësi. Mundësi të riaktivizimit ka edhe industria ushqimore e cila ka vepruar në të kaluarën.

Në zonat rurale, bujqësia është 70% si burim i jetesës. Gjithsej janë 55684 ha tokë, prej të cilës 29445 në sektorin shoqërorë dhe 26239 në atë privat. Blegtoria është një degë tjetër strategjike i zhvillimit ekonomik të Komunës së Gjakovës. Ajo favorizohet sidomos nga sipërfaqja e madhe me livadhe e kullota brenda territorit të komunës si dhe nga tradita e zhvillimit të blegtorisë në këto anë. Në territorin e Komunës së Gjakovës, në sektorin individual, janë aktualisht 75 ferma të pulave vojse me kapacitet prej 206.810 pula, ndërkohe që shfrytëzohet pak më shumë se gjysma e kapacitetit të tyre. Janë, gjithashtu, 15 ferma të bojlerëve (rritja e zogjve) me kapacitet 140.800 bojlerë në turne si dhe 4 mull për prodhimin e koncentratit me kapacitet 18.000 ton/vit.

Zonat rurale të Gjakovës dhe Prizrenit janë nga zonat me prodhimtari më të lartë krahasuar me të gjithë zonat e tjera të Kosovës. Ekonomia ka qene dhe do të mbetet për shumë vite e dominuar nga aktiviteti bujqësor në Kosovë. Përsa specifikë e rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto (GDP) nga sektori i bujqësisë ishte 26-32% për të gjithë periudhën 1999-2017. Megjithatë, rritja e të ardhurave nga prodhimi i bimevë, blegtoria, agro-industria, pyjet, mbetet një alternativë kryesore për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Zhvillimi i sektorit të bujqësisë kushtezohet nga shumë faktorë, ku më të rëndësishmit janë:

- Fermat me madhësi minimale dhe shumë të fragmentizuara,
- Problemet lidhur me pronësinëmbi tokën bujqësore,
- Çmime të larta të inputeve dhe një sistem i paorganizuar dhe jo-efektiv i prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve bujqësore,
- Mungesa apo pamjaftueshmëria e kreditimit të bujqësisë,
- Mungesa apo pamjaftueshmëria e mekanikës bujqësore.

Për të bërë të mundur parashikimin e nevojave energjetike për këtë sektor, ky i fundit është duhet të konsiderohet i përbërë nga 3 nënsektorë, të cilët janë: bujqësia, blegtoria, pyjet. Vlera e shtuar nga sektori bujqësor, së bashku me intensitetet energjetike, duhet të përdoret si treguesit bazë për parashikimin e kërkesave energjetike për të ardhmen. Bujqësia, si nënsektor në Komunën e Gjakovës, do të ketë kërkesën më të madhe për Energji dhe lëndet

djegëse dominuese në këtë sektor janë dizeli me 75-85%. Gjithashtu, në këtë figurë vihet re se një rritje deri në vitin 2030 do të ketë edhe konsumi i energjisë elektrike, megjithesë zë një përqindje të vogël në totalin e lëndëve energjitike. Kjo do të vijë më shumë si rezultat i modernizimit të sistemeve të ujitjes dhe modernizimit të stallave të blektorisë. Komuna nuk ka mund të siguroj konsumin energjetike vjetor nga aktivitetet e fermave bujqesore dhe blektorale.

4.4. KONSUMI I ENERGJISË NGA SEKTORI TRANSPORTIT

4.4.1. STOKU I TRANSPORTIT TË KOMUNËS

Sektori i transportit në këtë sesion është analizuar për dy grupe të sektorit të transportit: 1) transportin nga flota komunale e automjeteve që është e lidhur drejt për drejt me shpenzimet komunale – ky grup do të analizohet në detaje nga ana sasiore në këtë sesion; 2) sektorin e transportit në përgjithësi në komune – ky grup do të analizohet nga ana cilësore meqenëse komuna ka një ndikim të vogël në shpenzimet e këtij grupi. Konsulentët kanë arritur të sigurojnë nga Komuna e Gjakovës të dhëna për stokun e flotes komunale e automjeteve. Në figurën 34 është dhënë numri i kilometrave të përshkruar çdo muaj flota komunale e automjeteve. Ndërsa në figurat 38-39 është dhënë konsumi mujor i karburanteve dhe shpenzimet mujore për të gjithë floten komunale e automjeteve.




Figura 38: Numri i kilometrave të përshkruar çdo muaj flota komunale e automjeteve (km/muaj)




Figura 39: Konsumi mujor i karburanteve nga flota komunale e automjeteve (litra/muaj)

Konsulentët kanë llogaritur konsumin specifik të konsumit të lëndës djegëse për 100 km (figura 40) të përshkruar si mëstare mujore e flotes komunale e automjeteve. Analiza e vlerave tregon se ky tregues varion nga vlera maksimale 12.47 litra/100 km në 7.39 litra/100 km. Analiza tregon në mënyrë të qartë se konsumet specifike janë shumë të larta dhe një manaxhim më i mirë sjell kursime të rëndësishme të energjisë në floten komunale të automjeteve. Nepermjet manaxhimit më të mirë të mjeteve të flotes së automjeteve me një skedulim shumë më të mirë të programit të levizjes mund të arrihet që i gjithë stoku mund të reduktoje konsumin specifik nga çfarëdo vlerë mujore në vlerën minimale prej 7.39 litra/100 km të arritur në muajin Maj 2018. Bazuar në këtë koncept është ndërtuar skenari i EE (figura 42) nepermjet një manaxhimi më të mirë të skedulimit të levizjes së stafit të drejtorive të ndryshme për realizimin e detyrave ditore.




Figura 40: Shpenzimet mujore flota komunale e automjeteve (km/muaj)



Figura 41: Konsumi specifik i karburanteve nga flota komunale e automjeteve (litra/100 km)




Figura 42: Llogaritja e nevojave energjetike per cdo muaj per skenarin e EE (MWh/muaj)




Figura 43: Llogaritja e kursimeve energjetike per cdo muaj per skenarin e EE (MWh/muaj)

Analiza e mesiperme tregon ne menyre te qarte vetem si rezultat manaxhimi me te mire mund te arrihet nje kursim 36.492 MWh/vit afersisht i barabarte me 17.13% (figura 43). Gjakova eshte e lidhur mire me qytetet kryesore te Kosovës si dhe Shqipërinë veriore. Rrjeti i nivelit më të lartë rrugorë në këtë komunë, kalon kryesisht përmes luginës së lumit, përgjatë me aksin e vendbanimit. Kjo mundëson qasje më të lehtë në rrugët kryesore pjesës me të madhe të popullsisë. Një rrugë magjistrale kalon përmes komunës, rruga magjistrale M9-1 nga Prishtina për në Tropojë në Shqipëri. Katër rrugë rajonale e lidhin Gjakovën me qytetet dhe fshatrat tjera në Kosovën perëndimore. Një ndër rrugët më të rëndësishme është rruga R107 ndërmjet Pejës dhe Prizrenit. Rruga R109 kalon përmes luginës së Erenikut, duke i lidhur fshatrat atje me Junikun dhe Deçanin. Rruga R203 është linjë e drejtpërdrejt ndërmjet Gjakovës dhe Kukësit në Shqipëri, dhe rruga R112 kalon përmes zonës së Hasit.

Rrugët magjistrale dhe rajonale janë të asfaltuara. Megjithëse në krahasim me standardin evropian, kualiteti është më i dobët. Atë janë të ngushta, dhe ju mungon pushimoret dhe në shumicën e rasteve rrugëve iu mungon trakë për kalimtarë. Meqenëse

rrugët përdorën nga këmbësorët si dhe nga trafiku i motorizuar, ku përfshihet një pjesë e madhe e nxënësve, kjo paraqet një problem serioz. Rrugët e nivelit më të lartë janë plotësuar nga një rrjet i rrugëve lokale. Kualiteti i këtyre rrugëve në shumicën e rasteve është i dobët, dhe shumica nuk mund të përdoren në të gjitha motet. Gjithashtu fshatrat më të mëdha, p.sh. Novoselë dhe Bec, janë të arritshme vetëm nga rrugët lokale. Në vitin 2017, në Kosovë janë të regjistruara 334,440 mjete motorike dhe jomotorike, ku prej tyre 18,559 janë vetura nën 3.5 ton, ose 4.64 për qind më shumë sesa në vitin 2016, në këtë vit ishin regjistruar 260,291 vetura. Nga të dhënat e prezantuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në raportin 'Statistikat e Transportit dhe Telekomunikacionit, tremujori i katërt 2017', me të dhëna mbi transportin ajror, hekurudhor dhe postë telekomunikimin. Sipas ASK-së, në territorin e Kosovës ka 2 mijë e 43 kilometër rrugë, prej tyre 64 për qind janë rrugë rajonale, 31 për qind janë nacionale, ndërsa 5 për qind janë autoudhë. Stoku i makinave të transportit rrugor në Gjakovë është afërsisht 26500 makina dhe nga keto rreth 7500 janë vetura.

4.4.2. TRANSPORTI PUBLIK

Rritja e cilësisë dhe efikasitetit të sistemeve të transportit urban është kritik për të inkurajuar individet që të kalojnë nga makinat personale në transportin urban. Transporti urban është një formë udhëtimi e ofruar në vend për t'ua mundësuar më shumë njerëzve të udhëtojnë së bashku përgjatë rrugëve të caktuara. Një prej problemeve më të theksuara në Gjakovë është trafiku dhe meqënëse prioritet i një qytetit duhet të jetë gjithmonë qytetari duhet marrë parasysh reformimin e trafikut urban në Gjakovë. Qytetet me popullsi më të madhe, siç është Gjakova në Kosovë, e ndiejnë më shumë ndikimin e emetimit nga automjetet, gjë që me rritjen e klasës së mesme dhe me rritjen e numrit të makinave personale çon drejt ndotjes masive. E vetmja mënyrë për të ndryshuar këtë prirje është miratimi i transportit urban. Autobusët duhet të kenë: firmën (respektivisht emërtimin e transportuesit) në pjesën anësore; numrin e linjës me kohën e nisjes dhe kohën e arritjes, ose intervalin e lëvizjes në stacionin e fundit orarin e udhëtimit dhe çmimin e transportit (të vendosura në vend të dukshëm) dhe mbishkrimin për ndalimin e pirjes së duhanit. Sa i përket transportit urban të udhëtarëve, qarkullojnë 48 nisje, si dhe veprojnë 4 operatorë të cilët i kryejnë shërbimet e taksive. Disa nga avantazhet e përdorimit të transportit publik:

- Redukton koston e transportit për qytetarët;
- Reduktimi i mbingarkesës në rrugët e Gjakovës;
- Përmison produktivitetin;
- Prandalon smogun në qytet;
- Parandalon ngrohjen globale;
- Siguron një ekosistem më të pastër.

Komuna e Gjakovës krahas implementimit të transportit urban, njëkohësisht është duke bërë analiza më qëllim të gjetjes së opsioneve më të efektshme të transportit për infrastrukturën rrugore ekzistuese, dhe njëri nga opsionet mund të jetë aplikimi më i madh i lëvizjes njëdrejtimshme në një pjesë të konsiderueshme të rrugëve në zonën urbane.

5. ANALIZA E POTENCIALIT TË EE SIPAS SEKTORËVË

5.1. SEKTORI I SHËRBIMEVE

5.1.1. NDËRTESET PUBLIKE

Stoku ekzistues i ndërtesave publike është ndërtuar ndërmjet viteve 1944 dhe 2018 dhe pjesa dërmuese midis viteve 1960-1980 dhe pas vitit 1999. Furnizimi me ngrohje është i mjaftueshëm për të siguruar një ngrohje por në disa raste është jo sipas kushteve të komfortit duke mos garantuar një temperaturë prej 20 °C. Ndërtesat në pjesën dërmuese të tyre shfaqin humbje të mëdha të energjisë nëpërmjet mbështjelljes së tyre dhe dritareve me dy xhama dhe në disa raste edhe me një tek-xham, duke kërkuar kështu një sasi të madhe energjie të shpenzuar për ngrohjen e hapësirave. Në gjendjen aktuale, shumë ndërtesa nuk ofrojnë parametrat e operimit sipas normave dhe standarteve për shkak të humbjeve të mëdha termike të ndërtesave. Me anë të buxhetit lokal, në disa shkolla janë zbatuar disa masa të rinovimit nga pikpamja e EE. Uji i ngrohtë kërkohet vetëm nga kopshtet dhe prodhohet me bolliere elektrik. Komuna operon mirëmbajtjen e të gjithë stokut të ndërtesave publike, për të ruajtur kushtet normale të strukturave dhe performancës së shkollave dhe kopshteve në kushtet të një operimi normal. Pas rishikimit të plotë të dokumentacionit të inxhinieringut dhe ndërtimit të të gjithë ndërtesave publike, u hartuan në detaje pyetsori sipas EMASOFT-it, si dhe dokumentacionit të operimit dhe menaxhimit, u shqyrtuan proceset me konsum të lartë energjie të gjithë ndërtesave publike për këtë komunë. Inspektimi u fokusua në këto çështje kyçe:

- Zarfi Mbështjelles i Ndërtesave (përfshire izolimet e mureve të jashtme në se ekzistojnë apo jo, izolimet e kulmeve/tarracave në se ekzistojnë apo jo, izolimet e mureve të jashtme në se ekzistojnë apo jo, izolimet e dyshemeve në se ekzistojnë apo jo, llojet e dritareve, llojeve e dyerve të jashtme, etj.);
- Sistemet e Ventilimeve (nëse ekzistojnë, nëse jo duhet të përshkruhen pasojat e mungesës të tij);
- Sistemet e Ndricimit (përfshire intensitetin e ndricimit, efikasitetin e përdorimit dhe kontrollin);
- Karakteristikat e përgjithshme të sistemeve elektrike;
- Operimi i sistemeve në ndërtesa (përfshire sistemet e ngrohjeve/ftohjeve);
- Sistemet e Ngrohjes/Ftohjes: karakteristikat e përgjithshme (lloji i lëndës djegëse, numri i njëësive të operimit, koeficienti i performancës etj.)
- Muret në disa ndërtesa publike nuk janë të termoizoluara dhe shpesh suvaja është e plasur në disa vende.
- Catite/kulmet e ndërtesave përbëhen nga catia e me tjegulla në shumicën dërmuese të rasteve. Catite/kulmet e ndërtesave nuk kanë termoizolim në një pjesë të madhe të ndërtesave. Performanca energjetike e catisë është në kushte jo të mira termike pasi një pjesë e tyre kanë edhe rrjedhje të vogla;
- Dritaret: Në këto ndërtesa janë instaluar disa lloje dritarësh. Instalimi dhe performanca energjetike e dritareve janë në kushte mesatare; Në kemi krijimin e lagështisë në pjesë të dritareve për shkak të mos izolimit dhe krijimit të urave termike;

Në disa ndërtesa ka dëmtime lagështie për shkak të arsyeve të mëposhtme:

- Uji si kondensim në hapësirat e brendshme të ndërtesave;
- Tualetet kanë ventilim natyror dhe për shkak të mos izolimit në kemi krijimin e lagështisë;
- Sistemet e shkarkimit të ujërave të zeza në shumë ndërtesa është i vjetër dhe nevojiten instalime të reja;
- Sistemet e ujit sanitar nuk janë në gjendje të mirë, kështu që duhet të bëhen instalime të reja në shumicën dërmuese të ndërtesave;
- Sistemet elektrik dhe ato të ndricimit janë në gjendje mesatare. Intensiteti i ndricimit nuk përmbush normat në shumë ndërtesa në disa orë të vitit ka

ndërpreje të furnizimit me energji elektrike. Komuna përpiqet nëpërmjet gjeneratorëve të plotësojë kërkesen – por kjo është me konsto shumë të lartë për komunën.

- Sistemet e ngrohjes/ftohjes janë në gjendje mesatare përsa lidhet me nivelin e efikasitetit të energjisë, me kalidat qendrore, me ngrohës elektrik dhe me disa soba druri individuale me dru zjarri.

Ekziston një kërkesë për rritjen e komfortit të brendshëm të hapësirave në lidhje me temperaturën, ndricimin dhe sigurinë. Për më tepër, nevojitet të kryhen përmirësime në strukturën e shumë ndërtesave në përgjithësi dhe në cati nëvecanti për të rritur jetëgjatësinë e ndërtesës. Ekziston një nevojënormale për përmirësimin e stokut të ndërtesave publike të komunës, nëpërmjet futjes së masave të efikasitetit të energjisë që vijnë si nga pikpamja e kërkesës ashtu edhe nga pikpamja e furnizimit:

1. Termoizolimi i mureve të jashtme për ato ndërtesa që ne nuk e kanë pse që e kanë me një shtresë shumë të hollë ose të vjetëruar;
2. Termoizolimi i catisë/tarracave për ato ndërtesa që ne nuk e kanë pse që e kanë me një shtresë shumë të hollëose te vjetëruar;
3. Instalimi i dritareve me dopio/tre xhama dhe dyerve tëjashtme shumë eficiente për ato ndërtesa që i kanë të vjetëruara;
4. Instalimi i sistemeve të ngrohjes qendrore me pelletë
5. Instalimi i valvulave termostatike
6. Instalimi i paneleve diellore për ujë te ngrohtë
7. Instalimi i sistemeve të kombinuara të sistemeve qendrore me panele diellore
8. Instalimi i paneleve diellore fotovoltaike
9. Instalimi i sistemeve eficiente të ventillimit
10. Instalimi i sistemeve eficiente të ftohjes së hapësirave
11. Instalimi i sistemeve eficiente të gatimit
12. Instalimi i pajisjeve elektroshtepiake me A++, etj.

5.1.2. NDRICIMI PUBLIK I RRUGEVE

Vlen të theksohet se Komuna e Gjakovës ka kryer një numër tëmadhe investimesh për ndricimin e rrugëve të fasadave të shumë ndërtesave tëqytetit. Ne tabelën 9 që vijon jepen disa nga rehabilitimet rrënjësore të bëra nga Komuna në pesë vitet e fundit.

Tabela 9: Disa nga rrugët në të cilat është ndërhyrë për përmirësimin e ndricimit në Komunën e Gjakovës

1	MAJI	1999	7	KORRIKU	1998
12		QERSHORI	9		NËNTORI
13		QERSHORI		ABDULLAH	HADRI
14		MARTIRËT		ABDURRAHIM	BUZA
14	PRILLI	1999		ABEDIN	TËRBESHI
14		QERSHORI		ADEM	ARIF
17	MAJI	1999		ADEM	FETA
17		MARTIRËT		ADEM	BAJRAMI
17	SHKURTI	2008		ADEM	BRAHIMAJ
2	KORRIKU	1990		ADEM	DELIJA
27	GUSHTI			ADEM	GUTAJ
27				ADEM	JASHARI
27	MARSI	1999		ADEM	QARRI
27		PRILLI		ADEM	ZEQIRI
29	MAJ	1998		ADONIS	BEÇI
4	QERSHORI	1999		ADRIATIK	ALPE
5	PRILL	1999		AEROPORTI	
6		MARTIRËT		FRIM	HASI
7	GUSHTI			AFRIM NUZA	

Sasia totale e energjisë elektrike të konsumuar në 2017 për ndricimin e rrugëve ishte 1,280,644 kWh. Kostot vjetore të energjisë elektrike për këtë sektor arrijnë vlerën afërsisht të barabartë me 122,302 Euro për vit. Gjatësia totale e rrugëve arrijnë në 251 km me numër total llambash prej 4,958, nga të cilat rreth 50-60% janë të ndricuara plotësisht ose pjesërisht. Kapaciteti mesatar i pikave të ndricimi është 64 W. Numri sipas kategorive të llambave të ndricimit rrugor është dhënë në figurat 44-45. Kapaciteti mesatar sipas kategorive të llambave të ndricimit rrugor (i shprehur në W) është dhënë në figurat 46-47. Kapaciteti total sipas kategorive të llambave të ndricimit rrugor është dhënë në figurat 48-49.




FIGURA 44: Numri sipas kategorive të llambave të ndricimit rrugor




FIGURA 45: Numri sipas kategorive të llambave të ndricimit rrugor (NE %)




Figura 46: Kapaciteti mesatar sipas kategorive të llambave të ndricimit (W)




FIGURA 47: Kapaciteti mesatar sipas kategorive të llambave të ndricimit (W)




FIGURA 48: Kapaciteti total sipas kategorive të llambave të ndriçimit (%)

Aktualisht, 4.84% e llambave të instaluara janë llamba konvencionale prej mercuri, jo-eficiente dhe me një kapacitet prej 150 W. 16.16% e llambave janë me presion të lartë zhive dhe ky grup dominohet nga llamba me kapacitet 2125 W. 51.15% janë llamba kompakte fluoreshente prej të cilave aplikohen kryesisht llambat 43 W. 27.85% e ndricuesve të rrugës janë teknologji LED dhe duhet theksuar se Komuna e Gjakovës ka bërë një punë shumë të mirë dhe vazhdo të bëjë në drejtim të vendosjes të llambave LED në cdo rrugë. Kapaciteti i ndricuesve LED me aftësi për reduktim të ndricimit është 55-65 W. Frekuenca e zëvendësimit të llambave konvencionale me presion të lartë prej mercuri dhe llambave CFL është shumë e lartë (cdo vit ose cdo dy vjet). Për llambat me natrium, zëvendësimi kërkohet të kryhet cdo 3 ose 4 vjet. Llambat e rrugëve të instaluara aktualisht janë pjesërisht llamba të vjetra, e cila e bën të vështirë zëvendësimin e tyre të thjeshtë me teknologji LED. Për më tepër, shpërndarja e dritës në mënyrë sinjifikative dhe kjo mund të çojë në zona të zeza (të pandricuara) në sipërfaqen e rruges. Orët mesatare të operimit të tyre vjetor arrijnë në 4015 orë për vit. Energjia elektrike për ndricim rrugor (SL) sigurohet nga një furnizues energjie lokal me nivel voltazhi 220 V me të njëjtin rrjet shpërndarjeje si klientet rezidencial. Për cdo rrugë ose segment të percaktuar ekziston njëkabineti ndricimi i cili është instaluar për matjen e energjisë. Kontrolli i operimit të tyre realizohet me anë të një orë astronomike bashkë me një qelizë fotovoltaike.

Në disa llamba me presion të lartë prej Natriumi (150 W/250W), llambat ishin shkëmbyer me CFL (80W ose me pak) për të reduktuar konsumin e energjisë elektrike, por ato kanë sjellë një nivel të dobët ndricimi dhe kosto të larta mirëmbajtjeje (llambat digjen me shpejt). Në pjesën e vjetër të qytetit, në ndricuesit të cilët ishin dizenuar për llambat me presion të lartë prej mercuri 125 W, ato aktualisht janë zëvendësuar me llamba CFLs 30-40W, të cilat gjithashtu kanë sjellë një nivel të dobët ndricimi. Zakonisht shtyllat e ndricimit janë 8 metra të gjata. Distanca ndërmjet shtyllave (e rrugës kryesore) është e barabartë me 25m, 30 m dhe vetëm në disa raste vetëm 50 m.

Projektet kryesore të kerkuara nga Komuna janë: **Zëvendëimi i llambave me presion të lartë prej mercuri (HPM), CFB, halogjene dhe natriumi (HPS) me llamba LED.** Ekziston nevoja për zëvendësimin i të gjithë stokut të llambave të ndricuesve (prej mercuri, natriumi, CFL), me llamba LED, niveli i ndricimit ka nevojë shumë të madhe për përmirsim. Rreth 20% (shtylla të reja dhe pjesët montuese të kokave të ndricimit duhet të instalohen përveç ndricuesve. Duhet të kryhet njëstudim para-fizibiliteti për të gjithë pjesën e vjetër të qytetit duke marrë në konsideratë dizanjin përkatëse.

6. POTENCIALI I KURSIMIT TE ENERGJISË DHE REDUKTIMIT TË GAZEVE ME EFEKTIN SERRË (GHG)

Potenciali i kursimit të energjisë është shumë i lartë në të gjithë sektoret ekonomik në Komunën e Gjakovës. Kursim më të lartë sjell sektori i ndërtesave publike, ndricimit të rrugëve, furnizimit me ujë të pishëm dhe mbledhjes dhe trajtimit të mbetjeve urbane. Kursimi i energjisë sjell reduktim të konsumit të lëndëve djegëse në realizimin e të gjithë shërbimeve energjetike në të gjithë sektorët e sipër përmendur, duke sjellë njëkohësisht reduktim të emetimeve të gazeve acide (SO₂, CO, NO_x, NMVO_x) dhe reduktim të gazeve me efekt serë (CO₂, N₂O, CH₄). Kapitulli 8 paraqet në detaje potencialet e kursimit të energjisë në të gjithë sektorët ekonomik në Komunën e Gjakovës. Gjithashtu, për sektorët e ndërtesave publike dhe ndricimit publik të rrugëve janë llogaritur dhe prezantuar në detaje në kapitullin 8, në detaje vlerat e reduktimi të emetimeve të gazeve acide (SO₂, CO, NO_x, NMVO_x) dhe reduktim të gazeve me efekt serë (CO₂, N₂O, CH₄).

7. TARGETAT E KURSIMIT TË ENERGJISË

Objektivat gjithëpërfshirëse të planit të eficientës së energjisë janë të reduktojnë konsumin e energjisë dhe të kursejnë buxhetin e Komunës për shpenzime energjetike, njëkohësisht edhe të përmisojë shërbimet e ndryshme për qytetaret dhe të nxisë zhvillimin e sektorit të turizmit.

Objekti i kursimit të energjisë i planit të Komunës për eficientë energjie për periudhën 2017-2030 është që të arrijë kursime vjetore të energjisë prej 14 GWh per vit, i cili përfaqëson një reduktim me rreth 40-42% të kursimit të energjisë të konsumit energjetic të ndërtesave publike dhe ndricimit rrugor të Komunës ose deri në afërsisht 6.5-8% të konsumit të përgjithshëm energjetic të Gjakovës krahasuar me vitin bazë 2017. Targetet e administratës Komunale për të eksploruar potencialin teknik dhe ekonomik në lidhje me eficientën e energjisë tek sektorët e cilët janë nën kontrollin e Komunës janë prezantuar në tabelën 10. Mundësitë e kursimit të energjisë përforcojnë rëndësinë e zbatimit të masave të EE dhe ato gjenerojnë kursime vjetore të cilat përfaqësojnë 25-30% të shpenzimeve tek buxheti aktual vjetor të energjisë.

Tabela 10: Targetat e EE për Komunën e Gjakovës

Ndërtesat publike	
✓	Minimumi 40% energji e kursyer nga ngrohja për të gjithë ndërtesat publike nga rehabilitimi
✓	50% kursim energjie nga ndricimi duke zëvendësuar ndricimin e brendëshëm jo eficient në shumicën e ndërtesave me llamba LED.
✓	Përdorimi i energjisë se rinovueshme që të mbulojë minimumi 20-25% të kërkesës për ngrohje të ujtit të ngrohtë për të gjithë ndërtesat publike
Ndricimi i rrugëve	
✓	Minimumi 50% kursim energjie për të plotësuar sistemin e ndricimit publik

Përveç kursimeve të kostos për shpenzimet e energjisë, zbatimi i masave të EE sjell dhe disa përfitime të tjera të cilat shpesh neglizhohen të përmenden dhe janë dhene në tabelën 11.

Tabela 11: Përfitime të shumfishta të efikasitetit të energjisë

Sektori	Shembujt e masave të efikasitetit të energjisë	Përfitime të shumfishta
Ndertesat publike Komunale	<ul style="list-style-type: none"> Rehabilitimi i ndërtesave publike të tilla si shkolla, kopshte fëmijesh dhe ndërtesa administrative Përmirsim të menaxhimit të energjisë në ndërtesa 	<ul style="list-style-type: none"> Rritje e komfortit dhe shëndetit të hapësirave të brendshme Përmirsim i mjedisit të studimit për fëmijet dhe studentët Rritje e jetegjatësisë dhe atraktivitetit të ndërtesave
Ndricimi i rrugëve	<ul style="list-style-type: none"> Përmirsim të ndricimit të rrugëve me teknologji LED Zgjerim të ndricimit rrugor, përfshirë ndricimin e trotuareve, parqeve, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> Rritje e sigurisë nga trafiku Rritje e sigurisë për këmbësorët Përmirsim i atraktivitetit të zonave historike për banorët dhe turistët

Nisma e administratës Komunale për të investuar në një infrastrukturë urbane të qëndrueshme dhe me standarte mjedisore e rrit vlerësimin dhe atraksionin e Komunës tek qytetarët, turistët dhe bizneset. Gjithashtu kjo nismë mund të risë ndërgjegjësimin në lidhje me teknologjitë e praktikën e kursimit të energjisë. Përveç shfaqes së përfitimeve të efikasitetit të energjisë, eksperiencën e përftuar mund të përdoret për të zgjeruar konceptin e kursimit të energjisë dhe në sektorë të tjerë, si ai rezidencial dhe komercial.

Paketa e investimit kërkon një skedul në lidhje me zbatimin e fazave, për shkak të a) kompleksitetit dhe kërkesës për investim, b) prioritete të ndryshme për shkak të profitabilitetit të investimeve, c) koha e cila kërkohe për studimet e fizibilitetit dhe strukturimin financiar, dhe d) disponueshmëria e kapaciteteve dhe kushtet e kërkuara në lidhje me strukturën si një parakusht për një zbatim të suksesshëm. Rekomandohet që të fillohet me masa EE me periudhë vetëshlyerje afat-shkurtra, të cilat kanë një shtrirje kohore nga 2019 deri në 2021 dhe me pas të vazhdohet me masat afat-gjata EE të cilat kanë një shtrirje kohore nga 2022 – 2030 në mënyrë që të arrihen përfitimet e parashikuara në kursimin e energjisë deri në 2030. Si rregull, duhet të zbatohen fillimisht ato masa që mund të sjellin kursime në energji dhe përfitime të tjera sa më shpejt të jetë e mundur.

8. MASAT E EE PËR TË REALIZUAR TARGETAT E KURSMIT TË ENERJISË

8.1. INFORMACION NË LIDHJE ME KAPACITETET TEKNIKE PËR ZBATIMIN E MASAVE TË EE

8.1.1. MASAT E POLITIKËS TË PROMOVIMIT TË EE DHE NDRYSHIMIT TË SJELLJES TË KONSUMATORËVE KARSHI KONSUMIT TË ENERJISË

Kuadri ligjor mbështetës: Miratimi i ligjit për efikasitetin e energjisë tani ofron bazën mbi të cilën do të zbatohen veprime sapa të përgatiten aktet nënligjore të nevojshme. Në të vërtetë, një tjetër parim i politikës kombëtare për efikasitetin e energjisë, siç përcaktohet në ligjin për efikasitetin e energjisë, është edukimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë dhe përdoruesve fundorë në lidhje me nevojën dhe përfitimet nga ulja e konsumit jo eficient të energjisë. Ndërkohë, ligji i dedikohet ofrimit të informimit dhe trajnimit. Kjo kërkon që Agjencisë Kosovare për Efikasitetin e Energjisë të:

- Publikojë, në faqen e saj zyrtare të internetit, informacion mbi mekanizmat, botimet, kuadrin financiar dhe ligjor i cili mund të ndihmojë në arritjen e kursimeve të energjisë.
- Informojë konsumatorin final mbi metodat dhe praktikrat e ndryshme që shërbejnë për të rritur kursimet e energjisë.
- Ofrojë trajnime për institucionet qeveritare dhe autoritetet vendore, audituesit e energjisë, si dhe menaxherët e energjisë.

Ligji për eficiencën e energjisë lejon gjithashtu që financimet, nëpërmjet Fondit për Eficiencën e Energjisë, të drejtohen tek programe që ofrojnë fushata ndërgjegjësimit dhe aktivitete edukimi në lidhje me eficiencën e energjisë. Etiketimi energjetik është gjithashtu i njohur si një bazë për rritjen e informimit të konsumatorit mbi eficiencën e energjisë.

Masat e parashikuara për këtë kategori nga Plani i EE të Kosovës janë shtyrë kryesisht për shkak të vonesave në miratimin e ligjit për eficiencën e energjisë, si dhe krijimit të Fondit për Eficiencën e Energjisë, e cila parashikohet të drejtojë shumë prej iniciativave. Megjithatë, disa aktivitete janë ndërmarrë dhe përfshijnë, një program i GIZ-it (2017-2019) për auditimin energjetik dhe menaxhimin e energjisë, i cili ka trajnuar deri tani 50 auditore dhe menaxherë komunal të energjisë në Kosovë; dhe një sërë programesh të ndërmarrë nga AKEE për promovimin e eficiencës së energjisë në shumë sektorë në përgjithësi dhe Komuna të ndryshme të Kosovës (përfshi edhe komunën e Gjakovës) në vecanti. Në Kosovë, bankat e nivelit të dytë kanë krijuar një eksperiencë dhe njohuri shumë të mira në lidhje me masat për EE-në, nëpërmjet programeve të mbështetura nga EBRD-ja, IFC-ja, KfW-ja dhe Fondi 'Green for Growth'. Tregu financiar Kosovar ka një kosto relativisht të ulët të financimit të borxhit, e kushtëzuar nga një normë interesi e ulët e bonove të thesarit. Bankat janë duke huazuar në nivelin 4.9-5.5% për hua të garantuara dhe 7-8.5% për hua të pa-garantuara.

- Bankat kanë një likuiditet të lartë (over-liquidity) dhe janë në treg për ofrimin e produkteve të reja financiare, pjesa më e madhe e bankave janë aktive në kërkimin e produkteve të reja për huadhënie.
- Bankat kanë linja kreditimi të dedikuara për eficiencën e energjisë. Eficienca e energjisë është mbuluar direkt ose indirekt nga produkte të ndryshme huaje në bankat e tjera nëpërmjet huave shumëqëllimëshe/gjithëqëllimëshe.
- Nevojat për asistencë teknike të identifikuar nga bankat përfshijnë:
 - Ekspertizën – mbi praktikrat më të mira, karakteristikat e projekteve për EE-në në sektorin e banesave dhe performancën financiare.
 - Dizajnimin e produktit, vlerësimin e projektit, kujdesin teknik.
 - Marketingun dhe reklamimin e produktit.
 - Mbështetjen ligjore – përgatitja e akteve nënligjore, mbështetja për zbatim.
 - Trajnimin për bankierët mbi aftësitë teknike.
 - Fushatat për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mjetet/materialet për to.

Një numër masash të reja janë propozuar për t'u zbatuar të cilat lidhen me rritjen e informimit të konsumatorit, rritjen e ndërgjegjësimit dhe trajnimin. Këto përfshijnë masat horizontale, të cilat mbulojnë faturimin informativ, fushatat e informimit, edukimin dhe trajnimin, promovimin e kontraktimit të performancës energjetike, auditimin energjetik dhe monitorimin e zbatimit (duke lejuar komentet e publikut mbi arritjet). Një fushatë specifike e informimit dhe edukimit propozohet për transportin, për të inkurajuar ndarjen modale dhe zgjedhjet me eficiencë të energjisë në transportin privat dhe publik.

Institucionet përgjegjëse: Organi drejtues për sigurimin e përhapjes së informacionit mbi masat për eficiencën e energjisë, politikave dhe mekanizmave, si edhe trajnimet përkatëse, është Agjencia për Eficiencën e Energjisë. Megjithatë, është gjithashtu i nevojshëm angazhimi i ministrive të tjera për çështje specifike sektoriale (p.sh. transporti dhe bujqësia), si edhe sigurimi i bashkëpunimit dhe aftësive të marketingut të kompanive private. Në mënyrë specifike, siç u përmend më sipër, bankat e nivelit të dytë kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në ofrimin e masave dhe marketingun e mundësive financiare për to. Në mënyrë të ngjashme, masat që mbështeten dhe zbatohen nga operatorit i

shpërndarjes dhe furnizuesit e energjisë do të kërkojnë që këto entitete të sigurojnë një marketing të përshtatshëm të mundësive tek konsumatorët.

8.2. MASAT E EE SIPAS SEKTOREVË

8.2.1. MASAT E EE NË SEKTORIN E NDËRTESAVE PUBLIKE

Stoku aktual i ndërtesave publike përbehet nga 80 ndërtesa me një sipërfaqe totale prej 92,481 m². Duke konsideruar një rritje specifike për çdo kategori është bërë e mundur të llogaritet stoku i ardhshëm për gjithë periudhën 2017-2030 të dhënë në figurën 50. Figura 51 bën të mundur parashikimin e stokut të ndërtesave publike i ndërtuar (dhe që parashikohet të ndërtohet në të ardhmen) me efikasitet bazuar në kriteret që po përgatiten në kuader të Ligjit të Performances Energjetike në Ndërtesa. Në këtë stok nuk do të parashikohet aplikimi i masave të EE. Figura 52 tregon parashikimin e stokut të ndërtesave publike që do të rehabilitohet me futjen e masave të EE.




Figura 50: Parashikimi i stokut të ndërtesave publike (m²)




Figura 51: Parashikimi i stokut të ndërtesave publike të ndërtuar (dhe që do të ndërtohet në të ardhmen) me efikasitet (m²)




Figura 52: Parashikimi i stokut të ndërtesave publike që do të rehabilitohet me futjen e masave të EE (m²)

Tabela 12 prezanton investimet e identifikuara për të përmirësuar efikasitetin e energjisë në sektorin e ndërtesave publike.

Tabela 12: Investimet për programin e EE në ndërtesat publike

Kod i	Kategoria e ndërtesave publike	Të dhënat në vitin bazë të ndërtesave publike	Masat specifike të EE që parashikohen implementohen	Kosto investimit Milion EURO
PB-01	Komunitet & Administrative	13 ndërtesa komunale administrative me sipërfaqe totale afërsisht 4,356 m ²	1. Masat e EE përfshijnë paketën bazë me këto masa për të gjitha kategoritë e ndërtesave publike.	1.404
PB-02	Shkolle fillore dhe mesme e ulët	42 ndërtesa Shkolle fillore dhe mesme e ulët	2. Termoizolimi i	7.020

		me sipërfaqe totale afërsisht 58,084 m ²	mureve	
PB-03	Bibliotekë	1 ndërtesa Bibliotekë me sipërfaqe totale afërsisht 1,556 m ²	3. Termoizollimi i catisë/kulimit	
PB-04	Shkollë e mesme	5 ndërtesa Shkollë e mesme me sipërfaqe totale afërsisht 8,692 m ²	4. Dritare Efiçente.	0.200
			5. Dyer të jashtme Efiçente	
PB-05	Cerdhe	4 ndërtesa Cerdhe me sipërfaqe totale afërsisht 2,162 m ²	6. Sistem qendror ngrohje me pelete	0.925
			7. Prodhimi i Ujit të Ndrohtë me Panele Diellore	
PB-06	Shëndetësi Familjare	25 ndërtesa komunale administrative me sipërfaqe totale afërsisht 7,916 m ²	8. Ndrëçimi i Brendshëm Efiçient LED	0.357
			9. Prodhimi i Energjisë Elektrike me Panele Diellore FotoVoltaike	
			Në raste vecanta, bazuar në kushtet konkrete në funksion të raportit të auditimit energjetik do të implementohet edhe ndonje masë tjetër sipas kushteve përkatëse.	
				1.309
	TOTAL	80 ndërtesa komunale me sipërfaqe totale afërsisht 95,762 m ²	Të gjitha masat e sipër përmendura	11.215

Masat shoqëruese jo-investuese në drejtim të rritjes së kapaciteteve manaxhuese të energjisë dhe për këtë sektor janë rekomanduar që të mundesojnë investimet si dhe monitorimin e rezultateve:

- Themelimi i Zyres Komunale për Energji sipas Udhëzimit Administrativ (UA) të lartpërmendur që do të këtë në fokus krahas fushave të tjera edhe EE në ndërtesa
- Kryerja e një analize krahasuese për konsumin e energjisë në ndërtesa për të gjithë ndërtesat publike bashkë me një program auditimi energjetik për të gjithë ndërtesat. Vlen të theksohet se nepërmjet këtij programi të GiZ është vendosur baza për këtë baza për vazhdimin e sistemit të të dhënave në lidhje me konsumin energjetik;
- Në mënyrë që të përgatiten projektet e investimit për masat e mëtejshëm sygjerohet:
 - o Studime fizibiliteti dhe dizanji i projekteve të investimit
 - o Specifikime teknike, tenderim dhe prokurim
 - o Mbikëqyrje e kualifikuar e ndërtimit bashkë me ngritjen profesionale dhe udhëzimin për instalimin e praktikave më të mira;
- Programi për monitorimin konsumit të energjisë;
- Programi për ngritjen profesionale për operatorët e stafit teknik të objekteve nën pronësi të komunës.
- Edukimi dhe trajnimi i ndryshimit të sjelljes së punëtorëve/përdoruesve të ndërtesave të cilat janë pronë të Komunës.
- Futja në përdorim të kriterëve të EE të prokurimit publik për pajisjet të cilat funksionojnë me energji në ndërtesat publike.
- Kërkesat minimale për konsumin specifik termike të ndërtesave të reja dhe atyre ekzistuese.
- Skema e certifikimit të ndërtesave.

Në tabelen 13 janë llogaritur të gjithë treguesit teknik dhe financiarë për çdo masë të EE dhe RES/BRE dhe analiza tregon në mënyrë të qartë se të gjitha investimet janë më me leveredhë financiare dhe implementimi i tyre sjelle kursim të burimeve energjive, reduktim të smogut dhe reduktim të gazeve me efekt sere.

Tabela 13: Analiza ekonomike paraprake për ndërtesat publike

Kodi	Masat e EE	Investimi total në Euro	IRR ne %	Periudha e vetëshlyerjes së investimit në vite	Niveli i reduktimit të konsumit të energjisë në GWh	Niveli i reduktimit të smogut dhe gazeve acide, tons	Niveli i reduktimit të gazeve të ngrohjes globale (CO2eqv), tons
Masa të domosdoshme të EE							
MEE1	Termoizolimi i mureve për të gjitha ndërtesat	1.032	14,97%	6.679	2.285	2.560	1.152
MEE2	Termoizolimi i catise/kulmit për të gjitha ndërtesat	0.413			1.166	1.306	0.588
MEE3	Dritare Efiçente për të gjitha ndërtesat	1.290			0.793	0.888	0.400
MEE4	Dyer të jashtme Efiçente për të gjitha ndërtesat	0.241			0.42	0.470	0.212
MEE5	Sistem qendror ngrohje me pelete për të gjitha ndërtesat	2.252	14,38%	6.955	2.998	3.358	1.511
MEE6	Prodhim i Ujit të Ngrorhtë me Panele Diellore për të gjitha ndërtesat	2.252	29,84%	3.351	1.499	1.679	0.756
MEE7	Ndriçimi i Brendshëm Efiçient LED për të gjitha ndërtesat	0.434	45,86%	2.180	1.191	1.334	0.600
	Totali EE	7.914	20,73%	4.824	10.352	11.595	5.219
Masa të RES – masa të mundshme							
MEE8	Diellore FotoVoltaike për të gjitha ndërtesat	3.301	16,84%	5.937	3.698	4.142	1.864
	Totali RES	3.301	16,84%	5.937	3.698	4.142	1.864
	TOTAL	11.215	19,58%	5.107	14.051	15.737	7.081

Një kombinim i masave të investimit të efiçencës së energjisë në këto ndërtesa mund të realizojë periudha vetëshlyerje në më pak se 7-8 vjet, e cila është më e vogël se jetëgjatësia e projektit ose jetëgjatësia e shtuar pas rehabilitimit të ndërtesës. Përveç përfitimeve ekonomike në kursimin e kostove të energjisë, komforti i ambienteve të brendshme për fëmijet, studentët, administratën dhe mësuesit do të rritet në mënyrë të konsiderueshme. Përderisa kapacitetet financiare janë shumë të limituara për të filluar të gjitha masat

njëkohësisht, rekomandohet të aplikohet një periudhë zbatimi afat-shkurter dhe afat-mesme në dy faza, sipas profitabilitetit.

Zbatimi i një plani të EE për Komunën e Gjakovës do të gjenerojë një kursim energjie deri në 14 GWh/vit në vitin e synuar 2030, vlerë e cila është ekuivalente me 42% të konsumit të energjisë në 2 sektorët përkatës të Komunës, krahasuar me konsumin e energjisë në vitin bazë 2030 (ndricimi i rrugëve dhe ndërtesat publike). Kursimi vjetor kumulativ për ndërtesat publike është dhënë në figurën 53 dhe investimet janë dhënë në figurën 54.




Figura 53: Kontribimi në potencialin e përgjithshëm të kursimit të energjisë për ndërtesat publike (GWh/vit)

Investimet vjetore kumulative për ndërtesat publike janë dhënë në figurën 54.




Figura 54: Investimet e nevojshme për realizimin e masave të EE për ndërtesat publike (Euro/vit)

8.2.2. NDRICIMI PUBLIK I RRUGËVE

Rehabilitimi i ndricimit të rrugëve me teknologji LED në vend të llambave me presion të lartë prej mërkuri/zhivë ose prej natriumi mund të rrisë ndjeshëm efikasitetin e energjisë në ndricimin e rrugëve, të ulë kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes si dhe të realizojë kursime të rëndësishme në koston e mirëmbajtjes së 50% dhe në varësi të shkallës deri në 75% në vit përgjatë jetegjatesisë së teknologjisë.

Përfitimet specifike të LED-eve për ndricimin e rrugëve përfshijnë reduktimin e emetimeve të gazeve me efekt sërë, përmirsimin e shikueshmërisë gjatë natës, pasqyrim më të mirë të ngjyrave, përdorim më të zvogëluar të llambave me mërkur/zhivë dhe ndricim me shpërndarje me uniform i cili mund të eliminojë zonat e pa ndricuara ndërmjet shtyllave. Teknologjitë LED zakonisht kanë një jetëgjatësi të gjatë e cila varion nga 50,000 deri në 100,000 ore, pra afërsisht 25 vjet. Gjatë kryerjes së një rehabilitimi për ndricimin e rrugëve, ekziston një numër i caktuar faktorësh dizanji të cilët duhet të merren në konsideratë bazuar në koston dhe disponueshmërinë e paisjeve. Këto faktorë dizanji përfshijnë llojin e paisjeve dhe fuqinë e llambave të zgjedhura. Tabela 14 prezanton investimet e identifikuar për të përmirësuar efikasitetin e energjisë të ndricimit të rrugëve.

Tabela 14: Programi i investimeve në efikasitetin e energjisë për ndricimin e rrugëve

Kod i	Kategoria e ndricimit rrugor	Të dhënat në vitin bazë të ndricimit rrugor	Masat specifike të EE që parashikohen të implementohen	Kosto investimit
NRr-01	Zv. i Llamba Zhivë me Llamba LED	Llamba Zhivë do të zëvendësohen me Llamba LED	1. Masat e EE përfshin paketën bazë me këto masa për ndricimin rrugor.	0.320 Milion EURO
NRr-02	Zv. i Llamba kompakte fluoreshente (CFL) me Llamba LED	Llamba kompakte fluoreshente (CFL) do të zëvendësohen me Llamba LED	2. Zv. i Llamba Zhivë me Llamba LED 3. Zv. i Llamba kompakte fluoreshente (CFL) me Llamba LED	1.014 Milion EURO
NRr-03	Zv. i Llamba Natriumi me Llamba LED	Llamba Natriumi do të zëvendësohen me Llamba LED	4. Zv. i Llamba Natriumi me Llamba LED	0.096 Milion EURO
NRr-04	Zv. i HID llamba halide (halogjene) me Llamba LED	Llamba halide (halogjene) do të zëvendësohen me Llamba LED	5. Zv. i HID llamba halide (halogjene) me Llamba LED	0.0 Milion EURO
	TOTAL	Llamba jo-eficente do të zëvendësohen me Llamba LED	Në raste vecanta, bazuar në kushtet konkrete në funksion të raportit të auditimit energjetik do të implementohet edhe ndonjë masë tjetër sipas kushteve pëkatëse. Të gjitha masat e sipër përmendura	1.431 Milion EURO

Kjo paketë parashikon një zëvendësim të pjesshëm të shtyllave të ndricimit (rreth 20% e të gjithë pikave të ndricimit) si dhe demontimin ekologjikisht të arsyeshëm të HPM, CFL dhe HPS. Megjithatë, duhet të përfshihen kontrollet automatike kohore dhe ndricimi gjatë natës. Modernizimi i sistemit publik aktual të ndricimit kërkon informacion për teknologjitë aktuale të instaluar dhe kushti i sistemit për të lejuar zhvillimin e duhur të projektit. Në mënyrë që të sigurohet inventari i duhur për monitorimin dhe mirëmbajtjen e ardhshme, sygjerohet që të krijohet një databazë me të dhënat e mëposhtme:

- Rrugët/rrugicat: emri, gjerësia e rrugës (korsi për trafikun, këmbësoret, bicikletat), kategoria e rrugës (rruga kryesore, grada 1 ose 2, Rruga lokale e qytetit, etj.)
- Shtyllat e Ndricimit: Gjatesia, distance, montimi i (poleve/mureve), kllapave, siuate;

- Ndriculesit/llambat: lloji (teknik/historik/dekorativ), teknologjia dhe kapaciteti i llambave,
- Operimi: Kontrolli i operimit (manual, ore astronomike, qeliza foto-voltaike) orët e operimit, kushtet e kabineteve dhe kablove, lloji i furnizimit (linja publike, linje e vecantë e dedikuar vetëm për ndriçimin e rrugës);

Masat shoqëruese jo-investuese për këtë sektor janë rekomanduar për të mundësuar investimet si dhe për të mbështetur monitorimin e rezultateve:

- Vlerësim i integruar i të gjithë komunën në lidhje me vlerësimin publik përfshirë dhe auditimet energjitike;
- Analiza krahasuese për konsumin e energjisë në lidhje me energjinë elektrike për ndricim;
- Guida e prokurimit për instalimet e reja në lidhje me ndricimin e rrugëve;
- Për projektet e Investimit:
 - o Studimet e fizibilitetit dhe dizanji i projektit të investimeve;
 - o Specifikime teknike, tenderimi dhe prokurimi;
 - o Mbikëqyrje e kualifikuar ndërtimi bashke me kapacitetin e ndërtesës e udhëzime në lidhje me praktikën më të mirë të instalimit;
- Programi për monitorimin e konsumit të energjisë;
- Programi për aftësimin teknik për operatorët teknik të faciliteteve.

Masa të tjera të investimit të cilat kontribuojnë në zhvillimin urban dhe turistik por që nuk kanë (ose kanë shumë pak) përfitime EE:

- Zgjerimin e ndriçimit të rrugëve;
- Zgjerimin e ndriçimit të trotuareve, shëtitores, parqeve, shkallëve;

Në tabelën 15 është dhënë analiza paraprake financiare për ndriçimin e rrugëve.

Tabela 15: Analize paraprake ekonomike për ndriçimin e rrugëve

Kodi	Kategoria e ndriçimit rrugor	Investimi total në Euro	IRR në %	Periudha e vetëshlyerjes së investimit në vite	Niveli i reduktimit të konsumit të energjisë në GWh	Niveli i reduktimit të smokut dhe gazeve acide, tons	Niveli i reduktimit të gazeve të ngrohjes globale (CO ₂ eqv), tons
NRr-01	Zv. i Llamba Zhivë me Llamba LED	0.320	27.20%	3.677	0.230	0.11619	0.25796
NRr-02	Zv. i Llamba kompakte fluoreshente (CFL) me Llamba LED (opsioni me arritje në nivelin të komfortit të ndriçimit)	1.014	44.12%	2.1253	0.0705	0.03556	0.07895
NRr-02	Zv. i Llamba kompakte fluoreshente (CFL) me Llamba LED (opsioni real me LED por pa arritje të komfortit)	0.912	15.22%	6.97	0.0243	0.01293	0.02955
NRr-03	Zv. i Llamba Natriumi me Llamba LED	0.096	48.44%	2.064	0.3107	0.015677	0.34802
NRr-04	Zv. i HID llamba halide (halogjenë) me Llamba LED	0.000	0.00%	0	0	0.00	0.00

TOTAL	1.431	15.22%	6.569	0.612	0.30851	0.68491
-------	-------	--------	-------	-------	---------	---------

Analiza e mësipërme tregon në mënyrë të qartë që investimet në përmirësimin e efikasitetit të energjisë për ndriçimin rrugor, nëpërmjet instalimit të LED, është me leverdi financiare, sjell reduktim të smogut, reduktim të ngrohjes globale dhe përmirësim të Komunës dhe do të sjelli shumë më tepër turistë dhe zhvillim ekonomik. Figura 55 paraqet kontributin në potencialin e përgjithshëm të kursimit të energjisë për ndriçimin rrugor me llamba LED. Figura 56 paraqet investimet e nevojshme për realizimin e masave të EE për ndriçimin rrugor me llamba LED (Euro/vit).




Figura 55: Kontributi në potencialin e përgjithshëm të kursimit të energjisë për ndriçimin rrugor me llamba LED (GWh/vit)




Figura 56: Investimet e nevojshme për realizimin e masave të EE për ndriçimin rrugor me llamba LED (Euro/vit)

8.2.3. NDËRRMARRJET PUBLIKE

8.2.3.1. ndërmarrjet publike të furnizimit me ujë dhe të ujrave të zeza

Disa nga aktivitetet shumë të rëndësishme që duhet të vazhdohet të ndiqen për rritjen e cilësisë së furnizimit, rritjen e arketimeve, uljen e kostove në përgjithësi dhe kostos energjetike në vecanti për Ujësjetelësin Rajonal të Gjakovës janë dhënë në vijim:

- Krijimi në vazhdimësi i kushteve më të volitshme të infrastrukturës ujore dhe të kanalizimit për konsumatorët tonë.
- Përmirësimi i Raporteve afariste me ARRU-se, MMPH, etj. Zgjidhja e çështjes financiare të obligimeve financiare të rregullta mujore ndaj tyre.
- Arkëtimi i borxheve të vjetra sipas Salldo 31.12.2016, sipas Ligjit në mënyrë të detyruar.
- Realizimin e Marrëveshjeve për borxhet e pa paguara, me konsumatorët borxhli për riProgramim të borxheve ndaj KRU-së.
- Rritja e shkallës së Leximin-Faturimin në masën +1.38 % në vitin 2017 dhe të inkasimitarkëtimin të Faturave të vitit 2017 në minimum +1.48 % të tyre nga konsumatorët dhe një pjesë të Borxheve të pa paguara nga konsumatorët sipas Salldos 31.12.2016.
- Paisja me ujëmatës e të gjithë kategorive të konsumatorëve.
- Lidhja e Marrëveshjeve të shërbimeve me konsumatorët.
- Përmirësimi i menaxhimit të sistemit të furnizimit me ujë, mbajtja nën kontroll e nivelit të prodhimit i cili nga ana tjetër është i lidhur me koston e prodhimit, në veçanti shpenzimet e energjisë elektrike të cilat shpenzime janë të lidhura direkt me nivelin e prodhimit, ulja e nivelit të prodhimit ndikon edhe në uljen e kostos së këtyre shpenzimeve.
- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit të pijes.
- Angazhimi maksimal i Sektorit të Planifikimit e Zhvillimit në hartimin e Projekteve Investive kapitale, për aplikimin tek aksionari Qeveria e Kosovës, Donatorët, Bankat, etj.
- Realizimi i Projektit Ndërtimi i Impiantit të Ujrave të Zeza
- Zhvillimi i raporteve të vazhdueshme me KK-Gjakovë, Rahovec dhe Prizren.
- Përgatitja e raportit për raportim MZHE për projekteve kapitale për vitin 2019-2020;
- Grumbullimi i të dhënave dhe ndarja në zona furnizuese;
- Pjesëmarrje në komisionin për pranimin teknik në projektin me titull "Rehabilitimi i gropave, ndërtimi dhe pastrimi i pusëve";
- Inspektimi dhe përgatitja e detajit të pusëve të kanalizimit në Impiantin e ujërave të zeza në disa zona problematike;
- Inspektimi dhe dhënia e instruksioneve për ndërtimin e pusëve të kanalizimit (pusëta seperues);
- Analizimi i projektit të komunës për ndërtim të kanalizimit dhe përgatitja e paramasës dhe detaleve për ndërtimin e gypave në rrugët që do të ndërtohen komuna;
- Shërbimin e hulumtimit të keqpërdorimeve-zvogëlimi të humbjeve të ujit;
- Identifikimi i dhe eliminimi i lidhjeve ilegale;
- Identifikimi dhe ndëshkimi i lidhjeve përpara ujëmatësit;
- Identifikimi i konsumatorëve që bëjnë korrupsionin e matësve të ujit.

8.2.3.2. Mbledhja e mbetjeve urbane

Disa nga aktivitetet shumë të rëndësishme për rritjen e efektivitetit të mbledhjes së mbetjeve të ngurta urbane në Komunën e Gjakovës janë dhënë në vijim:

Mbledhja dhe transferimi i mbeturinave

- Më pak se 60% e popullsisë merr shërbim të rregullt nga një operator ligjor;

- Më shumë se 50% e popullsisë jeton në zonën rurale dhe vetëm rreth 40% e mbeturinave që ata gjenerojnë grumbullohen dhe shkarkohen siç duhet në deponi;
- Ekzistojnë sfida, financiare dhe operacionale, në ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave në fshatra të largëta;
- Shkalla e arkëtimit mbetet e ulët (~ 60%) dhe pengon qëndrueshmërinë financiare të shtetit të grumbullimit të mbeturinave.

Ndarja në burim dhe riciklimi

- 62,461t onë mbetje të riciklueshme (15% e sasisë totale të mbeturinave të grumbulluara) grumbullohen nga kompanitë e përpunimit të mbeturinave në Kosovë; Ndërsa në Gjakovë grumbullohen rreth 22% e mbetjeve të gjeneruara.
- Nga sasia totale e mbeturinave të grumbulluara në vend (~420,000 tonë) vetëm 2.7% të mbeturinave janë përpunuar dhe pastaj janë eksportuar për industrinë e riciklimit në vende të tjera; Ndërsa në Gjakovë përpunohen rreth 5.8% e mbetjeve të gjeneruara.

Fraksionet e veçanta të mbeturinave

- Mbeturinat organike paraqesin fraksionin më të madh, por ka vetëm një numër të vogël të përpjekjeve të bëra në riciklimin e tyre; Mënyra më e mirë për të bërë riciklim të tyre është të bëhet pleh organik dhe kjo sigurisht do të kërkonte një ndarje paraprake të tyre.
- Vetëdija mjedisore
- Më shumë se 1500 deponi të paligjshme janë identifikuar në vend. Hedhja ilegale e mbeturinave mbetet problem dhe eliminimi i qëndrueshëm i tyre është ende sfidues; Ndërsa në Gjakovë numri i tyre është më i ulët në krahasim me mesataren e Kosovës.

Bërja e politikave dhe planifikimi

- Korniza legjislative për menaxhimin e mbeturinave mbulon të gjitha fraksionet e mbeturinave, por ende nuk ka implementim të plotë në nivel komunal;

Dokumentet nacionale dhe komunale të planifikimit nuk janë të harmonizuara;

- Një pjesë e planeve komunale për menaxhimin e mbeturinave nuk kanë plan të qartë financiar dhe tjera mvaren nga fondet e Qeverisë apo donatorëve për implementim të aktiviteteve prioritare sipas planit.

Monitorimi dhe raportimi

- Raportimi për aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave realizohet vetëm pjesërisht nga operatorët e licencuar dhe zotëruesit e mbeturinave;
- Pjesa dërmuese e komunave nuk raportojnë në AKMM në baza vjetore siç kërkohet me ligj;
- Ka mungesë të raportimit të standardizuar nga të gjithë aktorët në sektorë.

Sistemi i të dhënave

- Ka mungesë të të dhënave të besueshme dhe të verifikuara për menaxhimin e mbeturinave komunale;
- Baza e të dhënave kombëtare për menaxhimin e mbeturinave ende nuk ofron të dhëna gjithëpërfshirëse Kombëtare të sektorit;
- Mungesa e të dhënave të besueshme dhe gjithëpërfshirëse kombëtare pengon hartimin efektiv të politikave dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

Planet e investimeve në infrastrukturë

1. Qendrat e deponimit të mbeturinave Nuk ka investime të planifikuara në PRKMM apo PKMM që kanë të bëjnë me deponimin e mbeturinave.

2. Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave

Sipas PKMM-ve ekzistuese komunale të Gjakovës dhe Junikut (Deçani nuk ka PKMM), shpenzimet e planifikuara për këtë kategori janë 1.27 mil. €, nga të cilat pjesa më e madhe është planifikuar për kontejnerë për mbeturina të ricikluara (0.85 mil €) në Komunën e Gjakovës.

3. Qendrat e ndarjes dhe trajtimit të mbeturinave

Në PRKMM është planifikuar një qendër për trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit në Gjakovë me një vlerë të përafërt prej 750,000 €. Sipas PKMM-së, një qendër e mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit është planifikuar në Junik në vlerë prej 27,500 €.

Vlera totale e investimeve të planifikuara për këtë rajon në PRKMM është 750,000 €, ndërsa sipas PKMM-së është afërsisht 1.3 mil€.

Të gjitha vlerat e mësipërme janë përmbledhur në tabelën 16.

Tabela 16: Planet e investimeve në infrastrukturën e manaxhimit të mbetjeve urbane

Planet e investimeve në infrastrukturë	PRKMM	PKMM-të
1. Qendrat e deponimit të mbeturinave		
2. Pajisjet mbledhjes, transportimit dhe trajtimit të mbeturinave		
2.1 Kontejnerët		1,046,450
2.2 Kamionët		225,000
Totali 2:		1,271,450
3. Qendrat e ndarjes dhe trajtimit të mbeturinave		
3.1 Qendra e trajtimit të mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit në Gjakovë	750,000	
3.2 Qendra e grumbullimit të mbeturinave komunale në Gjakovë		27,500
Totali 3:	750,000	27,500
Totali (1+2+3):	750,000	1,298,950

Ekziston nevoja për reduktimin e volumit të mbetjeve dhe kategorizimin e tyre si dhe zëvendësimi i kamioneve të vjetër që kanë kosto të lartë karburanti dhe mirëmbajtjeje. Për më tepër, rritja e ndergjegjesimit mjedisor mund të çojë në zvogëlimin e deponimeve ilegale dhe të rrisë normën e mbledhjes së mbetjeve tëngurta në Komunën e Gjakovës.

8.2.4. SEKTORI I SHËRBIMEVE PRIVATE

Kapacitetet e shërbimeve në Komunën e Gjakovës sot ka rreth 1794 biznese aktive, nga të cilët 1731 biznese private, shumica në tregti dhe shërbime, 48 shoqëri aksionare, 9 ndërmarrje shoqërore dhe 6 ndërmarrje publike. Rreth 60 000 m² objekte sot janë të zbrazëta. Të gjitha potencialet industriale për agrikulturë dhe shërbyese mund të riaktivizohen dhe së bashku me projektet dhe iniciativat ndërmarrëse tjera përbëjnë një potencial interesant dhe atraktiv për investime të jashtme, nga diaspora etj.

Gjakova ka të punësuar afërsisht 13,000 veta, nga të cilët 7200 veta në biznese private, 3200 në SHA, 1760 në ndërmarrje publike dhe 135 veta janë të punësuar në banka. Rreth 60% e të punësuarve janë në sektorin e veprimtarive ekonomike. Shoqëritë Aksionare gjegjësisht Ndërmarrjet Shoqërore përbëjnë një potencial ekonomik të konsiderueshëm për Komunën e Gjakovës. Rimëkëmbja e tyre do të jetë bazë e mirë si nga aspekti i punësimit ashtu edhe i zhvillimit ekonomik. Sot janë të regjistruara 48 Shoqëri Aksionare dhe 9 Ndërmarrje Shoqërore. Gjerë me tani aktive kanë qenë "IMN", kohë pas kohe "JATEX" dhe Dukagjini, ndërsa ndërmarrjet tjera nuk janë aktive. Disa nga SHA, që nuk janë në funksion, nuk kanë arritur të ruajnë funksionalitetin e objekteve dhe pajisjeve, çka ka sjellë humbje të resurseve ekonomike të investuara me vite. Rastet më të rënda janë në SHA "Emin Duraku", Metaliku dhe më pak në SHA "Ereniku". Pajisjet dhe objektet janë ruajtur mirë në ShA "Elektromotori", "IMN", "Dukagjini" dhe "Jatex". Këtu ka ndikuar edhe vonesa e procesit të privatizimit. Gjerë më tani janë privatizuar "Kompresori", Hoteli "Pashtrik", "Modeli", "IMN", Mulliri dhe fabrika e bukës, Stacioni Bujqësor, "Elast" dhe thertorja "Agimi". Prej tyre janë në funksionim "IMN" dhe "Modeli" pjesërisht me

program tjetër prodhimi; fabrika e miellit dhe e bukës do të filloje së shpejti veprimtarinë prodhuese ndërsa Hoteli "Pashtrik" tashmë ka filluar pjesërisht punën. Tash së voni të drejtën për t'u regjistruar si biznes e kanë fituar edhe SHA "Elektromotori", "Jatex", "Dukagjini" dhe "Ereniku". Ky është një sinjal mjaft pozitiv për ekonominë e Komunës së Gjakovës. Në fakt ky është një sinjal mjaft inkurajues edhe për mundësinë e tërheqjes së investitorëve për programet e zhvillimit dhe krijon mundësinë e zhvillimit të marrëdhënieve ko-operuese me bizneset e vogla.

Rezultate të dukshme janë arritur në sektorin e ndërtimit, ku krahas ndërtimit të ndërtesave dhe ngritjes së infrastrukturës, po zhvillohen me shpejtësi burimet njerëzore për të gjitha profilet. Megjithatë, vihet re një rënie e intensitetit të punës në këtë sektor në krahasim me vitet e pasluftës, kur filloi faza e rikonstruktimit, dhe shumë prej burimeve njerëzore të këtij sektori kanë filluar të punojnë edhe në vende të tjera jashtë Kosovës.

Duke analizuar zhvillimet e sektorit të shërbimeve dhe konsumin energjetik, që lidhet me këto zhvillime për sektorin e shërbimeve private në Komunën e Gjakovës (dyqane, restorante, supermarkete, hotele, shkolla dhe spitale private, salla sportive private, qendra rekreacioni private), i cili do të garantojë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit, duke reduktuar kërkesën për energji dhe lëndë djegëse. Vëmendje kryesore duhet ti kushtohet reduktimit të kërkesës për energji elektrike dhe lëndë djegëse të lehtëta. Ndryshime duhet të ndodhin në reduktimin e intensiteteve energjitike dhe strukturën e furnizimit me burime energjitike, për secilin shërbim. Parashikohet që të merren masa të ndryshme si psh. rritja e cmimit të energjisë elektrike, zbatimi i kodit energjetik në ndërtesa, aplikim të lehtësirave fiskale për burimet e rinovueshme të energjisë dhe për burimet më efikente, fushata sensibilizuese etj. Njëpëmjet këtyre masave synohet të arrihet:

- Penetrimi i Ngrohjes së Përqendruar nga impianti qëpo rehabilitohet/zgjerohet i Ngrohtores së Gjakovës për ngrohje,
- Rritja e efikasitetit nëpëmjet ndërhyrjeve, psh. shtimi i ndricimit fluoreshent, përdorimi i teknikes elektronike inteligjente, përdorimi i pajisjeve elektrike moderne me $\cos\Phi$ të përmirësuar në pompat, frigoriferet etj. në konsumatorëte ndryshëm të sektorit të shërbimeve.
- Përmirësimi i termoizolimit në stokun e godinave ekzistuese, dhe zbatimi rigoroz i Kodit Energjetik në Ndërtesa për godinat e reja në sektorin e shërbimeve,
- Zgjerimi i përdorimit të paneleve diellore, për përgatitjen e ujit të ngrhtë nëgodinat tregtare,
- Zgjerimi i përdorimit të paneleve diellore fotovoltaike si autoprodhues nëtarracat e ndërtesave të sektorit të shërbimeve private,
- Penetrimi i GNL-së dhe Gazit Natyror (kur të lidhet Kosova me rrjetin e GN) për ngrohje dhe gatim,
- Futja gradualisht e impianteve moderne koogjeneruese të vegjël SSCHP¹ (impianti që po rehabilitohet/zgjerohet i Ngrohtores së Gjakovës) dhe e ngrohjes qendrore, duke filluar nga konsumatorët më të mëdhenj në më të vegjëlit, sidomos në zëvendësim tësistemeve ekzistuese konvencionale.

8.2.5. SEKTORI I INDUSTRISE

Pas luftës së Dytë Botërore, një qendër e re e qytetit është ndërtuar në bregun lindor të lumit Krena. Janë ndërtuar shkolla, parqe dhe një spital. Qyteti gjithashtu zhvillohej në një qendër industriale. Degët më të rëndësishme ishin: industria e përpunimit të metalit, tekstilit, materialit ndërtimorë, përpunimit të drurit si dhe industria e përpunimit të produkteve bujqësore. Gjatë konfliktit të viteve të 1990-ta, industria pothuaj se paralizohet

¹ Shkurtimi i SSCHP – Small Scale Combined Heat and Power (Impiante të Vegjël të Prodimit të Kombinuar të Energjisë Elektrike dhe termike)

plotësisht. Gjatë luftës në vitin 1999 Gjakova ishte një nga qytetet më të dëmtuar të Kosovës.

Disa nga përparësitë e mundëshme industriale të Komunës së Gjakovës janë:

- struktura ekzistuese industriale
- kushtet e mira për bujqësi dhe traditë e kultivimit të verës
- mjedis i pastër dhe peizazh atraktiv
- afërsia me Shqipërinë dhe integrim rajonal

Disa nga dobësitë e sektorit industrial të Komunës së Gjakovës janë:

- Shumë funksione qendrore dhe zhvillimi ekonomik janë koncentruar në komunën;
- Linja hekurudhore në rrafshin e Dukagjinit nuk kalon nëpër Gjakovë
- standardi i rrjetit të rrugëve është i ulët

Disa nga mundësitë e sektorit industrial të Komunës së Gjakovës janë:

- Komuna mund të zhvillohet në një qendër bujqësore në një nga qendrat kryesore të Kosovës për vreshtari dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve,
- Afërsia me Shqipërinë si dhe linja e drejtpërdrejt me portin e Shëngjinit janë parakushte të mira për lulëzimin e tregtisë
- Aeroporti i vogël ushtarak mund të zhvillohet në një aeroport rajonal,
- Natyra e pashfrytëzuar mund të kthehet në një bazë për turizëm

Disa nga rrisqet e sektorit industrial të Komunës së Gjakovës janë:

- Infrastruktura e dobët dhe lidhja e dobët me të gjitha arteriet kryesore të transportit, mund të parandalojnë investimet.
- Mungesa e kooperimit ndërmjet qyteteve të Dukagjinit mund ta dobësojë rajonin.

Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të industrisë në Komunën e Gjakovës kërkon detyrimisht, plotësimin e nevojave energjitike për secilin nënsektor industrial (në sasi, cilësi, cmim, vazhdueshmëri dhe kohë), pasi ato luajnë rol të madh në rritjen ekonomike, zënieën me punë, standartin e jetesës etj. Për pasojë, përsa i përket zhvillimit të qëndrueshëm industrial në Komunën e Gjakovës, si objektiva bazë janë vendosur:

- Rritja e efektivitetit ekonomik të industrisë, që do të ndikohet ndjeshëm nga ulja e peshës së kostos energjitike në produktet industriale, gjithashtu edhe nga reduktimi i nevojave për energji.
- Pakësimi i ndotjes së mjedisit nga emetimet e gazeve tëndryshme (si atyre që shkaktojnë ngrohjen globale të atmosferës ashtu edhe të atyre që shkaktojnë shiun acid) me origjinë energjitime (në tokë, ujë dhe atmosferë), që është një faktor, i cili varet direkt nga shkalla e reduktimit të nevojave për energji.
 - Reduktimi i nevojave energjitike për sektorin e industrisë, pa ndryshuar treguesit e zhvillimit ekonomik-shoqëror dhe njëkohësisht duke rritur punësimin dhe duke i bërë produktet industriale me një kosto më të vogël. Kjo kërkon marrjen në konsideratë të një tërësi masash në drejtim të përdorimit me efikasitet më të lartë të energjisë së sektorin e industrisë në Komunën e Gjakovës. Rekomandimet me kryesore, që do të bëjnë të mundur zvogëlimin e nevojave energjitike janë:
 - Përmirësimi i organizimit dhe menaxhimit në industri;
 - Mirëmbajtja dhe modernizimi i teknikës dhe teknologjisë së përdorur në sektorin e industrisë;
 - Rritja e shkallës së përpunimit të lendeve të para, cilësive dhe vlerës së produkteve industriale;
 - Shtimi i rendimentit, rikuperimit, shkallës së përdorimit të mbetjeve teknologjike, herësit të qarkullimit të ujit, reagentëve etj.
 - Futja e koncepteve: "teknologji më të pastra"; "simbioza e disa industrive" etj..

Bazuar në analizën shumë vjeçare të sektorit të industrisë disa nënsektoret industriale, aktualisht kemi një menaxhim jo efektiv të burimeve energjitike, që rezultojnë në fund të fundit me vlera shumë të rritura të intensiteteve energjitike në degë të ndryshme të industrisë në Komunën e Gjakovës, në krahasim me të njëjtat industri në vendet europiane. Bazuar në

eksperiencën boterore dhe nëauditimet energjitike të realizuara në kuadrin e projektit të KOSEP/EBRD (2013-2018) ne dege te ndryshme te industrise, është arritur në përfundim se vetëm nëpërmjet njëmenaxhimi më të mirë, (pa ndërhyrje me investime, por vetëm nëpërmjet një "nikoqirllëku" më të mirë) mund të arrihen reduktime të ndjeshme të konsumit të energjisë.

Eksperienca botërore dhe analiza e auditimeve, tregoi se mund të kemi reduktim të intensiteteve energjitike vetëm nëpërmjet "nikoqirllëkut" më të mirë në nivele 10-20%. Menaxhimi me i mire i energjisë, ne pergjithesi i referohet situates kur i gjithë personeli brenda një ndërmarrje është vazhdimisht i ndërgjegjshëm, në lidhje me kostot e energjisë dhe adapton masa (ndërhyrje) të thjeshta për të bërë reduktimin e saj. Shembull i një "nikoqirllëku" të mirë mund të jenë veprime fare të thjeshta si: fikja e dritave, fikja e pajisjeve sa herë që ato nuk përdoren, mbyllja e dritareve gjatë sezonit të ngrohjes, moslejimi i rrjedhjes konstante të avujve, ajrit të komprimuar, ujit, nënprodukteve të naftës, qymyrit, etj. Disa nga masat që duhen marrë në këtë drejtim janë:

- Vendosja e sanksioneve kundrejt konsumatoreve, që kanë cosq jashtë kufijve të lejuar (poshte vleres 0.9) është rekomanduar edhe nga Studimi i Sistemit te Tarifave të Energjisë Elektrike, (realizuar në vitin 1996 nga London Economic). Për rastet kur ndërmarrja paguan tarife fuqie per maksimumin e fuqisë së plotë të kërkuar, eksperienca e vendeve të zhvilluara tregon se kjo tarife rritet me 5% për cdo ulje prej 1% te cosq nga vlera 0.9.
- Për rastet kur ndërmarrja paguan tarife për energjinë elektrike të konsumuar, sipas nje cmimi të miratuar, eksperienca e vendeve te ndryshme tregon se kjo tarife rritet me 3% per cdo ulje prej 1% të cosq nga vlera 0.9. Gjithashtu, kontrolli i zbatimit të normës shtetërore për nivelin e cosq, duhet të risanksionohet në legjislacion, duke ia ngarkuar këtë detyrë një inspektoriat të vecantë.

Futja e skemave koogjeneruese në industri

Shumë nënsektorë industrial në Komunën e Gjakovës, për nevojat e tyre teknologjike, kanë nevoja energjitike në formën e nxehtësisë (në formën e avullit apo ujit tëngrohtë) dhe në formën e energjisë elektrike. Mbështetur në teknologjitë që ekzistojnë sot në botë, teknologjia më efiçente, e cila bën të mundur garantimin e nevojave elektrike dhe termike është ajo koogjeneruese, dmth që realizon prodhimin e kombinuar të energjisë termike dhe elektrike. Duke përdorur në sistemet koogjeneruese moderne CHP, të njëjtën sasi lëndë djegëse të gaztë/lënget, që konsumojmë në kaldajat tradicionale, mund të sigurohet nxehtësia e nevojshme që kërkohet nga konsumatorët, duke përfituar njëkohesisht energji elektrike shtesë në vlera sa 1/3 e energjisë së lëndës djegëse. Kjo shpjegohet thjesht me faktin e përmirësimit të rendimentit (rreth 2 here) në keto sisteme ndaj sistemeve tradicionale me kaldaja industriale. Gjithashtu, i ndjeshëm është zvogëimi i impaktit mjedisor, pasi përdoret më pak lëndë djegëse, qësi rregull është me cilësi më të mirë, por edhe më e shtrenjtë. Por, futja e impianteve koogjeneruese kërkon:

Se pari, konsumatorë relativisht mesatarë dhe të mëdhenj, të cilët kanë kërkesa të njëkoheshme për energji elektrike dhe termike.

Se dyti, konsumatorët duhet të kenë kërkesë të vazhduar, sidomos për energji termike për më shumë se 6000 orë në vit.

Se treti, duhet që të ekzistojnë që cdo tepicë e energjisë elektrike, që prodhohet nga impianti CHP, të blihet nga rrjeti i kompanisë shpërndarese elektrike me cmimin e përcaktuar nga ERE.

Se katerti, impiantet CHP kërkojnë investime të mëdha, që mund të sigurohen jo vetëm me plotësimin e parakushtit të përdorimit të domosdoshëm dhe të vazhdueshëm të të gjithë nxehtësisë dhe të energjisë elektrike, por gjithashtu duhet që analizat tekniko-ekonomike, në cdo fazë të projekteve, të rezultojnë me efektivitet ekonomik të padiskutueshëm, për të gjitha palët e interesuara (financues, sipërmarrës, konsumatorë).

8.2.6. SEKTORI I BUJQESISË

Me rreth 14741 ha tokë të punueshme (shih Tab. 15), Komuna e Gjakovës ka kushte shumë të volitshme për të zhvilluar një bujqësi intensive: Aktualisht struktura e prodhimit bujqësor dominohet nga kultura e misrit dhe e grurit, që së bashku zënë rreth 57% të sipërfaqes së tokës së punueshme. Ajo që vihet re është zhvillimi i pakët i kulturave intensive dhe industriale dhe vonesa në kultivimin e kulturave shumëvjeçare.

Nisur nga tradita, struktura ekzistuese e prodhimit dhe perspektiva e zhvillimit ekonomik të Komunës së Gjakovës, në kuadrin e strategjisë së zhvillimit bujqësor për të nxitur investimet e suksesshme, kanë përparësi fushat e mëposhtme:

- Pemëtaria
- Kultivimi i rrushit
- Lavërtaria
- Kultivimi i duhanit

Këto zhvillime strategjike të prodhimit bujqësor kërkojnë, gjithashtu, rritjen e sipërfaqes së ujitur. Aktualisht në territorin e Komunës së Gjakovës ujitën rreth 10920 ha, nga të cilat rreth 2850 ha me sistemet e vjetra, ndërsa pjesa tjetër nga HS "Radoniqi". Në një periudhë afatmesme do të duhet që, krahas përmirësimit të sistemeve ekzistuese të ujitjes, të zgjerohet deri në dyfishim sipërfaqja e ujitur, veçanërisht duke shfrytëzuar mundësitë potenciale ujtëse nga liqeni HS "Radoniqi".

Rritja e kapaciteteve blegtorale të paraluftës është një synim me prioritet e plotësisht i mundshëm për tu realizuar. Në territorin e Komunës së Gjakovës, në sektorin individual, janë aktualisht 75 ferma të pulave vojse me kapacitet prej 206.810 pula, ndërkohe që shfrytëzohet pak më shumë se gjysma e kapacitetit të tyre. Janë, gjithashtu, 15 ferma të bojlerëve (rritja e zogjve) me kapacitet 140.800 bojlerë në turne si dhe 4 mulli për prodhimin e koncentratit me kapacitet 18.000 ton/vit.

Me objektivin për të reduktuar konsumin e energjisë, në sektorin e bujqësisë, në Komunën e Gjakovës, duhet të promovohen dhe të merren parasysh këto masa të EE/RES nga ana e fermereve të kësaj komune:

- Futja e mekanikës bujqësore eficiente në drejtim të konsumit të karburanteve;
- Së pari, për sektorin e bujqësisë duhet të arrijmë një reduktim prej 10% i intensiteteve energjitike, si pasojë e një menaxhimi më të mirë energjetik që mund të bëhet nga ana e fermereve të kësaj komune. Kjo parashikohet të realizohet nëpërmjet ristrukturimit të sektorit të bujqësisë dhe rikrijimit të grupeve të fermereve me interesa të përbashkëta, që do të mundësojë përdorimin e makinerive bujqësore. Kjo do të sjellë një përfitim të dyfishtë, nga njëra anë do të çojë në rritje të prodhimit bujqësor dhe nga ana tjetër, do të çojë në reduktim të konsumit specifik të lëndëve djegëse, për pasojë është në interesin e fermerëve.
- Aplikimi i skemave të përdorimit të biomasave dhe prodhimi i biogazit nga mbetjet bimore dhe shtazore nga bujqësia dhe blegtoria është gjithashtu efektive, për të plotësuar nevojat në rritje të sektorit të bujqësisë. Biomasa dhe biogazi mund të përdoren për ngrohjen e serave, duke plotësuar një pjesë të konsiderueshme të nevojave të tyre. Përdorimi i tyre do të bënte të mundur rritjen e kontributit të burimeve të rinovueshme të energjisë, uljen e kostos dhe në të njëjtën kohë do të çonte në reduktimin e ndotjes së mjedisit.
- Një nga masat më kryesore e analizuar në mënyrë sasiore në sektorin e bujqësisë, që parashikohet të sjellë një ulje prej 50% të konsumit të energjisë, është përdorimi i skemave ujtëse sa më eficiente, pra zëvendësimi i ujitjes sipërfaqësore që mund të jetë ose me brazda ose me përmytje, me ujitjen me presion në formë shiu ose me pika.
- Shfrytëzimi i pompave fotovoltaike për ujitje dhe sigurimin e ujit të pishëm për zonat kodrinore larg sistemeve të ujitjes dhe sistemeve të furnizimit me ujë të pishëm.
- Potenciali i energjisë diellore në Gjakovë e bën këtë burim energjie të preferueshëm, veçanërisht duke shfrytëzuar kolektorët diellore, që prodhojnë ajër të nxehtë për tharjen e kulturave tëndryshme bujqësore.

- Përdorimi i rezervuarve ekzistues të vaditjes për të instaluar impiante të gjenerimit të energjise elektrike atje ku ato janë me leverdi ekonomike.
- Instalimi i centraleve të vogla të erës, në pronësi të grup fermerëve, qëndodhen përgjate kodrave me pontencial të energjise diellore.

8.2.7. SEKTORI I TRANSPORTIT

Qyteti i Gjakovës është i lidhur mirë me qytetet kryesore të Kosovës si dhe me Shqipërinë veriore. Rrjeti rrugor kryesor përbëhet nga rrugët magjistrale dhe rajonale. Sa i përket transportit të udhëtarëve të cilat janë nën kompetencën e Komunës, kemi tri lloje të transportit:

- 1* Transporti Urban i Udhëtarëve
- 2* Transporti Urbano Periferik I Udhëtarëve
- 3* Transporti I Veçantë i Udhëtarëve

1* Transporti Urban i Udhëtarëve:

Linja në relacion Piskotë – Spital – Piskotë

2* Transporti Urbano Periferik I Udhëtarëve

në Komunën e Gjakovës ekzistojnë 14 , në këto linja operojnë 7 kompani të ndryshme private të cilat janë të licencuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe janë të pajisura me të drejtën e operimit (rendin e udhëtimit) nga Komuna e Gjakovës.

3* Transporti i Vecantë i Udhëtarëve

Në këtë kategori të transportit operojnë 48 linja në destinacione të ndryshme të territorit të Komunës të cilat shërbejnë për transportin e nxënësve. Në kuadër të Komunës është i organizuar edhe transporti periferik i udhëtarëve nga qendrat rurale në drejtim të qendrës urbane dhe anasjelltas. Gjatë ditës në drejtim të qendrave rurale janë të regjistruara 49 nisje.

Sa i përket transportit qytetit dhe Komunës ekzistojnë linjat urbane si dhe veprojnë 4 operatorë të cilët i kryejnë shërbimet e taksive. Qyteti disponon me rrjetin e rrugëve kryesore në brendi të qytetit. Në zonën më të re, Blloku i ri, rrugët kryesore janë të gjëra, shumica të asfaltuara, dhe pjesërisht të furnizuara me trotuare. Në pjesët tjera të qytetit, rrjeti është më pak i ngarkuar. Rrugët kryesore në pjesët tjera të qytetit janë të ngushta, dhe kanë standard të ulët. Si rezultat, pengesat e trafikut, dhe bllokimet e rrugëve janë të zakonshme. Në veçanti qyteti i vjetër ka probleme rreth të qasjes brenda tij. Për shkak të rrugëve të ngushta, sistemi i rrugëve në qendër të qytetit është një drejtimesh. Në disa pjesë të qytetit, p.sh. pjesa dërmuese e qytetit të vjetër, automjetet nuk mund të ndeshën. Edhe pse sistemi i rrugëve një drejtimesh është duke shkaktuar udhëtime shtesë, ky sistem duhet të merret parasysh edhe në pjesët tjera. Me objektivin për të reduktuar konsumin e energjisë dhe për një leverdisshmëri ekonomike janë marrë parasysh dhe janë analizuar disa masa sasiore dhe cilësore të efikasitetit të energjisë. Në transportin e udhëtarëve janë analizuar këto masa:

Mbështetur në eksperiencën botërore dhe në atë të vendeve fqinje, parashikohet që intensitetet energjike për sektorin e transportit të ulen 10%, si pasojë një menaxhimi më të mirë. Kjo do të realizohet nëpërmjet:

- ◆ rehabilitimit të rrugëve, i cili aktualisht ka filluar në shkallë të gjerë në Komunën e Gjakovës;
- ◆ ndërtimit të rrugëve të reja në Komunën e Gjakovës;
- ◆ menaxhimit me te mire te sektorit te transportit publik;
- ◆ përdorimit të makinave me fuqi motorrike më të ulët dhe më efçente;
- ◆ shpejtësive më të larta të lëvizjeve të mjeteve të transportit në zonat jashtë qytetit.
- ◆ Futja e linjave te shfrytëzimit të bicikletave;
- Ndërmerren dhe realizohen fushata të ndryshme ndërgjegjësuese për nxitjen e transportit publik.

Si rezultat i masave të mësipërme parashikohet që numri i udhëtareve me autobusa të rritet. Nisur edhe nga eksperiencia botërore, këto masa janë parashikuar për të inkurajuar transportin publik të udhëtareve kundrejt transportit privat, gjë që sjell ulje të konsumit të lëndëve djegëse, kosto me të ulët të transportit si dhe reduktim të emetimeve të ndërmjetme në atmosferë në krahasim me skenarin pasiv. Kjo do të shoqërohet me një kursim ekonomik, i cili mund të përdoret si në përmirësim të infrastrukturës rrugore, ashtu edhe në nxitjen e qytetareve për përdorim të transportit publik nëpërmjet tarifave më të ulta. Në transportin e mallrave rekomandohen këto masa: Rënia e kontributit të përdorimit të kamionave me tonazh 3 ton dhe 3-8 ton, duke filluar nga viti 2019 deri në vitin 2030. Diferenca që krijohet duhet të mbulohet nga transporti me kamiona të tonazhit 8-16 ton dhe mbi 16 ton.

Për të zbatuar masat e kursimit të energjisë në sektorin e transportit duhet të:

- Vazhdojnë masat e ndërmarra në Komunën e Gjakovës, për përmirësimin e infrastrukturës rrugore,
- Inkurajohet përdorimi i makinave me fuqi motorike më të vogël dhe me eficientë,
- Vendosen taksa doganore më të larta për makinat e përdorura në krahasim me makinat e reja (kjo masë duhet të futet nga qeveria qendrore),
- Vendosen dhe hartohen taksa të mirefillta mjedisore sipas emetimeve që ato hedhin në atmosferë.

9. PLANET E VEPRIMIT

9.1. PRIORITIZIMI I SEKTORËVE

Komuna e Gjakovës si gjithë komunat e tjera të Kosovës i shërben qytetarëve dhe ka si qëllim kryesor rritjen e mirëqenies së tyre nëpërmjet punësimit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë duke krijuar kushte konkrete për lulezim të biznesit. Por, Komuna në vetvete jo në të gjithë sektorët ka një ndikim të drejtë për drejtë.

Për pasojë, qëllimi i analizës të konsumit të energjisë në Komunën e Gjakovës është që të vlerësojë përdorimin e energjisë në Komunë në mënyrë që të identifikohen dhe prioritetizohen sektorët dhe sygjeron ndërhyrje specifike në efikasitetin e energjisë. Për këtë qëllim, sektorët me potencialin më të lartë të kursimit të energjisë, të cilët janë të arritshëm për shkak të kontrollit dhe impaktit nga Komuna, si dhe financiarisht të zbatueshëm do të theksohen dhe prezantohen në tabelën 17. Procesi për identifikimin e sektorëve prioritar merr në konsideratë këto tre çështje kryesore:

- Shpezimet relative për energjinë në çdo sektor si në nivel Komunal ashtu dhe për të gjithë ndërtesat (publike);
- Intensiteti Relativ i Energjisë (REI) për sektorin si kursime teorike të energjisë bazuar në rezultatet e ushtrimit të krahasimit dhe vlerësimin profesional të konsulentit duke shqyrtuar çdo sektor; dhe së fundmi
- Shkalla e kontrollit ose influencës që Komuna ka mbi çdo sektor ose komponent të një sektori të caktuar, kontrolli buxhetor i cili konsiderohet faktori më kryesor.

Tabela 17: Përmbledhje e sektoreve sipas shpenzimeve për energjinë, REI dhe potenciali për kursimin e energjisë.

Sektori	Potenciali i Kursimit të Energjisë= Intensiteti Energjetik Relativ	Niveli i Kontrollit/Autoritetit nga Komuna
Transporti Publik	15-20%	MESATAR
Transporti privat	15-20%	ULT
Ndërtesat publike të Komunës	40-50%	LARTE
Ndriçimi rrugor	50-60%	LARTE

Uji i pishëm	30-40%	ULET
ujrat e zeza	10-15%	ULET
Mbetjet urbane	10-20%	LARTE
Spektori elektrik	10-15%	ULET
Spektori rezidencial	40-45%	ULET
Spektori komercial	40-50%	ULET
Spektori industrial	20-25%	ULET
Spektori TJERË	30-40%	ULET

Vlen të theksohet se komuna e Gjakovës ka një nivel të lartë kontrolli për këto sektorë:

- Transporti publik,
- Ndërtesat publike
- Ndrçimi rrugor
- Mbetjat urbane

Dhe një nivel të vogël kontrolli për këto sektorë:

- Uji i pishëm dhe ujrat e zeza
- Transportin privat,
- Konsumin e energjisë nga familjet
- Konsumin e energjisë nga shërbimet private
- Konsumin e energjisë nga sektori shërbimeve private
- Konsumin e energjisë nga industria
- Konsumin e energjisë nga bujqësia.

Komunës i është besuar operimi i objekteve publike (ndërtesat publike, ndriçimi i rrugëve, transporti publik, menaxhimi/pastrimi i mbetjeve, furnizimi me ujë dhe ujrat e zeza) brenda kufijve të territorit Komunal. Kjo përbën pagesën e faturave të energjisë, mirëmbajtjen dhe investimet në rehabilitim dhe zgjerim të objekteve. Kosto e operimit janë përfshirë në buxhetin e përgjithshëm Komunal dhe janë mbuluar pjesërisht nga të ardhurat Komunale e transfertat me qeverisë qendrore. Niveli i transfertave nga qeveria qendrore tek Komuna është llogaritur duke u bazuar në një formulë fikse të faktoreve social-ekonomik. Komuna ka lirinë e veprimit për të rishpërndarë sipas kërkesës dhe disponueshmërisë, p.sh. reduktimi i shpenzimeve në një sektor– të tilla si shpenzimet e energjisë– nuk do të çojnë në një zvogëlim të transfertave buxhetore nga qeveria qendrore por fondet mund të përdoren për çështje të tjera të cilat janë nën diskrecionin e Komunës.

Efienca e mbledhjes së taksave nga Komuna është raportuar të jetë 90%. Buxheti Komunal (kostot/ të ardhurat) është i balancuar dhe Komuna nuk raporton borxhe apo kredi. Gjakova renditet si një kreditor i kategorisë së parë (niveli më i lartë) sipas aftësisë për të marrë hua dhe performancës financiare, vlerësuar nga Ministria e Financave. Shpenzimet kryesore të buxhetit Komunal janë personeli, investimet dhe shpenzimet Komunale të tilla si funerale, ndriçim, pastrim, menaxhim mbetjesh, ndërtesa publike. Shërbimet Komunale për furnizimin me ujë dhe pastrim përfshijnë largimin e mbeturinave dhe janë të kontraktuara tek kompani filiale Komunale. Komuna raporton se të ardhurat nga këto shërbime i mbulojnë kostot, që do të thote se nuk nevojiten subvencione Komunale për të balancuar ndonjë deficit në fund të vitit. Shërbimi i transportit publik është i licensuar dhe kostot e operimit të tij mbulojnë plotësisht nga koncesionari.

Edhe pse konsumi i energjisë në sektoret të cilët kontrollohen direkt nga Komuna përfaqëson vetëm një pjesë të vogël të energjisë totale të konsumuar nga e gjithë Komuna, prezantimi i ndërhyrjeve të suksesshme në këto sektore është i rëndësishëm për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me potencialet dhe përfitimet e mundshme tek qytetarët. Për më tepër, kursimet e energjisë në këto sektorë do të kontribuojnë direkt në reduktimin e kostove të energjisë si dhe zvogëlimin e shpenzimeve Komunale.

9.2. NIVELI I KONTROLLIT TË KOMUNËS NË TË GJITHË SEKTORËT

Për shkak të strukturave të ndryshme ligjore dhe rregullatore Komuna ushtron nivele të ndryshme influence dhe kontrolli tek shërbimet komunale dhe tek konsumatorë e fundit të energjisë. Lloje të ndryshme pronësie të objekteve të cilat konsumojnë energji në sektorë të ndryshme e limitojne ose forcojnë kontrollin e buxhetit dhe fuqinë e zbatimit dhe një pjesë e qenësishme e diagnostifikimit të energjisë urbane është që të përcaktoje shkallen e autoritetit ose kontrollit që Komuna mund të ushtroje tek palët e interesuara për energjinë sic tregohet në tabelën 18.

Tabela 18: çelësi i kontrollit të autoritetit Komunal

	Palët e interesuara shtetërore	Komuna praktikisht nuk ka kontroll; vendimet ndërmerren në nivel shtetërore
	Palët e interesuara lokale	Komuna është një nga të shumtat palë të interesuara të cilat ndërmarrin vendime në nivel lokal
	Komiteti lokal	Komuna përfaqësohet formalisht nga Komiteti që ndërmerr vendime
	Agjensitë funksionale Multi-	Komuna është një nga agjensitë e shumta me një rol vendim-marrës kombëtar
	Formuluesi i politikave	Komuna mund të vendosë direkt politikën në këtë Sektor
	Rregullatori/Imponuesi	Komuna mund të përcaktojë direkt politikën e Sektorit si dhe të imponojë zbatimin e tyre
	Kontrolli i Buxhetit	Komuna ka kontroll direkt mbi shpenzimet që kryhen në këtë Sektor

Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë dhe shpjegojnë nivelin e influencës dhe kontrollit që Komunës ka për dy sektorët.

Shembull Sektori A: Publik, ndërtesat Komunale – Nivel i LARTË kontrolli:

Komuna është përgjegjëse për të gjithë kodet, rregullat dhe lejet e ndërtesës dhe zotëron një nivel të lartë rregullator. Përderisa të gjithë kostot operacionale në lidhje me ndërtesën janë paguar nga buxheti i Komunës, përfshirë këtu dhe kostot e energjisë për mirëmbajtjen dhe investimet, Komuna zotëron një kontroll të lartë të buxhetit dhe ka incentiva direkte për të investuar ëpajisje me efikasitet të lartë energjie. Së fundmi, të qenit pronar i një ndërtese i jep Komunës fuqinë për të zbatuar disa masa të caktuara për kursimin e energjisë.

Shembull Sektori B: Transporti privat – Nivel i ULËT kontrolli:

Përderisa Komuna nuk mund të kontrollojë konsumin e lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike dhe kodet e performancës të automjeteve individual, ajo këtu ka kontroll të ulët rregullator. Fakti që kostot e energjisë të transportit individual janë mbuluar nga individë, do të thotë që Komuna ka një kontroll të ulët të buxhetit në këtë sektor. Së fundmi, Komuna zotëron influencë të limituar në imponimin e efikasitetit të energjisë në transportin individual.

Sic tregon dhe tabela 19, Komuna ka kontroll të plotë mbi sektorët e ndertesave publike komunale, ndricimin e rrugeve, furnizimin me ujë të pijshëm si dhe menaxhimin e ujërave të zeza. Këto sektorë do të jenë fokusi kryesor i planit Komunal për efikasitetin e energjisë.

Tabela 19: Shkalla e kontrollit të Buxhetit që Komuna e Gjakovës zotëron dhe fuqia që ajo ka për të imponuar konsumin e energjisë në sektorët

Sektori	Niveli i fuqisë të Autoritetit Komunal		
	Rregulatori	Kontrolli i buxhetit	Influenca dhe imponimi
Transporti publik	ULËT	ULËT	MESATARE
Transporti privat	ULËT	ULËT	ULËT
Publik, ndërtesat Komunale	LARTË	LARTË	LARTË
Ndricimi i rrugëve	LARTË	LARTË	LARTË
Uji i pijshëm / Ujrat e zeza	LARTË	LARTË	ULËT
Mbetjet e ngurta	LARTË	LARTË	LARTË
Furnizimi me energji	ULËT	ULËT	ULËT
Sektori rezidencial	ULËT	ULËT	ULËT
Sektori komercial	ULËT	ULËT	ULËT

Komuna ushtron disa kontrolle rregulatori në sektorin e transportit publik nëpërmjet licensimit të disa kompanive komerciale që merren me transportin e pasagjerevë.

Megjithatë, kontrolli i buxhetit dhe influenca mbi konsumin e energjisë të këtyre automjeteve është e ulët. Komuna nuk ka aspak ose shumë pak kontroll mbi buxhetin, imponimin e rregullave të efikasitetit të energjisë tek furnizimi me energji i sektorëve që janë konsumatorë final, transportin privat individual si dhe sektorët rezidencial, ndërtesat komerciale dhe ndërtesat publike jo-Komunale; përderisa ato kontrollohen nga qeveria qendrore ose janë të organizuara në mënyre individuale/komerciale.

Mundësi e vetme për Komunën që ti influencojë këta sektore është që të përfshijë palët e interesuara në procesin e planifikimit të energjisë Komunale si dhe të rrisë ndërgjegjesimin në lidhje me efikasitetin e energjisë. Në këtë pikë, sektorët ku Komuna zotëron nivel të ulët kontrolli lihen menjandhe nuk ndiqen më tej në analizat dhe në termat e rekomandimeve për efikasitetin e energjisë në lidhje me programet e Komunës për EE. Megjithatë, kjo jo domosdoshmërisht do të thote se në këto sektorë nuk mund të zhvillohen masat EE.

9.3. SFIDAT E KOMUNËS NË LIDHJE ME KONSUMIN ENERGJETIK

Komuna e Gjakovës ka përballe shumë sfida të ndryshme për sa i përket potencialit që ai zotëron në lidhje me efikasitetin e energjisë. Këto sfida mund të kategorizohen gjerësisht në tre grupe (tabela 20).

Tabela 20: Sfidat Energjitike për Komunën

Sfidat ekonomike dhe demografike	Niveli i përgjithshëm i sfidave ekonomike të Komunës	Sfidat e sektorit specifik
<p>Në rritje:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➢ Popullsia ➢ Kërkesa për energji ➢ Kërkesa për shërbimet e Komunës ➢ Kosto mirembajtje ➢ Harxhimet e buxhetit të 	<ul style="list-style-type: none"> ➢ Konsumi i lartë i energjisë për shërbimet e Komunës (ndërtesat, ndricimi) ➢ Kosto e lartë për mirembajtje dhe riparime ➢ Shpenzime të larta dhe të shkallëzuara të buxhetit për furnizimin me 	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtesat publike (N1) - Konsum i lartë i energjisë specifike krahasuar me nivelin e ngrohjes - Nuk përmbush nivelin e komfortit - Shpenzime të larta dhe të shkallëzuara të buxhetit për furnizimin me energji - Kërkesa për analiza të thella dhe auditimi i energjisë

Sfidat ekonomike dhe demografike	Niveli i përgjithshëm i sfidave ekonomike të Komunës	Sfidat e sektorit specifik
<p>Komunës</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Emetimet mjedisore ➤ Varësia ndaj naftës Turizmi 	<p>energji si shkak të rritjes së tarifave</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Objekte dhe pajisje joefikase dhe të dala për punë ➤ Ullje disponueshmërie e objekteve dhe furnizim jo i besueshëm, të tilla si furnizim me energji elektrike dhe ngrohje qendrore ➤ Kapacitete të kufizuara në përgatitjen dhe zbatimin e kursimit energjisë dhe masat rehabilitimit ❖ Kapacitete të kufizuara të kapitalit njerezor: stafi i Komunës nuk ka aftësitë ose pajisjet e duhura për imponimin e rregullave të performancës së energjisë ❖ Informacioni i ulët i mundësive të EE 	<ul style="list-style-type: none"> - Ndriçimi i Rrugëve (NRR) - Ndriçim jo i besueshëm me llampa të vjetra, joefikase - Kosto e lartë për zëvendësim dhe mirembajtje - Të ardhura nga fitë (fees) respektive nuk i mbulojnë shpenzimet - Kërkesë për përmisimin e ndricimit nga trevat historike të qytetit dhe rrugëve hyrëse të kalasë
<p>Limitime në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Performancën e pajisjeve ➤ Furnizimin me energji (mungesa) ➤ Fonde për investime ➤ Stimuj për të investuar në teknologjinë e EE ➤ Informacioni për EE ➤ Ndikime të tjera ➤ Zbatim i dobët i paketave të EE 		<ul style="list-style-type: none"> - Uji i pijshëm dhe ujrat e zeza (UP / UZ) - Tendencë të lartë të konsumimit të ujit - Nivel i lartë i humbjeve dhe mospagesa - Konsum i lartë specifik i energjisë për shkak të pajisjeve të vjetëruara - Ndotje e lartë e lumit për shkak të mos-trajtitimit të ujërave të zeza <p>Mbetje të ngurta (MN)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kosto të larta dhe në rritje të lëndëve djegëse - Shkallë e ulët e riciklimit dhe përdorimit energjistik (djegia) - Nuk ekzistojnë kapacitetet të cilat përputhen me standartet mjedisore të zonave të gruposjes së mbetjeve - Të ardhurat nuk i mbulojnë kostot dhe për pasojë ekziston kërkesa për subvencione Komunale

10. MONITORIMI DHE IMPLEMENTIMI I PLANIT TË VEPRIMEVE

10.1. MANAXHIMI I ENERGJISË NË KOMUNA

Komuna e Gjakovës dhe GIZ-i nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për Krijimin e Sistemit të Menaxhimit të Energjisë në Nivel Lokal. Kryetari i komunës së Gjakovës, Z. Ardian Gjini nënshkroi një Memorandum bashkëpunimi me përfaqësuesin e GIZ-it, Projekti i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (KEEP) për Krijimin e Sistemit të Menaxhimit të Energjisë në Nivel Lokal, që ka për qëllim të sigurojë bashkëpunimin e dakorduar dhe të ngushtë midis palëve nënshkruese për krijimin e sistemit për menaxhimin komunal të energjisë, bazuar në

Marrëveshjen për zbatim të projekteve për bashkëpunim teknik të datës 29.08.2017 në mes të GIZ dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Kosovës. Në bazë të kësaj marrëveshje, komuna e Gjakovës është përgjegjëse për themelimin e Zyrës Komunale për Energji (ZKE) ose emërimin e një zyrtari në pozitën e Menaxherit Komunal të Energjisë (MKE), hartimin e Rregullores së Punës së ZKE-së dhe përshkrimin e detyrave të punës për MKE-në e emëruar, krijimin e Grupit Punues Komunal për të punuar në rishikimin e PKEE-së dhe hartimin e PKVEE-së, si dhe menaxheri i ZKE apo MKE e bën koordinimin e të gjitha aktiviteteve të projektit nga ana e Komunës. Kurse GIZ, është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve këshillëdhënëse dhe ekspertizës teknike të drejtpërdrejtë nëpërmjet projektit apo përmes konsulentëve vendorë dhe ndërkombëtarë, zhvillimin dhe sigurimin e ndërtimit të kapaciteteve duke i përdorur praktikat më të mira, sigurimin e mbështetjes së ekspertëve vendorë duke e përdorur ekspertizën relevante nga OJQ-të lokale, kompanitë vendore, ekspertët lokalë apo sipas nevojës edhe të ekspertëve rajonal të punësuar për ta mbështetur MKE-në. Me bashkëpunim të Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe GIZ është realizuar trajnimi treditör lidhur me menaxhimin e Energjisë në Komunën e Gjakovës, në të cilën morën pjesë Drejtorët e Shërbimeve Publike dhe Zyrtarët komunal për Energji. Pjesë e programit trajnues ishin edhe temat si:

- Komunat si prodhues / konsumator / rregullator dhe motivues energjie,
- Pse Menaxhimi i Energjisë në komuna dhe përcaktimi i strukturës organizative në lidhje me Menaxhimin e Energjisë Komunale,
- Hapat bazik në procesin e krijimit të sistemit të Menaxhimit të Energjisë Komunale,
- Prezentimi i ciklit të menaxhimit të energjisë në nivel komunal,
- Identifikimi i mangësive, mospërputhjeve, dhe problemeve të procesit aktual të vendimmarrjes në komuna që ndërlidhen me Menaxhimin e Energjisë Komunale,
- Prezentimi i Projektit GIZ-KEEP,
- Aktivitetet për mbështetje komunave,
- Procesi i krijimit të sistemit për Menaxhim Komunal të Energjisë (MKE) me komunat,
- Softveri ENMASOFT për MKE (spjegimi i aktiviteteve që do të zhvillohen në lidhje me: mbledhjen e të dhënave, krijimi i bazës së të dhënave, llogaritja e potencialit të kursimit të energjisë, krijimi i Planit Komunal të Veprimit për EE),
- Monitorimi dhe raportimi i projekteve të implementuara në fushën e EE me Platformën për Monitorim dhe Verifikim (MVP),
- Përgatitja e komunave për aplikim për projekte për EE.

Zbatimi i suksesshëm i planit Komunal të Gjakovës për EE kërkon pronësinë dhe angazhim të palëve të interesuara. Në mënyrë që të arrihet kjo, është e nevojshme që të kryhet një analizë e strukturuar e sektorit për të përcaktuar sfidat dhe masat e nevojshme si dhe përfitimin e njohurive në lidhje me bashkë-përfitimet të cilat duhet të zhvillohen dhe komunikohen tek palët përkatëse të interesuara. Që të zbatohet në mënyrë të suksesshme plani EE dhe që të nisë kursimi i energjisë dhe përmirsimi i shërbimeve Komunale, Komuna e Gjakovës duhet të fokusohet në keto tre çështje kryesore:

- (i) **Adoptimin e një plani EE** nga Këshilli Komunal për legjitimizimin dhe institucionalizimin demokratik të targeteve EE (→ **Përfshirja e palëve të interesuara**);
- (ii) Zhvillimi dhe promovimi i **mekanizmave financiar të qëndrueshëm të EE** të cilët konsiderojnë kursimet shumë-vjecare të energjisë për të shlyer investimet EE, dhe
- (iii) Fuqizimi i **kapacitetit për sigurimin e EE** në Komunë dhe forcimin e njësie të vecantë e cila është përgjegjëse për mbikqyrjen e zbatimit të planit EE.

Figura 57 paraqet hapat e nevojshëm për një zbatim të suksesshëm për planin Komunal për EE.

Figura 57: Fazat e zbatimit të planit Komunal të EE ne Gjakovë




10.1.1. KOORDINIMI

Një kërkesë shumë e rëndësishme për zbatimin e suksesshëm të programit EE është që të ndërtohen kapacitetet institucionale dhe që të krijohet një pikë kryesore për eficientë të energjisë në Komunën e Gjakovës, për shembull duke themeluar një departament i cili i dedikohet EE brenda Komunës. Departamenti aktual tashmë i themeluar do të ishte më e përshtatshme për të marrë një mandate të tillë për tu marrë me EE. Megjithatë, aftësitë dhe njohuritë e personelit aktual në lidhje me EE si dhe kapacitetet që ai zotëron monitorimin e energjisë dhe kostove të energjisë janë të një niveli të kënaqshëm. Kërkesat kryesore për një njësi administrative të **Zyres komunale për energji** në Administratën e Komunës janë:

Mandat Zyrtar	Staf i Kualifikuar	Buxhet të Përshtatshëm
----------------------	---------------------------	-------------------------------

Numri minimal i stafit të Departamentit 2 – përfshirë këtu Drejtuesin dhe një inxhinjer – duhet të parashikohet dhe të mbulojë kualifikimin dhe ekspertizën në disiplina si inxhinjia (energjetik), ekonomist (projektet që kanë lidhje me investimet) dhe marrëdhëniet me publikun (për detyrat e promovimit/informimit në lidhje me EE). Një program i ngritjes së aftësive profesionale duhet të planifikohet në fillim të zbatimit të programit duke filluar me themelimin e një Departamenti për Menaxhimin e Energjisë. Mund të përqasemi donatoreve ndërkombëtar dhe në rastin konkret duhet vlerësuar maksimalisht puna e madhe që po bën GIZ për të siguruar asistencë teknike për planifikimin e biznesit dhe ngritjen profesionale të departamentit sic tregohet në figurën 58.

Figura 58: Elementet kryesore të zyrës për energjinë



Nje katalog i detyrave të **Menaxhimit të Energjisë** duhet të përbëhet nga:

A) Aktivitete të përgjithshme horizontale

- **Programe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e EE** për të gjithë sektorët duke realizuar evente të cilët informojnë mbi EE, konkurse dhe cmime (psh. në shkollë) dhe zhvillimi e shpërndarja e materialeve informuese dhe promovuese të ef i ç encës së energjisë²;
- **Transformimi i propozimeve teknike të projekteve të efi ç encës së energjisë** në nje plan të arsyeshëm investimesh për tju përqsasur financuesve dhe donatorëve;
- **Planifikim i vazhdueshëm i kapitaleve të investimeve**, strukturimi financiar dhe mbledhja e fondeve;
- Përgatitja, blerja dhe mbikëqyrja e auditimeve të energjisë dhe studimeve të fizibilitetit;
- **Mbështetja e projekteve për investim**: organizimi dhe mbikqyrja e specifikimeve teknike, tenderimi dhe prokurimi si dhe një mbikqyrje e kualifikuar e ndërtimeve bashke me ngritjen profesionale dhe udhëzuesin për instalimin e praktikave me të mira;
- Programi për **Monitorimin dhe Verifikimin (M&V)** (ndjekjen e objektivit); monitorimin e rezultateve dhe përfitimeve dhe raportimin tek palët e interesuara;
- Zbatimi i një **Programi për monitorimin e konsumit të energjisë**;
- Përgatitja dhe zbatimi i një skeme për integrimin e performancës së energjisë dhe vlerësimi i kostos së ciklit të jetës për kontratat e blerjes dhe shërbimit, dispozitat e udhëzimeve të prokurimit për ndricimin, paisjet³, etj.

B) Sektori dhe masat të cilat lidhen me të

Ndërtesat Publike	- Themelimi i një inventari të ndërtesave të Komunës së Gjakovës (bazuar në punën shumë të mirë të bërë në këtë projekt me mbështetjen e gjithashshme të GiZ – inventari aktual i ndërtesave publike është realizuar dhe kërkohet që të përditësohet vit pas viti), krahasimi dhe monitorimi i performancës së energjisë bazuar në treguesin kWh/m2 vit sipëfaqe ndërtese;
--------------------------	--

². Pëveç kërkesave të cilësish për materialet/produktet, të tilla si jetegjatesia dhe përmbustja e standarteve, dokumentet e tenderit për ndricimin e rrugëve gjithashtu duhet të përfshijnë një kërkesë për nivelin e ardhshëm të ndricimit në çdo rrugë të rinovuar. Vecanërisht ndryshimi i ndricimit aktual me ndricues LED duhet të përgatitet me kujdes sepse Komunitet kanë pak experiencë në lidhje me shpërndarjen e kapacitetit i të fluksit i të drites. Tarifime nuk mund të zbatohen zgjidhje të thjeshta si aplikimi i llambave. Për shkak të avancimeve teknologjike, fluksi i ndricimit LED mund të jetë shumë më i ulët se ato i llambave konvencionale, sepse llambat LED kanë një afësi shumë të fokusuara ndricimi. Për më tepër, të dhënat e siguruar nga prodhuesit për ndricimin LED akoma nuk janë të standartizuara dhe kjo mund të çojë në oferta të pakrallueshëm.

	<ul style="list-style-type: none"> - Analiza krahasuese për konsumin e energjisë në ndërtesa; - Edukimi dhe ndryshimi i sjelljes së stafit/perdoruesve të ndërtesave në pronësi të Komunës të Gjakovës.
Ndriçimi i rrugëve	<ul style="list-style-type: none"> - Themelimi i një inventari të ndriçimit të rrugëve të Gjakovës (bazuar në punën shumë të mirë të bërë në këtë projekt me mbështetjen e gjithashshme të GiZ – inventari aktual i ndriçimit të rrugëve është realizuar dhe kërkohet që të përditësohet vit pas viti), krahasimi dhe monitorimi i performancës së energjisë bazuar në treguesin kWh/km rrugë të ndriçuar; - Program i integruar për Vlerësimin e Ndriçimit Publik në të gjithë Komunën e Gjakovës; - Analiza krahasuese për konsumin e energjisë në lidhje me ndriçimin e rrugëve; - Udhëzuesi i Prokurimit për Instalimet e Reja të Ndriçimit të Rrugëve.

10.1.2. RAPORTIMI

10.1.2.1. Monitorimi dhe raportimi brenda komunës

Masat shoqeruese jo-investuese në drejtim të rritjes së kapaciteteve manaxhuese të energjisë dhe për këtë sektor janë rekomanduar që të mundësojnë investimet si dhe monitorimin e rezultateve:

- Themelimi i Zyrat Komunale të Energjisë bazuar ne Ligji për EE dhe UA nr. 09-2017, për Zyrat komunale të energjisë.
- Rritja e aftësive të Zyres komunale për energji të Komunë së Gjakovës për EE ne ndërtesat publike, ndriçimin e rrugëve, furnizimin me ujë dhe mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve urbane;
- Zyra Komunale për energji do të jetë përgjegjëse për raportimin e arritjeve ne drejtim të EE ne te gjithë sektoret e shërbimeve komunale;
- Kryerja e një analize krahasuese për konsumin e energjisë në ndërtesa për të gjithë ndërtesat publike bashkë me një program auditimi energjitik për të gjithë ndërtesat
- Në menyre që të përgatiten projektet e investimit për masat e mëtejshëm sygjerohet:
 - o Studime fizibiliteti dhe dizanji i projekteve të investimit
 - o Specifikime teknike, tenderim dhe prokurim
 - o Mbikëqyrje e kualifikuar e ndërtimit bashke me ngritjen profesionale dhe udhëzimin per instalimin e praktikave më të mira;
- Programi për moniorimin konsumit të energjisë;
- Programi për ngritjen profesionale për operatorët e stafit teknik të objektit.
- Edukimi dhe trajnimi i ndryshimit të sjelljes së punëtorëve/perdoruesve të ndërtesave të cilat janë pronë e Komunes.

Masat shoqeruese jo-investuese për këtë sektor janë rekomanduar për të mundësuar investimet si dhe për të mbështetur monitorimin e rezultateve:

- Vlerësim i integruar i të gjithë bashkisë në lidhje me vlerësimin publik përfshirë dhe auditimet energjitike;
- Analiza krahasuese për konsumin e energjisë në lidhje me energjinë elektrike për ndriçim;
- Doracak (udhëzuesi) e prokurimit për instalimet e reja nëlidhje me ndriçimin e rrugëve;
- Për projektet e investimit:
 - o Studimet e fizibilitetit dhe dizanji i projektit të investimeve;
 - o Specifikime teknike, tenderimi dhe prokurimi;
 - o Mbikëqyrje e kualifikuar ndërtimi bashkë me kapacitetin e ndërtesës e

- udhëzime në lidhje me praktikat më të mira të instalimit;
- Programi për monitorimin e konsumit të energjisë;
- Programi për aftësimin teknik për operatorët teknik të faciliteteve.

Masat shoqëruese jo-investuese për këtë sektor janë rekomanduar që të krijojnë një mjedis i cili mundëson investime si dhe monitorimin e rezultateve.

- Për përgatitjen e investimeve në projekte (për stacionin e transferimit):
 - o Studimi i fizibilitetit dhe realizimi i projektit inxhinjerik të investimit në projekt;
 - o Specifikime teknike, tenderimi dhe prokurimi;
 - o Mbikëqyrje e kualifikuar e ndërtimit bashkë me rritjen profesionale dhe udhëzues për praktikat më të mira të instalimit;
- Programi për monitorimin e mbledhjes sëmbetjeve;
- Fushata edukuese për klasifikimin dhe reduktimin e mbetjeve;
- Programi për rritjen profesionale për operatorët teknik të objekteve.

Rekomandimet për masat shoqëruese tek niveli i qeverisë qendrore janë:

- Futja në përdorim të kriterëve të gjelberta të prokurimit publik për paisjet të cilat funksionojnë me energji në ndërtesat publike.
- Kërkesat minimale për cilësinë termike të ndërtesave të reja dhe atyre ekzistuese.
- Skema e certifikimit të ndërtesave.

10.1.2.2. Raportimi ne Agjencionin Kosovar për Eficiencë të Energjisë (AKEE)

Rishikimi i progresit të deritanishëm të kursimeve të energjisë në Kosovë është i vështirë, pasi nuk është krijuar asnjë platformë monitorimi dhe verifikimi për raportimin e saktë poshtë-lart (PL), ndërsa kufizimet në qëllimin dhe cilësinë e statistikave kombëtare pengojnë modelimin e besueshëm lart-poshtë (LP). Nga të gjitha masat e parashikuara në PKVEE, zbatimi i shumë prej tyre u vonua nga ngadalësimi i progresit të pritshëm në hartimin dhe miratimin e legjislacionit mbështetës në mënyrë që të gjitha Komunitet të raportojnë tek AKEE. Këto çështje trajtohen në mënyrë të detajuar në seksionet e mëposhtme.

Aktiviteti i matshëm që është kryer ishte kryesisht në formën e asistencës financiare (huatë dhe grantet) për përmirësimin e eficiencës së energjisë në termoizolim të jashtëm të ndërtesave, për kolektorët diellorë për ngrohjen e ujit, për automjetet e transportit të mallrave dhe traktorët më eficientë, dhe në një masë më të vogël, për pajisjet me eficiencë të energjisë. Të dhënat për këto programe, për çdo masë të EE/BRE, u morën, për çdo institucion financiar, në formën e mbështetjes financiare në vit të paraqitur në nivel të grupuar. Për të ruajtur strukturën e raportimit, të kërkuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKE), duhen raportuar kursimet e vlerësuara, përfshirë vitin 2018 dhe çdo vit që pason 2019, 2020 dhe vitet e tjera (tabela 21).

Tabela 21 : Krijimi i një sistemi të integruar informacioni për monitorimin dhe zbatimin e politikave për eficiencën e energjisë

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Krijimi i një sistemi të integruar informacioni për monitorimin dhe zbatimin e politikave për eficiencën e energjisë
Përshkrimi	Kategoria	Mekanizma për arritjen dhe monitorimin e kursimeve të energjisë
	Afati kohor	Fillimi: 2019 Mbarimi: 2020 dhe të gjitha vitet për periudhën 2021-30 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime

	Qëllimi/Përshkrim i shkurtër	Sistemi i integruar do të jetë një bazë për zbatimin e masave të përcaktuara në planin komunal të EE të Gjakovës në kuptimin e monitorimit të zbatimit të të gjitha masave, llogaritjeve metodologjike të kursimeve, hartimit të rregulloreve për eficiencën e energjisë, lehtësimin e zbatimit të masave, integrimin e të gjithë pjesëmarrësve dhe përdoruesve fundorë.
	Përdoruesi fundor i synuar	Konsumi primar dhe final i të gjithë burimeve energjetike; kjo masë do të monitoronte zbatimin e masave, programeve, planeve dhe projekteve për eficiencën e energjisë në të gjithë sektorët e konsumit final dhe primar të gjithë burimeve energjetike.
	Grupi i synuar	Të gjitha palët e detyruara në zbatimin e masës (organet ekzekutive) të përcaktuara në këtë plan veprimi.
	Aplikimi rajonal	Komuna e Gjakovës
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve kursimin energjisë përbëjnë masën për e që	<p>Projekti i zhvillimit të një sistemi të integruar informacioni duhet të fillojë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik/AKEE mbështetur nga organizata ndërkombëtare, siç janë, psh. GIZ apo projekte të ndryshme të BE-së.</p> <p>Zhvillimi i sistemit kryhet në faza dhe zhvillimi shtesë varet nga kërkesat e ardhshme të KE-së dhe detyrimet.</p> <p>Deri në fund të 2019, Ministria e Zhvillimit Ekonomik/AKEE mbështetur nga GIZ do të ndërtojë sistemin bazë, i cili do të mbështesë aktivitetet, raportet e zbatimit për të gjitha Komunat e Kosovës.</p> <p>Sistemi i integruar i informacionit duhet të mundësojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raportimin e rregullt mbi zbatimin e masave, programeve dhe planeve për eficiencën e energjisë; • Analizën e zbatimit të masave, programeve dhe planeve, si dhe rekomandimet për periudhën e ardhshme dhe rishikimin e planeve, masave dhe programeve; • Identifikim më të lehtë të pengesave në zbatimin e masave, planeve dhe programeve; • Mbështetje për koordinimin e zbatimit të politikave për eficiencën e energjisë; • Mbështetje për hartimin e rregulloreve kombëtare për eficiencën e energjisë dhe mbështetje për hartimin e dokumenteve të planifikimit kombëtar; • Kontributin në të gjithë sistemin e zbatimit të politikave për eficiencën e energjisë.
	Buxheti dhe burimi financiar	Fondi për Eficiencën e Energjisë në Kosovë dhe mbështetur fillimisht nga EU dhe Banka Botërore
	Organi zbatues	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
	Autoriteti monitorues	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, KEEA

Kursimet e energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Në nivel lokal, kjo masë aplikon llogaritjen e masave, programeve dhe planeve të zbatuara për eficiencën e energjisë, në përputhje me metodën PL dhe LP.
	Kursimet e pritshme në 2020	Në cdo sektor mund të arrihet deri në 2.5% të konsumit si pasojë e informimit të gjithë përdoruesve të shërbimeve të ndryshme komunale
	Kursimet e arritura në 2023	Në cdo sektor mund të arrihet deri në 5% të konsumit si pasojë e informimit të gjithë përdoruesve të shërbimeve të ndryshme komunale
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2026	Në cdo sektor mund të arrihet deri në 7.5% të konsumit si pasojë e informimit të gjithë përdoruesve të shërbimeve të ndryshme komunale
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2030	Në cdo sektor mund të arrihet deri në 10% të konsumit si pasojë e informimit të gjithë përdoruesve të shërbimeve të ndryshme komunale
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	Kjo masë është në përputhje me të gjitha masat e përcaktuara në planet e veprimit, si dhe me palët e tjera të detyruara.

11. MODELI DHE BURIMET FINANCIARE PËR FINANCIIMIN E REALIZIMIT TË MASAVE TË EE

11.1. FINANCIIMI NGA BUXHETI I KOMUNËS

Përveç potencialit të madh të kursimeve të energjisë dhe reduktimit të shpenzimeve operuese, ekzistojnë një numër i madh barrierash për të zbatuar programet e eficiencës së energjisë, përfshirë: i) Procedura jo-fleksibelë prokurimi për paisjet dhe shërbimet, dhe ii) Buxhete të limituara një-vjecare që limitojnë financimin e përditësimeve të kapitalit.

Financimi i projekteve të EE mund të jetë vecanërisht sfidues përderisa Komunitetet shpesh janë të mbyllura në një rreth vicioz për shkak të buxhetit të limituar për investime të reja, ndërsa varësia në infrastruktura të vjetra e detyron Komunitetin që t'i përdori burimet e kushtueshme që ka në mënyrë jo-eficiente. Masat për reduktimin e energjisë në sektorin publik mund të ndihmojnë në frenimin e shpenzimeve të energjisë, duke krijuar në këtë mënyrë një hapësirë fiskale për shpenzimet e tjera (p.sh. shërbimet sociale, investime në infrastrukturë, etc.). Megjithatë, zbatimi i programeve të eficiencës së energjisë është i limituar edhe në ekonomitë e vendeve të zhvilluara, me anë të rregullave të kontabilitetit, praktikave të ashpra të prokurimit të sektorit publik, dhe akses të limituar të buxhetit ose financimit të projekteve të EE. Për shembull, aplikimi strikt i kritereve të prokurimit të cmimit më të ulët nuk e reflekton përfitimet që vijnë nga investime në kursimin e energjisë. Materialet dhe paisjet e një cilësie më të lartë dhe me një performancë më të mirë energjitike do të jenë pak më të kushtueshme, por do të arrijnë kursime më të larta në koston e energjisë gjatë jetegjatesisë së tyre. Më me rëndësi për arritjen e kursimeve afat-gjata në energji është instalimi dhe ndërtimi i kryer me një profesionalizëm të lartë. Oferta më e mirë bazuar në cmimet më të ulta për punët instaluese/ndërtimore ka me vete riskun e mos-përdorimit të praktikave më të mira që zotërohen nga instalues me experience. Si pasojë, procedurat e tenderimit publik duhet të rregullohen – sa më shumë që të jetë mundur – për të përzgjedhur kombinimet e paisjeve dhe punëve të cilat kanë kosto optimale dhe përfitime sa më afat-gjata. Për këtë arsye, kërkesat e cilësisë në specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit duhet të jenë precize dhe procesi i vlerësimit duhet të reflektojë këtë përjasje.

Financimi i efijencës së energjisë është i ndryshëm nga forma të tjera investimi. Ndërsa projektet e investimit financohen shpesh kundrejt ndonjë produkti të prekshëm – investimet në efijencën e energjisë gjenerojnë shumicën e vlerës së tyre nga të ardhurat që ato do të gjenerojnë në të ardhmen prej kursimeve të energjisë. Si rrjedhojë, në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i Planit të EE për Gjakovën, është e rëndësishme që të merren në konsideratë mënyrat se si mund të zvogelohen barrierat duke grupuar/bashkuar prokurimin publik, praktikat shumëvjeçare publike të kontabilitetit, të buxhetit dhe ruajtjen e kursimeve – dhe të nxiten skemat për ndarjen e përfitimeve. Buxhetimi i investimeve është një mjet për planifikimin e shpenzimeve i cili përfshin një plan shumë-vjeçar për përmirsimin e kapitalit dhe përgatitjen e një buxheti vjetor kapital. Përmirsimi i planit të kapitalit është i rëndësishëm sepse blerja, zhvillimi, zgjerimi ose rehabilitimi i aseteve publik, të tilla si ndërtesat publike, kërkon shpenzime të mëdha parash, shpesh përtej limiteve të një buxheti vjetor. Planifikimi afat-gjatë është i nevojshëm për të siguruar që projektet të vlerësohen në një mënyrë sistematike, si nga aspekti teknik ashtu dhe ai financiar për të ndihmuar Komunën të përzgjedhë një listë projektesh të realizueshme brenda kapacitetit operativ dhe financiar të Komunës.

Sipas kësaj qasjeje, financimi sigurohet nga një agjensi qeveritare – në nivel Komunal ose qendror, si psh ministria e financave duke përdorur një kombinim të buxhetit Komunal dhe Institucioneve financiare ndërkombëtare (IFI) ose fondeve nga donatorët. Ky financim mbulon kostot e investimit të projekteve EE në ndërtesat dhe objektet publike të Komuneve. Marrësi i fondeve "shlyen" sasinë e përfituar duke përdorur kursimet e gjeneruara nga projekti i investimit në formën e faturave të reduktuara të energjisë për Komunën në vitet e ardhshme ("financim i buxhetit"). Sasia e shpenzimeve të reduktuara zakonisht bazohet në sasinë e kursimeve të kostos së energjisë. Rrjedha e fondeve për të paguar për përmirsimet për EE ndjek të njëjten rrjedhë normale si edhe të gjithë fondet e tjera nga MOF. Shlyerja e borxhit tek MOF mund të bëhet e plotë ose e pjesshme, qasja e pjesshme stimulon shërbimet Komunale dhe agjensite publike të marrin pjesë në program sepse ata ruajnë një pjesë të kursimeve të arritura (tabela 21).

Tabela 21: Rrjedha logjike e planifikimit të kapitalit dhe procesit buxhetor

Fazat	Hapat	Rezultatet
Planifikimi	Përditesimi i inventarit dhe vlerësimi i gjendjes së aseteve; Identifikimi i projekteve; Vlerësimi i projektit	Hartimi i inventarit duke analizuar kushtet dhe gjendjen në lidhje me shpenzimet energjetike për çdo objekt; listimi i projekteve bazuar në vlerësime të përafërta të investimeve të kërkuara; vlerësim i detajuar i kostove duke përfshirë edhe kostot e lëndëve djegëse vlerësimin e energjisë së kursier, të ardhurave që vijnë nga kursimi, kryerja e planit strategjik të investimeve, dhe vendosja e prioritetëve duke realizuar në përfundim të analizës edhe analizën financiare të përfitim-kostove për të identifikuar prioritetet. Të gjitha këto hapa tashmë janë realizuar bazuar në projektin aktual të mbështetur nga GIZ.
Buxheti mi	Renditja e projektit	Renditja e projektit duke përdorur teknikat e buxhetimit të kapitalit.
	Financimi	Marrëveshjet financiare për projektet të cilat përfshihen në buxhet.
	Buxheti	Shpenzimet e përfshira në propozimet e buxhetit për departamentet përkatëse, alokimi i fondeve bazuar në buxhetin e siguruar nga kranti qeveritar, përfshirja e kostove operuese të projektit në buxhetin afat-gjatë për periudhat kur projekti është realizuar dhe po funksionon.
Buxheti mi	Monitorimi i Prokurimit	Procesi për përzgjedhjen e kontraktoreve të projektit; Shqyrtimi i progresit financiar dhe fizik të projektit; Koordinimi i shpenzimeve me të ardhurat.
Auditimi	Auditim i Jashtëm	Shqyrtimi i të dhënave financiare pas përfundimit të projektit.

Buxhetimi i kapitalit duhet të ketë parashikime të kostove për të gjithë projektet e infrastrukturës të cilat janë propozuar, duke përfshirë si kostot ashtu dhe implikimet e investimit për operimin e buxhetit. Përgatitja e kapitalit të buxhetit kërkon renditjen e projekt-propozimeve duke përdorur teknika si periudha e vetëshlyerjes së investimit, vlera aktuale neto, norma e brendshme e fitimit ose indeksi i profitabilitetit.

Huamarresi i mundshëm dhe pranueshëm do të jetë Komuna e Gjakovës e cila është me aftësi pozitive kredimarrëse bazuar në buxhetet e publikuara dhe raportet e auditimit. Programi i huasë mund të mbështetet nga fonde të asistencës teknike për aftësimin profesional dhe reformën institucionale, dhe gjithashtu nga një grant investimi i bazuar tek performancë i cili siguron incentivat dhe shpërblimet tek Komuna për zbatimin e iniciativave reformuese për të përmirësuar performancën e sigurimit të shërbimeve.

11.2. FINANCIMI NGA BUXHETI QENDROR

Mekanizmat e financimit të cilat përdoren zakonisht nga Komuna kudo në botë mund të grupohen në katër kategori. Këto përfaqësojnë një rritje të vartësisë komerciale kundrejt atyre publike:

Financimi i buxhetit me rimëkëmbjen e kapitalit: Ky përfshin financim direkt nga buxhetet Komunale, përdorimin e granteve të jashtme dhe përdorimin e mekanizmave të kapjes së buxhetit psh. financim nga MOF ose një agjensi buxheti qendrore që përdorin fonde nga donatorë të ndryshëm, me pagesa në formë të reduktuar të shpenzimeve të ardhshme buxhetore;

Fonde të cilat zhvillohen specifikisht për të adresuar eficientë e energjisë. Kjo përfshin fonde riqarkulluese që, pasi gjenerohen nga buxheti i përgjithshëm ose fondet e donatorëve, mund të bëhen të vetëqëndrueshme. Një instrument i ardhshëm do të jetë Fondi Kosovar për Eficientë e Energjisë.

Kreditim i drejtëpërdrejtë nga IFI-te tek shërbimet e Komunës. Kjo përbëhet nga mekanizma financimi për sektorin publik—siguruar nga donatorë dhe/ose qeveri kombëtare ose rajonale tek Komunitat—të cilat mund të ndihmojnë në mbështetjen ose shfrytëzimin e financimit komercial.

Shfrytëzimi i financimit komercial duke përdorur kompani të shërbimit të energjisë (ESCO-te) sipas përjasjes kontraktuese të performancës në lidhje me kursimin e energjisë (ESPC). Është e rëndësishme të theksohet se Ligji i ri i Eficientë e Energjisë i aprovuar nga Ligji Kosovar ben të mundur plotësisht pranimin e skemave ESCO.

Gama e mekanizmave financiar të disponueshem nga Komuna varet nga shumë faktorë, si forca e saj financiare dhe aftësia e saj pozitive për marrjen e kredisë, parashikueshmëria e të ardhurave dhe transfertave në buxhet, struktura lokale dhe ligjore e rregullatorit, mjedisi financiar komercial, natyra e projektit të EE, kapaciteti i zbatimit të projektit si dhe mekanizmat e disponueshëm të ofruar. Shumica e këtyre faktorëve influencohen nga madhësia e Komunës. Shumë shpesh, një burim i vetem financimi nuk është i mjaftueshëm për zbatimin e një projekti të tërë, kështu që struktura e financimit të projekteve mund të përfshijë konsolidimin e fondeve nga shumë burime të ndryshme, të cilat të marra vec e vec nuk mund të jene të mjaftueshme. Grupimi i burimeve të ndryshme fondesh ka avantazhin shtese që e shpërndan riskun e projektit në shumë burime të ndryshme financuese (përfshirë kapitalin e kredimarrësve). Shumë shtete kanë zbatuar një gamë të gjerë mekanizmash financimi për të shkuar përtej financimit vetëm me grante, ose për të përmirësuar shfrytëzimin financiar të fondeve publike ose për të përftuar akses në fondet komerciale për projektet e EE.

Kërkesa e llogaritur për investime prej afërsisht 19.368 milion EURO e kalon aftësinë e Komunës të Gjakovës për të përmbushur nevojat e identifikuara të projekteve të

sipërpërmendura të EE. Në të njëjtën kohë, është e mundur që Komuna e Gjakovës mund të jetë e aftë të përfitojë grante ose subvencione nga fonde ndërkombetare për të financuar të gjitha këto masa. Si pasojë, duhet të zhvillohen mekanizma të qëndrueshëm financimi të cilat përfshijë sektorin privat.

Komuna e Gjakovës mund të fillojë me projekte të vogla pilot duke përdorur grante ose transfertat buxhetore. Bazuar në strukturën e dhënë të buxhetit për Komunën e Gjakovës – sic është paraqitur në seksionin 2.1 – detyrimet që ajo ka por dhe fleksibiliteti për shpërndarjen e buxhetit është maksimalisht rreth 25% e buxhetit (vlerë që korrespondon me 40% të transfertave të pakushtëzuara) mund të caktohen për investime.

Megjithatë, për shkak se fondet dhe grantet buxhetore mund të jetë të pakta, dhe përgjithësisht të pa-qëndrueshme, Komuna do të ketë nevojë më tëmadhe për të aksesuar financim nga tregu në mënyrë që të zbatojë projektet EE ekonomikisht atraktive, të cilat përndryshe nuk do të kishte burimet e nevojshme për ti zbatuar. Për këto arsye ajo do të duhet të përmirsojë kapacitetin e saj teknik dhe aftësinë për të aksesuar burime financimi.

Sipas ligjit të ri mbi Efiçencën e Energjisë të aprovuar theksohet si një instrument i rëndësishëm financiar ngritja e fondit të efiçencës së energjisë. Fondi i efiçencës së energjisë do të përdoret për të financuar aktivitetet e mëposhtme:

- investimet që synojnë përmirësimin e efiçencës së energjisë në ndërtesat private dhe publike, kompanitë industriale dhe në sektorin e transportit;
- investimet që synojnë përmirësimin e efiçencës së energjisë në nxjerrjen, prodhimin dhe transportimin ose transmetimin e energjisë;
- përmirësimet në efiçencën e energjisë në ndriçimin rrugor;
- përmirësimet efiçencën e energjisë në furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;
- zhvillimet e projekteve demonstruese për të investiguar dhe testuar teknologji të reja energjitike ose zgjidhje të reja organizative për sektorin e energjisë;
- auditimet e energjisë të kryera në sektorin publik;
- përmirësimin e matjes së energjisë dhe faturimit;
- fushata sensibilizuese dhe aktivitete edukuese në lidhje me efiçencën e energjisë.

11.3. FINANCIMI NGA DONATORËT

Disa nga Programet Multi-Përfituese janë dhënë në vijim:

- Western Balkan Investment Facility - WBIF ...; <http://www.wbif.eu>
- The Western Balkans Sustainable Energy Direct Financing Facility (WeBSEDF); <http://www.websedff.com>
- GIZ - Open Regional Fund for South Eastern Europe (ORF)
- European Investment Bank (EIB)
- German Bank for Reconstruction (KfW)
- Green for Growth Fund (GGF).....www.ggf.lu

11.4. FINANCIMI NGA FONDET E EU

Në këtë sesion jepen një numër i burimeve të financimit të brendshme dhe të jashtme për zbatimin e programeve të Efi ç encës së Energjisë. Stafi i Komunës duhet ti kontaktojë të gjithë donatorët për të bërë të mundur zbatimin e programeve të Efi ç encës së Energjisë sidomos lidhur me fondet ndërkombetare.

Fonde nga BE:

- **Fondet IPA** (Instruments for Pre-accession Assistance - Instrumentet për Asistencën e Para-anëtarësimin)

- Fondet IPA janë mjete nëpërmjet të cilin BE mbështet reformat në vendet në zgjerim me ndihmë financiare dhe teknike. Fondet IPA rritin kapacitetet e vendeve përgjatë procesit të anëtarësimit, duke rezultuar në rritje progresive, dhe zhvillime pozitive në rajon.
- Komuna e Gjakoves mund të marrë fonde nën komponentin 3 të programit të IPA; Zhvillimi Rajonal – për investime në transport, mjedis dhe kohezion ekonomik, të shoqëruara me asistencë teknike. Pjesëmarrja në këto programe duhet të ndihmojë vendet përfituese për të përdorur fondet rajonale të BE-së në mënyrë më efektive kur ai vihet në dispozicion (pasi ata bëhen vende anëtare të BE).
- **Fondet FP (Research Framework Program);** Më shumë informacion mund të gjendet në <http://web.jrc.ec.europa.eu>
- **TAIEX:** Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit (Technical Assistance and Information Exchange) është një instrument i BE-së që ndihmon vendet partnere të bëhen të njohur me, dhe të aplikojnë dhe zbatojnë ligjin e BE-së, dhe të monitorojnë në këtë mënyrë progresin e tyre.

11.5. AKSESI NE FINANCIMIN NËPËRMJET BANKAVE KOMERCIALE – PARASHIKIMI I KUFIZIMEVE PËR MADHESINË E BORXHIT

Komuna e Gjakovës mund të konsiderojë alternativën e hua-marrjes nga burime financuese komerciale dhe ta shlyejë borxhin me anë të kursimeve të përfituara në kosto. Aftësia e Komunës për të aksesuar burimet financiare të jashtme ndikohet nga legjislacioni përkatës kombëtar. Ligji për Huamarrjen e Qeverisë Lokale, përkufizon procedurat e miratuara dhe dispozitat e limituara, por gjithashtu e lejon qeveritë lokale që të marrë hua:

- Për qëllime fluksi të ardhurash ose investime,
- Nga tregu i kapitalit—institucionet financiare dhe Bankat, dhe
- Në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Huate afat-shkurtra mund të jepen për:

- Maturim me të shkurtër se një buxhet një vjeçar; dhe
- Për të financuar deficitet e përkohshme në fluksin e të ardhurave, atëherë kur shpenzimet operacionale janë më të larta se të ardhurat.

Kërkesa për një hua afat-shkurtër duhet të dërgohet fillimisht tek Ministria e Financave (MoF). Nëse MoF e refuzon kërkesën; Komuna ku mund të marrë hua direkt nga Bankat vetëm nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

- Huaja afat-shkurter asnjëherë nuk duhet të kalojë vlerën 10 përqind (10%) të të ardhurave totale aktuale të Komunës e nga taksat dhe tarifat lokale si dhe taksat e ndara me vitet e tjera të mëparshme.

Huate afat-gjata mund të jepen për:

- Investime për qëllime publike; dhe
- Mbulimin e funksioneve lokale—në pronësi, të përbashkëta (dhe të deleguara nëse është e nevojshme).

Maturimi i huase nuk duhet të jetë më i madh se koha që do të përdoret investimi. Huaja afat-gjate negocohet me Komunën por vendimi final merret nga këshilli lokal. Huaja vjetore e mbetur nuk duhet të kalojë:

- 20% e të ardhurave të pakushtëzuara (përfshirë zotërimin e burimit të të ardhurave, ndarjen e taksave dhe grantet e pakushtëzuara) në tre vitet e mëparshme fiskale; dhe
- 7.1 % të tepicës operacionale (raporti ndërmjet të ardhurave neto bruto dhe borxhi i mbetur i pashlyer duhet të jetë 1.4).
- Borxhi i mbetur i pashlyer (kumulativ) nuk duhet të jetë më i lartë se 130% e të ardhurave

të pakushtëzuara. Për paketa më të mëdha investimi psh. rehabilitimi i ndërtesave të shkollave ose transportit publik është i nevojshëm për të tërhequr financim të jashtëm nga IFI-te (aktualisht Gjakova do të fillojë një projekt me KfV për rinovimin e 4-5 ndërtesave publike) me skemat përkatëse të garancive kombëtare. Limitimet e fuqisë së Komunës për të rritur të ardhurat e kufizojnë aftësinë e Komunës për të marrë hua nga fondet komerciale për projektet e EE. Huadhënësit analizojnë aftësinë e Komunës për të shlyer borxhin duke rritur taksat ose tarifat e përdoruesve të shërbimeve Komunale dhe për këtë arsye ata zakonisht kërkojnë kolateralin ose mbulimin e duhur. Bazuar në rregulloren e Bankës dhe praktikën e udhëzimit të huadhënies komerciale, asetet e blera për një projekt EE zakonisht janë kolateral i pamjaftueshëm për huatë komerciale. Shumë nga asetet e tilla nuk mund të likuidohen për përdorim në ndonjë vend tjetër në rastin kur huamarrësi nuk shlyen huanë. Për këtë arsye huadhënësit kanë tendencën të kërkojnë siguri duke përdorur si kolateral asetet e Komunës.


- Kufizimet e Komunës në mbledhjen dhe përdorimin e të ardhurave, vartësine e tyre nga transfertat dhe limitimet që ata kanë në sigurimin e kolateralit si dhe mbulimi që ata mund të ofrojnë për të ardhurat, të gjitha janë faktorë që do të thotë se Komunitat—veçanërisht ato më të voglat—janë të ngjashme të mos perceptohen si kreditore të vlefshme nga huadhënësit. Si të tilla, Komunitat mund t'u duhet të mbështeten tek huadhënësit e rinj të cilët janë të ngjashëm të kërkojnë një sasi më të madhe kohore për të kryer analizën financiare të mundësisë së marrjes së kredive nga ana e Komunës. Megjithatë, Komunitat me të ardhura më të mëdha, siç është rasti i Gjakovës, dhe të qëndrueshme dhe me kapacitet të mjaftueshëm huamarrjeje mund të jenë të afta të bindin huadhënësit komercial për aftësitë e tyre paguese dhe në këtë mënyrë të zhvillojnë lidhje për të lehtësuar financimin e projekteve të EE. Gjithashtu, projektet EE gjenerojnë kursime në kosto, përveç të ardhurave të reja, krahasuar me një vlerë bazë (koston e përdorimit të energjisë në mungesë të projektit EE). Bankat mund të perballen me sfida në perkufizimin e një vlerë baze/standartit, si dhe matjen dhe verifikimin e kursimeve krahasuar me këtë vlerë, dhe të sigurohen që kursimet EE janë të mjaftueshme për shlyerjen e borxhit. Këto sfida mund t'i detyrojnë Bankat të refuzojnë financimin e projekteve EE.
- Kostot e transaksionit gjithashtu mund të luajnë një rol të rëndësishëm në kufizimin e aksesit ndaj financimit komercial për projektet EE të Komunës, veçanërisht për Komunitat me të vogla. Vetëm në rastet kur huadhënësit ndihen konfident për zhvillimin e një portofoli me projekte të tilla me një analizë teknike-financiare të standartizuar dhe metodologji procesimi, ato janë të afta që të refuzojnë financimin e projekteve EE. Ky është veçanërisht rasti kur huadhënësit nuk kanë njohuritë e duhura për të kuptuar projektet EE. Huamarrje direkt nga IFI për shërbimet Komunale, siç është rasti i Gjakovës (figura 59). Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në shërbimet Komunale (si psh furnizimi me ujë) shpesh përfshin investime të mëdha në infrastrukturë. Në të tilla raste, një IFI mund të sigurojë një hua direkt për shërbimet Komunale, me shkëmbim të një garancie kombëtare nga Qeveria Qendrore. Avantazhet e këtij opsioni janë:

Figura 59: Struktura e skemes së Financimit Direkt nga IFI tek Shërbimet Komunale

- Derisa shërbimi Komunal mund të jetë i aftë të ripaguajë hua me risk të ulët, ai mund dhe të mos plotësojë kërkesat e kreditimit të Bankave komerciale, dhe si rrjedhojë mund të mos jetë i aftë të përfitojë financimin e nevojshëm për një hua IFI.
- Incentivat janë përpunur ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit për të arritur në një marrëveshje në lidhje me sistemin e rregullimit të tarifave ekonomikisht të justifikuar nga

rregullatori kombëtar.

